



Raport

Çliro Ndryshimin

Zërat e të Rinjve të Kosovës 2010

20 tetor 2010

Copyright © UNICEF

Autor i këtij raporti është Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS)

ISBN 978-9951-600-00-2

Çliro Ndryshimin

Zërat e të Rinjve të Kosovës 2010

20 tetor 2010

Ky raport është mundësuar falë përkrahjes zemërgjerë nga UNICEF-i, dhe fondeve të Qeverisë së Luxemburgut.



LE GOUVERNEMENT
DU GRAND-DUCHÉ DE LUXEMBOURG

Mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë studim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e UNICEF-it.

PËRMBAJTJA


PARATHËNIE.....	2
SHKURTESAT DHE AKRONIMET	3
PËRMbledhje EKZEKUTIVE	5
HYRJE.....	7
REKOMANDIME	9
METODOLOGJIA.....	11
SHKOLLIMI I RINISË KOSOVARE: EDHE NJË GJENERATË E HUMBUR?.....	13
TRASHËGIMIA E VITEVE 1990-TA.....	14
NIVELI I KËNAQËSISË SË TË RINJVE ME ARSIMIN NË KOSOVË	17
MËSIMI PA LIBRA OSE PA KOMPJUTERË	18
MUNGESA E GJËRAVE THEMELORE	22
QËNDRIMET NDAJ ARSIMIT: TË VAZHDOHET APO TË MOS VAZHDOHET	27
URË DREJT SË ARDHMES APO GUR SHPOTITËS E PENGESË?	30
S’KA PUNË, S’KA PERSPEKTIVË	33
PAPUNËSIA: BRENGA MË E MADHE E TË RINJVE	34
ARSIMI NUK TË PËRGATIT PËR PUNË.....	38
NJERËZIT QË I NJOH.....	42
PËRGJIGJA E QEVERISË?	44
TË IKIM APO TË MOS IKIM!	45
INKURAJIMI I PJESËMARRJES SË TË RINJVE.....	47
ZHVILLIMI I GJENERATËS SË RE TË QYTETARËVE AKTIV: PJESËMARRJA NË FAMILJE	47
ETJA E TË RINJVE PËR TË MARRË PJESË NË PROCESET VENDIMMARRËSE	49
TEPËR PAK, TEPËR VONË!?	52
PËRPJEKJET E RINISË QË ZËRI I TYRE TË DËGJOHET.....	54
PËRMBUSHJA E PREMTIMEVE NË PRAKTIKË.....	57
TË RINJTË KOSOVARË BALLAFAQOHEN ME TË ARDHMEN E TYRE.....	59
E ARDHMJA IME ËSHTË E NDRITSHME?.....	59
KOSOVA NË SYTË E MI	61
MIGRIMI: SEFI I SIGURISË PËR TË RINJTË	62
‘KOSOVA: EVROPIANËT E RINJ’	65
FUSHAT PËR HULUMTIME TË MËTUTJESHME	69
ANNEX I. GRAFIKË NGA ANKETA E IKS-IT NË MBARË KOSOVËN	70
ANEKS II. PYETËSORI PËR TË RINJTË E MOSHËS 10-14 VJEÇARE	81
ANEKS III. PYETËSORI PËR TË RINJTË E MOSHËS 15-24 VJEÇARE.....	96
ANEKSI IV. GUIDA E DISKUTIMIT PËR FOKUS GRUPET	109
ANEKS V. PROJEKTET E FINANCUARA NGA BE	111

PARATHËNIE

Përafërsisht një e katërta e popullsisë së botës përbëhet nga të rinjtë e moshës 10 deri 24 vjeç. Kosova me 50 % të popullatës ndër 25 vjeç, njihet si vendi me popullsinë më moshën më të re në Evropë. Sidoqftë, pjesmarrja e të rinjëve në proceset vendim marrëse në të gjitha fushat mbetet një sfidë e madhe. Fakti që të rinjtë ndihen të përjashtuar nga debatet publike, ka shtyrë UNICEF-in të adresojë pjesmarrjen e të rinjëve duke angazhuar akterë dhe ministri të ndryshme në krijimin dhe implementimin e politikave më të mira përfshirëse sociale, duke ju dhënë prioritet të rinjëve. Pjesmarrja e të rinjëve në proceset vendim marrëse dhe ndryshimi shoqëror që vijon, mund të jetë një pjesë përbërëse e formimit të perspektivës për të ardhmen e Kosovës. Gjithsesi, në nivelin qendror dhe atë lokal, zëri i të rinjëve venitet para se të shkojë në vesh të duhur. Mobilizimi dhe fuqizimi i të rinjve duhet të jetë prioritet i insitucioneve të Kosovës, shoqërisë civile dhe akterëve për të arritur potencialin e plotë që të rinjtë përfaqësojnë në Evropë dhe më gjerë.

Studimi Zëri i të Rinjve të Kosovës që ju mbani në duar shfaq mendimet dhe eksperiencat e të rinjëve në Kosovë. Studimi paraqet sfidat dhe shpresat e të rinjëve për sistemin e arsimit, mundësitë e punësimit, perspektivën për të ardhmen, dhe shoqërinë kosovare në përgjithësi, duke theksuar rrethanat që pamundësojnë pjesmarrjen e tyre në jetën publike. Të rinjtë kanë shprehur irritimin e tyre për të ardhmen në lidhje me arsimin e dobët dhe papunësinë që pason, duke përfshirë edhe mungesën e materialeve për studim, stafin e pakualifikuar ose mungesën e metodologjisë bashkëkohore. Sidoqftë, të rinjtë shprehin dëshirat për të pasur mundësi që të kontribuojnë në mënyrë më aktive që të rregullojnë të tashmen dhe të ardhmen e Kosovës.

UNICEF do të vazhdojë të monitorojë dhe avokojë për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve në të gjitha vendet. Rekomandimet e nxjerra nga ky hulumtim empirik duhet të shërbejnë si udhëzues për akterët dhe politikbërësit për përkushtim më të madh në ndërtimin dhe formimin e një shoqërie aktive dhe të integruar për një të tashme dhe të ardhme më të mirë për të gjithë të rinjtë e Kosovës.



Johannes Wedenig
Shef i zyrës së UNICEF-it, Kosovë
Tetor 2010, Prishtinë

SHKURTESAT DHE AKRONIMET

ADA	Agjencioni Austriak për Zhvillim
PTAP	Programi i Tregut Aktiv të Punës
AUK	Universiteti Amerikan në Kosovë
CIDA	Agjencioni Kanadez për Zhvillim Ndërkombëtar
KQVR	Këshilli Qendror i Veprimit Rinor
EC	Komisioni Evropian
ESOMAR	Shoqata Evropiane për Hulumtim të Opinioneve dhe Tregut
ETF	Fondacioni Evropian për Trajnime
BE	Bashkimi Evropian
FSDEK	Përkrahja Finlandeze për Sektorin e Arsimit në Kosovë FSDEK
GDP	Prodhimi i Brendshëm Bruto
GTZ	Bashkëpunimi Teknik Gjerman
IKS	Iniciativa Kosovare për Stabilitet
ILO	Zyra Ndërkombëtare e Punës
KEC	Qendra për Arsim e Kosovës
PZHAK	Plani për Zhvillimin e Arsimit në Kosovë
PVFRK	Plani i Veprimit për Fuqizimin e Rinisë Kosovare
RRK	Rrjeti Rinor i Kosovës
KLVR	Këshilli Lokal i Veprimit Rinor
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MRKS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OJQ	Organizatat Joqeveritare
OBZH	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
QPP	Qendra për Punësim Publik
SHPP	Shërbimet e Punësimit Publik
SDC	Agjencioni Zvicëran për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SIDA	Agjencioni Suedez për Zhvillim Ndërkombëtar
ESK	Enti Statistikor i Kosovës
UNESCO	Organizata për Arsim, Shkencë dhe Kulturë e OKB-së
UNDP	Programi Zhvillimor i OKB-së

UNICEF	Fondi për Fëmijë i OKB-së
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USAID	Agjencioni Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar
USG	Qeveria e SH.B.A-ve
VET	Arsimi dhe Trajnimi Profesional

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Rreth gjysma e popullsisë së Kosovës është nën moshën 25-vjeçare dhe kjo e bën Kosovën shtetin më të ri në Evropë qoftë për kah moshë si dhe statusi i shtetësisë të saj të sapolindur. Arsimimi, fuqizimi dhe punësimi i të rinjve kosovarë mbetet njëra prej sfidave kyçe të Kosovës në rrugën e saj drejt integritimeve evropiane. Në vitin 2001, UNICEF-i zhvilloi *Hulumtimin e Opinioneve të Zërave të Rinj* për promovimin e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të rinjve duke iu ofruar mundësinë që mendimet, qëndrimet dhe brengat e tyre të dëgjohen dhe të ndahen me qeverinë, familjet dhe publikun e gjerë. Ky raport synon të identifikoj problemet dhe çështjet të cilat të rinjtë i shohin si prioritete.

Brengat dhe shpresat e të rinjve kosovarë kanë ndryshuar pak që nga vitin 2001 kur UNICEF-i për herë të parë zhvilloi *Hulumtimin e Opinioneve të Zërave të Rinj*. Para pothuajse një dekade, 43 përqind e të rinjve mendonin se Kosova do të bëhej vend më i mirë për të jetuar. Ata e donin vendin e tyre dhe 87 prej tyre dëshironin të jetonin në Kosovë. Ata shpresonin se do të përmirësohej standardi i jetesës, se do të zvogëloheshin problemet shoqërore dhe se gjendja politike do të përmirësohej.

Në vitin 2010, as ndihma e dhënë nga bashkësia ndërkombëtare e as shpallja e pavarësisë nuk e kanë përmirësuar perspektivën e të rinjve kosovarë. Kosova duhet të investoj më shumë në rininë e saj në mënyrë që të krijoj një ekonomi konkurruese në tregun e madh evropian. Investimet e para duhet të bëhen në sektorin e arsimit. Trashëgimia e viteve të 1990-ta, metodologjitë e vjetruara të mësimdhënies si dhe infrastruktura e mangët e kanë lënë rininë të zhgënjyer me sektorin e arsimit në Kosovë. Ndërlidhja e fortë në mes arsimit dhe punësimit dëshmon që sektori i qëndrueshëm dhe i fuqishëm i arsimit është kyç për uljen e papunësisë dhe varfërisë drejt stabilitetit më të madh shoqëror.

Kosova akoma ka ekonominë më të varfër në tërë Evropën Juglindore. Kjo ka ndikuar më së shumti të rinjtë nën moshën 25 vjeçar, papunësia e të cilëve arrin shkallën prej 73 përqind. Në një treg pune ku kërkesa për punë është edhe ashtu shumë e vogël, 95.5 përqind të të rinjve nuk kanë fare përvojë paraprake të punës. Edhe kjo ndikon negativisht në punësimin afatgjatë të të rinjve; 81.8 përqind prej tyre janë duke kërkuar punë që 12 muaj. Të papunët vuajnë edhe pasojat e informaliteteve si dhe të nepotizmit gjatë procedurave të punësimit. Në këto rrethana shumë të errëta, shumica e të rinjve mendojnë që shpërngulja në vende të tjera është mënyra më e mirë për ta përmirësuar jetën e tyre.

Ndikimi i të rinjve në proceset vendimmarrëse është akoma i kufizuar, për shkak të dy arsyeve: institucionet nuk ndejnë obligim t'i respektojnë të drejtat e të rinjve për pjesëmarrje në këto procese, dhe të rinjtë nuk e shohin pjesëmarrjen si detyrim qytetar. Mosinkuadrimi i të rinjve në proceset vendimmarrëse shumë lehtë mund të shkaktoj destabilizim në të ardhmen.

Në sytë e rinisë, kushtet ekonomike dhe sociale shërbyen si standarde për matjen e kualitetit të jetës në Kosovë. Njëlloj me të rinjtë e anketuar më herët, respondentët kësaj herë shpresojnë se gjendja ekonomike dhe standardi i jetesës në Kosovë do të përmirësohet. Në krahasim me të rinjtë e komuniteteve tjera, të rinjtë nga komuniteti serb u shprehën më pak të sigurtë për të ardhmen e tyre.

HYRJE

Për shkak të nivelit të lartë të papunësisë në mesin e të rinjve, punësimi është prioritet kyç për Kosovën.¹ Me rreth gjysmën e popullsisë së saj nën moshën 25-vjeçare², kjo e bën Kosovën shtetin më të ri në Evropë qoftë për kah mosha si dhe statusi i shtetësisë të saj të sapolindur. Rinia, si dhe burimet natyrore në vend, janë identifikuar si dy fuqi të shtetit të ri.³ Fuqia e re punëtore e Kosovës mund të jetë vlerë për popullatën e vjetër të Evropës si dhe është faktor vendimtar për shpresat e Kosovës për integrim evropian. Në fakt, Komisioni Evropian, në raportet e tij të progresit, si dhe Banka Botërore dhe USAID, kanë theksuar rëndësinë e punësimit dhe fuqizimit të rinisë.

Megjithatë, përkundër përkushtimit të zhurmshtëm të liderëve kosovarë për integrim evropian, rinisë i është kushtuar vëmendje minimale. Për shembull, në strategjinë 55-faqëshe të Qeverisë për prioritetet kombëtare 2008-2011, rinia është përmendur vetëm tetë herë.⁴ Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara në Raportin e Zhvillimit Njerëzor të vitit 2006, thotë që rinia kosovare ka pasur ndikim të vogël në institucionet vendimmarrëse për shkak të dy arsyeve: e para, institucionet nuk ndejnë obligim t'i respektojnë të drejtat e të rinjve për pjesëmarrje, dhe e dyta, të rinjtë nuk e shohin pjesëmarrjen e tyre si përgjegjësi qytetare.

Në vitin 2001, UNICEF zhvilloi *Hulumtimin e Opinioneve të Zërave të Rinj* për t'i promovuar mendimet dhe brengat e fëmijëve dhe të rinjve. Studimi përfshiu 400 fëmijë dhe të rinj të moshës 9-17 vjeçare. Në vitin 2004, UNICEF-i zhvilloi një hulumtim tjetër të opinionit me fokus në shëndetësi, arsim, punësim, zhvillim, mbrojtje dhe pjesëmarrje në shoqëri civile. Hulumtimi përfshiu 600 të rinj të moshës 9-25 vjeçare, si dhe një sërë fokus grupesh me rininë.

Ky raport mëton të vlerësoj mendimet, qëndrimet dhe brengat e të rinjve dhe t'i ndaj ato me qeverinë, hisedarët kyç dhe publikun e gjerë. Raporti bën krahasime me hulumtimet e mëhershme për rininë, aty ku është e nevojshme. Të dhënat dhe gjetjet e raportit do të përdoren nga UNICEF-i për hartimin e indikatorëve themelor dhe atyre të progresit, për ta frymëzuar hartimin e analizës përmbajtjesore të gjendjes së të rinjve; për ta monitoruar ndikimin e ndërhyrjeve programore të UNICEF-it dhe për ta forcuar monitorimin dhe vlerësimin e Planit të Veprimit për Rininë në Kosovë.

Zërat e të Rinjëve të Kosovës 2010, i financuar nga UNICEF-i dhe i implementuar nga ekipi i Iniciativës Kosovare për Stabilitet (IKS), përfshinë metoda të përziera të hulumtimit siç janë, sondazh në mbarë Kosovën me 1300 respondentë, intervista të hollësishme me të rinjtë anëmbanë Kosovës dhe 10 fokus grupe me të rinj të niveleve të ndryshme të shkollimit, përkatësisë etnike dhe zonave gjeografike. U zhvilluan edhe intervista të hollësishme me politikbërës, praktikantë, donatorë dhe hisedarë tjerë relevant.

Në këtë raport japatulli i parë merret me mendimet e të rinjve dhe vlerësimin e tyre për sistemin arsimor në Kosovë dhe funksionimin e tij. Kapitulli i dytë trajton mendimet e

¹ Komisioni Evropian (KE), *Kosova-Përmbushja e Perspektivës Europiane*, Bruksel, tetor 2009.

² U.S. Census Bureau, International Data Base, Population Pyramid Kosovo 2010. Kosova llogaritet të ketë 1,815,048 banorë, 864,170 (47.6 përqind) e të cilëve janë nën moshën 24 vjeçare. Në <http://www.census.gov/ipc/www/idb/country.php>.

³ Republika e Kosovës, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2009-2011, 12 qershor 2008. Prishtinë, f. 6.

⁴ Qeveria e Kosovës, *Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2008-2011*, Prishtinë, prill 2008.

të rinjve për mundësitë e punësimit në Kosovë; gatishmërinë e tyre për t'u futur në tregun e punës, si dhe ndërlidhjen në mes arsimit dhe punësimit. Kapitulli i tretë trajton pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe dispozitat institucionale për përfshirjen e të rinjve në këto procese. Kapitulli i katërt përqendrohet në perceptimin e të rinjve për jetën në Kosovë dhe vlerësimin e tyre mbi jetën në përgjithësi; mat gatishmërinë e tyre për t'u shpërngulur nga Kosova; si dhe prezanton mendimet e të rinjve kosovarë për të ardhmen e tyre dhe për integrim në Evropë.

REKOMANDIME

Arsimi

- Vërehet qartë qasja gjithëpërfshirës dhe përmbytjesore për të reformu sistemin arsimor. Mirëpo, kjo qasje kërkon investime gjithëpërfshirëse për një periudhë të konsiderueshme kohore. Përpjekjet aktuale duhet të shoqërohen me lidhshmëri të fuqishme, përfshirë këtu përkushtimin strategjik të qeverisë dhe buxhet më të madh për sektorin e arsimit.
- Bashkëndimi ndër-ministror është vendimtar për sinkronizimin e kërkesave të tregut të punës me mundësitë e sektorit të arsimit që ta furnizoj kërkesën për punë, posaçërisht për trajnime profesionale. MPMS duhet ta caktoj si prioritet identifikimin e aftësive që kërkohen në tregun e punës. Rrjedhimisht, këto nevoja duhet të pasqyrohen edhe në qasjen strategjike gjithëpërfshirëse të MASHT-it.
- Promovimi i shkëmbimit të obligueshëm me jashtë për studentë dhe mësimdhënës të shkollave terciare private dhe publike do ta shpejtoj procesin e reformave në arsim me anë të metodave të reja që përdoren nga vendet e tjera në rajon dhe në Evropë. Përveç kësaj, aftësitë dhe njohuritë e fituara gjatë semestrit të kaluar jashtë vendit do të kontribuonin në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në nivelin universitar.

Punësimi

- Infuzioni i fuqisë së re punëtore është thelbësor për zënien e vendeve të punës që lihen hapur nga popullata e vjetër e Evropës. Qeveria e Kosovës mund të nënshkruaj marrëveshje bilaterale me vendet e interesuara të BE-së për t'i identifikuar kërkesat e tregut të punës dhe për të hartuar programe për ofrimin e punës. Migrimi afatshkurtër mund të bashkërendohet, kontrollohet dhe rregullohet në mënyrë bilaterale. MPMS duhet ta marrë rolin udhëheqës në hartimin e këtij programi në emër të Qeverisë së Kosovës. Projekti i MPMS-së ishte i pari që hapi rrugën në këtë drejtim.
- Praksa e obligueshme, e mandatuar si pjesë e kurrikulit universitar, mund t'i përgatis më mirë të diplomuarit për tregun e punës. AUK është shembull i shkëlqyeshëm në këtë drejtim. Duhet të studiohet mundësia që të rinjtë ta mbajnë praksën me organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë. MASHT duhet të studioj edhe mundësi tjera për iniciimin e marrëveshjeve të praksës në mes universiteteve në Kosovë dhe atyre në rajon.
- Uebportalet, ku të rinjtë mund t'i prezantojnë CV-të e tyre dhe punëdhënësit mund të lajmërojnë vende të lira të punës, mund të shërbejnë si lidhje në mes kërkesave të tregut të punës dhe aftësive ekzistuese. Kjo praktikë është treguar shumë e suksesshme në vendet tjera. Ajo mund të ndihmojë në zvogëlimin e joformaliteteve gjatë proceseve të përzgjedhjes dhe rekrutimit. Të rinjtë në mbarë Kosovën do

të kishin qasje në këtë uebfaqe. Këtë projekt mund të inicioj MPMS-ja në bashkëpunim të ngushtë me bizneset.

Pjesëmarrja

- Në mënyrë që ta dëshmojnë përkushtimin e tyre për ‘Evropianët e Rinj,’ Kryeministri dhe Qeveria e Kosovës duhet ta shpallin vitin 2011 ‘Vit të Rinisë.’ Kjo pastaj duhet të përkthehet edhe në vepra, përfshirë linja të shtuara buxhetore për lehtësimin e pjesëmarrjes së rinisë dhe stimulimin e aktivizmit të tyre. Një vendim i tillë në nivel kombëtar do të ndikoj edhe në nivelin komunal.
- Drejtorët e shkollave duhet të gjejnë mënyrat për inkurajimin e pjesëmarrjes dhe aktivizmit të nxënësve. Ata mund t’i identifikojnë interesat dhe mendimet e të rinjve për të ardhmen e tyre, nëpërmjet rrjeteve sociale në kompjuter, të cilat janë shumë të popullarizuara në mesin e të rinjve.

Perspektiva e së ardhmes

- Iniciativa për hapjen e më shumë qendrave të informimit për Bashkimin Evropian dhe qendrave kulturore në vendet jashtë Prishtinës duhet të jetë më e madhe. Në fakt, edhe BE edhe qeveria e Kosovës duhet të shfrytëzoj pozicionimin pozitiv të të rinjve karshi inkudarimit në BE. Me anë të këtyre qendrave, BE dhe qeveria e Kosovës do të mund të organizonin kurse të detyrueshme, në informimin sa më të mirë të nxënësve në shkollat e mesme për institucionet dhe vlerat e BE-së, subjekt që do të bënte pjesë në shkenca sociale.

METODOLOGJIA

Të gjeturat e paraqitura në këtë raport rezultojnë nga përzjerja e metodave të hulumtimit dhe përfshijnë të dhëna kuantitative dhe kualitative. Rishikimi fillestar i literaturës dëshmoi mungesën e të dhënave të sakta dhe aktuale të cilat do të ndihmonin në përmbushjen e objektivave të hulumtimit, siç janë vlerësimi i mendimeve, qëndrimeve dhe brengave të të rinjve dhe ndarja e tyre me qeverinë, hisedarët kyç dhe publikun e gjerë. Prandaj, IKS ka përdorur disa metoda, burime të të dhënave dhe hulumtues për triangulum, për ta shtuar besueshmërinë dhe vlefshmërinë e të gjeturave.

Burimi primar i të dhënave ishte hulumtimi në mbarë Kosovën me 1,300 të rinj të moshës 10-24 vjeçare. U përdor procesi i shpërpjesëtuar, shumëfazor dhe i rastësishëm i mbledhjes së mostrave. Mostrat shtresoheshin sipas komunës, moshës dhe përkatësisë etnike. UBO Consulting u ngarkua me zhvillimin e intervistave të strukturuar sy-në-sy, të cilat u zhvilluan gjatë periudhës 29 mars – 7 prill 2010. U përdorën dy hulumtime të ndryshme për të vlerësuar mendimet dhe brengat e të rinjve të moshës 10-14 vjeçare dhe 15-24 vjeçare. Intervistat u zhvilluan në përputhje me ‘udhëzimet për Intervistimin e Fëmijëve dhe të Rinjve’ lëshuar nga Shoqata Evropiane për Hulumtim të Opinioneve dhe Tregut (ESOMAR)⁵ në vitin 1999. Sipas këtyre udhëzimeve, të gjithë fëmijët u intervistuan në gjuhën e tyre dhe në shtëpitë e tyre me lejen e prindërve apo kujdestarëve të tyre. Megjithatë, intervistuesi e zhvillonte intervistën vetëm me prezencën e fëmijës për të inkurajuar këtë të fundit që të përgjigjet lirë dhe me sinqeritet. Të gjithë hulumtuesit në terren kanë kaluar trajnimin njëditor me një psikolog të specializuar.

Siç ilustron Figura 1, 900 shqiptarë, 200 serb dhe 200 respondentë të komuniteteve tjera etnike, përfshirë këtu turq, goranë, boshnjakë, romë, ashkali dhe egjiptas, morën pjesë. UBO Consulting kontrolli të dhënat nëpërmjet skenimit 35 përqindësh; i futi të dhënat në SPSS dhe zhvilloi kontroll të konsistencës apo lidhjes logjike. Analiza e të dhënave përfshiu statistika përshkruese si dhe regresion me interval të besueshmërisë prej 95 përqind. Vëmendje e posaçme iu kushtua variablave siç janë mosha, gjinia, rajoni dhe përkatësia etnike.

Hulumtimi i të dhënave kuantitative u shoqërua me intervista të hollësishme me të rinj dhe me diskutime në dhjetë grupe me nxënës të shkollave të mesme, studentë të universiteteve, persona që kërkojnë punë dhe me të rinj të punësuar. Grupet e fokusit u mbajtën në Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Dragash, Mamushë, Graçanicë dhe Mitrovicë. Intervistat e hollësishme me të rinjtë si agjentë kyç ishin karakteristikë defnuese e metodologjisë hulumtuese, siç dëshmon edhe përdorimi i civateve dhe anekdotave. Raportin e pasuruan edhe më shumë intervistat me më tepër se 50 politikbërës, donatorë ndërkombëtarë, organizata dhe qendra rinore. Këto intervista vlerësuan iniciativat dhe programet ekzistuese që synojnë fuqizimin, shkollimin, punësimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse.

⁵ The European Society for Opinion and Marketing Research (ESOMAR) është organizata botërore që mundëson hulumtime më të mira të tregut, konsumatorëve dhe shoqërive. ESOMAR promovon vlerën e hulumtimit të tregut dhe opinionit për të hedhur dritë mbi çështjet reale dhe vendosjen e vendimmarrjes efektive në një nivel global. Misioni i ESOMAR është promovimi i standardeve më të larta në hulumtim të tregut për përmirësimin e vendimmarrjes në sektorët publik dhe privat. Për më shumë informata, shih: www.esomar.org.

Triangulimi u përdor për identifikimin e temave të përbashkëta dhe u hetuan të gjeturat që në dukje ishin kundërthënëse. Ekipi i IKS-it analizoi të dhënat kuantitative dhe kualitative dhe përmbledhi të gjeturat në katër kapituj të raportit. IKS prezantoi të gjeturat preliminare në një punëtori me hisedarë kyç në fushën e arsimit, punësimit dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje, dhe pastaj futi amendamentet dhe sugjerimet e caktuara në këtë raport.

Figura 1. Mostra e Demografisë

Madhësia totale e mostrës: n = 1300			
	Njësia	Përqindja	Frekuenca
Gjinia	Meshkuj	50.7%	658
	Femra	49.3%	642
Mosha	10-14 vjeçar	34%	444
	15-24 vjeçar	66%	856
Përkatësia etnike	Shqiptar	69.6%	900
	Serb	15.5%	200
	Tjerët*	14.9%	200
Rajoni	Prishtinë	24%	313
	Pejë	14%	182
	Prizren	18%	230
	Gjilan	12%	167
	Gjakovë	5%	61
	Mitrovicë	16%	208
	Ferizaj	11%	139

* ‘Tjerët’ përfshijnë romët, ashkalijtë, egjiptasit, goranët, boshnjakët dhe turqit.

SHKOLLIMI I RINISË KOSOVARE: EDHE NJË GJENERATË E HUMBUR?



'Arsimi është ura e tyre me botën.'
- Alyssa Milano, Ambasadore e Vullnetit të Mirë e UNICEF-it

Fëmijët në Kosovë e punuan këtë pikturë për Alyssa Milanon, Ambasadore e Vullnetit të mirë e UNICEF-it, e cila vizitoi Kosovën në Ditën e Fëmijëve në vitin 2010. Libri i hapur përfaqëson burimin e arsimit dhe njohurisë, nga i cili lulet e kuqe (fëmijët e Kosovës) rriten në botë. Piktoret, fëmijë kosovarë, janë lindur pas vitit 1999 dhe nuk e kanë fare në kujtesën e tyre konfliktin. Ata shikojnë drejt të ardhmes më të mirë dhe janë të etur ta ndryshojnë Kosovën. Për këtë arsye, arsimi është 'ura e tyre me botën.'

Në vitin 2010, rreth gjysma e popullsisë së Kosovës është nën moshën 25 vjeçare, dhe rreth 54 përqind prej tyre janë të regjistruar në sistemin arsimor.⁶ Shpresa të mëdha janë vu për arsimin si shtyllë e zhvillimit ekonomik dhe progresit, mirëpo problemet janë akoma prezente.⁷ Siç thuhet në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian, sistemi arsimor i Kosovës vazhdon të jetë nën ndikimin e burimeve të pamjaftueshme, hapësirave joadekuate (përshirë këtu shërbimet themelore sanitare dhe ujën e pijshëm), cilësinë e dobët të mësimdhënies dhe nivelin e ulët të vijimit të mësimi (më e ulët se mesatarja rajonale). Në nivelin komunal, zbatimin e Ligjit për Arsimin e kanë penguar kapacitetet e pamjaftueshme financiare dhe administrative të drejtorive komunale të arsimit.⁸ Të ballafaquar me të gjitha këto sfida, a do të jenë *Evropianët e Rinj*⁹ të Kosovës në gjendje t'i përmbushin ëndrrat e tyre dhe të bëhen katalizator të ndryshimeve sociale dhe ekonomike?

Ky kapitull fillimisht trajton mënyrën si trashëgimia e viteve 1990-ta ka ndikuar në cilësinë e arsimit në Kosovë. Pas vështrimit të nivelit të kënaqësisë në mesin e të rinjve me sektorin e arsimit, kemi diskutuar çështjet siç janë materialet mësimore,

⁶ Kalkulim i IKS-it duke përdorur të dhënat nga Enti Statistikor i Kosovës për vijimin total në mësim (469,631 vijues) në të gjitha nivelet si dhe numri mesatar i të rinjve nën moshën 25 vjeçare në Kosovë (865,170), sipas U.S. Census Bureau, *International Data Base, Population Pyramid Kosovo 2010*, <http://www.census.gov/ipc/eeë/idb/country.php>. Regjistrimi i fundit i popullsisë në Kosovë u mbajt në vitin 1981, prandaj nuk ka të dhëna të sakta për numrin e popullsisë.

⁷ Qeveria e Kosovës, *Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2008-2011*, Prishtinë, prill 2008.

⁸ Komisioni Evropian, Raport i Progresit për Kosovën nën Rezolutën 1244/99 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për vitin 2009, Bruksel, tetor 2009.

⁹ 'Kosova: Evropianët e Rinj' është slogani i fushatës promovionale për Kosovën të financuar nga qeveria dhe të lançuar më 26 tetor 2009. Fushata u transmetua në gjashtë stacione televizive në Evropë dhe në SHBA, përfshirë këtu në CNN, BBC, Euroneës, Bloomberg dhe Eurosport, dhe synonte promovimin e Kosovës së komb i ri, duke u përqëndruar në fuqinë e rinisë së saj.

mësimdhënësit dhe infrastruktura e klasave. Në fund, kemi bërë rekomandime për përmirësimin e sektorit të arsimit.

Trashëgimia e viteve 1990-ta

Në vitin 2008, Qeveria e Kosovës e identifikoi edukimin si njëri nga '4 E-të,' sektorët prioritar për zhvillimin e Kosovës: Ekonomia, Energjia, Edukimi dhe Evropa. Megjithatë, sistemi i arsimit mbetet njëra prej dobësive më të mëdha të Kosovës. Për afro 20 vite, sistemi arsimor në Kosovë ka qenë në gjendje emergjente dhe ofronte vetëm gjërat më bazike. 'Edhe sot e kësaj dite nuk mund të flasim për reforma,' thotë Lida Kita, eksperte në sistemin arsimor të Kosovës e Fondacionit Evropian për Trajnime. 'Ne ende flasim për prioritete.'¹⁰ Arsimi i pamjaftueshëm i mësimdhënësve, metodologjitë e vjetruara të mësimdhënies, mungesa e hapësirës, shkollat e stërngarkuara, orët e shkurtuara të mësimin dhe pagat e ulëta e kanë dobësuar cilësinë e arsimit.

Këto probleme janë pjesërisht rezultat i trashëgimisë së dekadave të diskriminimit dhe shkatërrimit të shkollave gjatë periudhës së konfliktit. Pas abrogimit të autonomisë vendimmarrëse të Kosovës në sektorin e arsimit në vitin 1989, autoritetet serbe detyruan rreth gjysmë milioni të rinj shqiptarë ta braktisin sistemin formal të arsimit. Si rezultat, autoritetet shqiptare krijuan sistemin paralel të arsimit.¹¹ Në vitin 1991, shkollimi i mesëm u zhvillua pothuajse në tërësi në shtëpi private pasi që vetëm 6,000 vende ishin në dispozicion për 36,000 nxënës shqiptarë që përfundonin shkollën fillore.¹² Në vitin 1992, studentët shqiptarë ishin përjashtuar plotësisht nga shkollat në Kosovë. Qindra mësimdhënës shqiptarë u përjashtuan nga vendet e tyre të punës. Të gjithë ligjëruesit e Universitetit të Prishtinës, që nuk pranuan të japin mësim sipas planprogramit të ri i cili parashihte përdorimin e gjuhës serbe si gjuhë e vetme gjatë mësimdhënies, u konsideruan se 'kishin dhënë dorëheqje nga vendi i punës.'¹³ Shumica e kuadrove dhe studentëve shqiptarë u përjashtuan nga Universiteti i Prishtinës.¹⁴

Nga viti 1989 deri në vitin 1999, sistemi paralel i arsimit në gjuhën shqipe u mundua të mbijetoj. Në vitin 1995, sistemi i cili vuante nga kufizimet e shumta kishte 386,511 nxënës.¹⁵ Mësimi mbahej në klasë të improvizuara në shtëpi dhe garazhe private. Hartimi dhe shtypi i librave shkollor ishte i ndaluar në Kosovë prandaj disa materiale mësimore kontrabandoheshin nga Shqipëria. Librat e tjerë shtypeshin në mënyrë ilegale në Kosovë, por nuk arrinin të pasqyronin zhvillimet e reja në shkencë dhe teknologji.¹⁶ Mësimdhënësit e pakualifikuar vullnetar zbatonin planprograme të vjetruara. Në vitin 1996, numri i nxënësve u përgjysmua si rezultat i infrastrukturës joadekuate dhe ngacmimit nga ana e serbëve.¹⁷ Pastaj, gjatë konfliktit të periudhës 1998-1999 u

¹⁰ Intervista e IKS me Lida Kita, Fondacioni Evropian për Trajnime, 1 korrik 2010.

¹¹ Në mars të vitit 1990, Beogradi miratoi 'Masat e Përkohshme' që përfshinin 'Programin për Arritjen e Paqes, Lirisë dhe Prosperitetit në Krahinë Socialiste Autonome të Kosovës', dhe 'Ligjin për Aktivitetet e Organeve të Republikës në Rrethana të Jashtëzakonshme'. Masat e Përkohshme çuan në suspendimin e Parlamentit Krahinor, abrogimin e kontrollit autonom të Kosovës në arsim dhe zyrtarizimin e gjuhës serbe si gjuhë e vetme në sistemin arsimor (Sommers & Buckland, *Botët Paralele: Rindërtimi i Sistemit Arsimor në Kosovë*: UNESCO, 2004, f. 42).

¹² Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), *Rishikim Tematik i Politikave Kombëtare të Arsimit – Kosovë*, qershor 2001.

¹³ Alva et al., 2002, në Sommers & Buckland, 2004.

¹⁴ Bellamy, A., 'Gabimet Njerëzore në Kosovë: 1974-99', *Zhurnal Ndërkombëtar i të Drejtave të Njeriut*, 2000, 4 (3), ff. 105-126.

¹⁵ Bache, J. & Taylor, A. 'Politika e Politikës së Rezistencës: Rindërtimi i Arsimit të Lartë në Kosovë.' *Journal of Public Policy*, 2003, 23 (3), ff. 279-300.

¹⁶ Sommers & Buckland, *Botat Paralele: Rindërtimi i Sistemit Arsimor në Kosovë*: UNESCO, 2004, f. 42.

¹⁷ OECD, *Rishikimi Tematik i Politikave Kombëtare të Arsimit – Kosovë*, qershor 2001.

shkatërruan gjysma e shkollave; rreth 17 përqind e shkollave u dëmtuan, dhe shumica prej tyre nuk kishin ujë të pijshëm dhe mjete sanitare.

Përkundër faktit se deri në vitin 2010 janë rindërtuar 110 shkolla,¹⁸ shumë fëmijë akoma vijojnë mësimet në klasë të tejngarkuara në ndërrime të mëngjesit, pasdites e nganjëherë edhe të mbrëmjes. Në vitin 2007, rreth 70 shkolla akoma zbatuan orarin me tri ndërrime, përkundër faktit që ky sistem ishte aplikuar si nevojë e pashmangshme në periudhën pasluftës. Shumica e shkollave të tjera kishin dy ndërrime.¹⁹ Shkollat që mbanin mësim në tri ndërrime u detyruan t'i shkurtrojnë orët mësimore prej 45 në vetëm 35 apo 40 minuta. Kjo ka ndikuar negativisht në cilësinë e shkollimit të të rinjve. Milot një student 22 vjeçar rikujton:

Ne ishim shumë nxënës në shkollën e mesme. Ishte e pamundur për mësuesin të merret me secilin prej nesh individualisht. Ne nuk mund të bënim ndonjë prezantim; të shkruajmë ese dhe të mësojmë shumë gjëra të tjera që janë të rëndësishme ti njohim në botën moderne.²⁰

Në vitin 2010, numri i shkollave me tri ndërrime u zvogëlua në 20 sosh.²¹ Megjithatë, shkollat tjera vazhdojnë të punojnë me dy ndërrime. Kështu, orët e shkurtuara të mësimt janë ende realitet në shumë shkolla të Kosovës. Hapësirat e pamjaftueshme, një problem që po pengon kualitetin në arsim, dhe në shumicën e fakulteteve në Universitetin e Prishtinës numri i madh i studentëve vazhdon të jet penges

Që nga fundi i vitit 2001 dhe në pajtim me Kornizën e Planprogramit të Ri,²² sistemi arsimor i Kosovës ka kaluar nëpër procesin e reformave që parashohin nëntë vite të shkollimit të obligueshëm sipas Procesit të Bolonjës:²³ pesë vite të shkollimit fillor dhe katër vite të shkollimit të ulët të mesëm. Pas nëntë viteve të para, nxënësit mund të vijojnë ose shkollimin e përgjithshëm të mesëm që zgjat katër vite dhe i përgatit studentët për universitet, ose shkollimin profesional të mesëm i cili zakonisht zgjat tri vite. Shkollimi i mesëm i lartë pritet të bëhet i obligueshëm në fillim të vitit 2011. Është e rëndësishme të përmendet që plan programi i ri ka dallim të madh në spektrin e arsimimit dhe shkollimit, ndryshimi nga fokusi i përmbytjes në orientim në mësim dhe mundësisë në qasje është mundësuar me vendimin e Ministrit aktual të Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Legjislacioni i miratuar pas shpalljes së pavarësisë është në favor të reformave të mëtutjeshme në sektorin e arsimit. Ky legjislacion parasheh strukturë të re të sistemit arsimor; kryesisht një aranzhim të ri institucional dhe zhvillim të mëtutjeshëm të planprogramit. Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-u) i ka bartur të gjitha kompetencat në fushën e arsimit tek Qeveria e Kosovës. Përveç kësaj, Ligji për

¹⁸ Të dhënat për investimet e MASHT-it në infrastrukturën e shkollave nga 2004 deri në 2010 u morrën nga Departamenti për Infrastrukturë dhe Shërbime Teknike, shtator 2010.

¹⁹ Lida Kita, *HDR Analizë e Vendit - Kosovë*, punim i ETF, maj 2008.

²⁰ Intervista e IKS me Milot Rexhepin, student i shkencave politike, Prishtinë, 9 prill 2010

²¹ Të dhënat e MASHT-t dhe puna në terren e CHF International. Email korrespondenca me Valbona Dushin, menaxhere e marrëdhënieve me partnerë, CHF International, 17 shtator 2010.

²² Departamenti për Arsim dhe Shkencë, UNMIK, (DASH), 'Dokument për diskutim mbi Kornizën e Re të Kurrikulit për Kosovë,' Prishtinë, shtator 2001.

²³ Procesi i Bolonjës është proces i reformave evropiane me synim të themelimit të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë deri në vitin 2010. Deklarata e Bolonjës, qershor 1999, ka vënë në lëvizje një sërë reformash që nevojiten për ta bërë Arsimin e Lartë Evropian më të përputhshëm dhe krahasueshëm, më konkurrues dhe më joshës për evropianët dhe për studentët e studiuës nga kontinentet tjera. <http://www.ehea.info>

Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës²⁴ dhe Ligji për Qeverisje Lokale²⁵ kanë hedhur bazat për bartjen e kompetencave nga niveli qendror tek autoritetet komunale. Në praktikë, kjo do të thotë që Drejtorati komunal i arsimit e bën përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave dhe stafit administrativ.

Megjithatë, disa vëzhgues të sistemit arsimor pohojnë se kjo nuk është e mjaftueshme. Siç thotë një ekspert i arsimit, udhëheqësia e dobët në nivelin qendror nënkupton mungesë të bashkërendimit ndërministror për zbatimin e reformave: ‘Qeveria duhet të bashkërendoj, dhe bashkërendimi ndërministror duhet ta ketë një zë. Mbetet akoma shumë për t’u bërë në këtë drejtim.’²⁶

Në vitin 2008 dhe 2009, donatorët shfaqën interesim për ta përkrahur zhvillimin e sistemit arsimor. Projekti për qasje gjithëpërfshirëse në sektorin e arsimit (SWAP) u lançua në maj të vitit 2010 nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ECLO). Projekti në vlerë prej 3 milion euro, i financuar nga BE-ja, synonte të kontribuonte në përmirësimin e menaxhimit dhe cilësisë së sistemit arsimor. Projekti planifikonte ‘të përkrah hartimin e kurrikulit dhe zhvillimin e trajnimeve për mësimdhënës në Kosovë.’ Ai poashtu synonte ta përkrahte MASHT-in dhe Departamentet Komunale të Arsimit në mbarë Kosovën ‘për t’i përmirësuar sistemet e planifikimit, zbatimit dhe vlerësimit të arsimit në të gjitha nivelet e qeverisjes.’²⁷

Me përkrahje financiare nga Agjencioni Suedez për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) nëpërmjet Projektit për Zhvillim të Kapaciteteve dhe Reforma në Arsim, MASHT-i në kohën kur u hartua ky raport ishte në fazën e mapimit të donatorëve ‘për ta futur këtë informatë në Planifikimin Strategjik të MASHT-it.’²⁸

Deri më sot, shumë donatorë të tjerë e kanë ndihmuar sektorin e arsimit në Kosovë. Banka Botërore (BB) është përkrahësi më i gjatë i sektorit arsimor në Kosovë, duke e financuar këtë sektor që nga viti 1999. Projektet e financuara nga BE-ja arrijnë shumën totale prej 76.6 milion euro për periudhën 2004-2009.²⁹ Qeveria e Shteteve të Bashkuara ka financuar projekte në arsim dhe në sektorin e rinisë në vlerë rreth 19 milion dollarë në periudhën 2000-2008. Përveç kësaj, qeveria amerikane ka ndarë rreth 13 milion dollarë për vitin fiskal 2011 (01 tetor 2010 – 30 shtator 2011) për arsim, aktivitete rinore dhe rindërtim të shkollave.³⁰ Agjencioni Kanadez për Zhvillim Ndërkombëtar (CIDA), Danida daneze, Agjencioni Zhvillimor Austriak (ADA), GTZ-ja gjermane, Agjencioni Zvicëran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), qeveria Norvegjeze, UNICEF-i dhe agjencitë e tjera të Kombeve të Bashkuara poashtu kanë kontribuar vazhdimisht, kryesisht me anë të granteve.

Tash shpresohet që bashkërendimi i donatorëve, që ka qenë sfidë deri vonë, do të ndihmojë në shmangien e projekteve të dyfishta nga donatorët e ndryshëm. MASHT, me

²⁴ Ligji për Arsim në Komunitet, Ligji Nr. 03/L-068; Republika e Kosovës, 2008, Neni 4.

²⁵ Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Ligji Nr. 03/L-040, Republika e Kosovës, 2008.

²⁶ Intervista e IKS me Dukagjin Pupovcin, Drejtor i Qendrës për Arsim të Kosovës (KEC), 3 qershor 2010.

²⁷ Komunikatë për shtyp e Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian, *Masat përkrahëse të BE-së për promovimin e arsimit cilësor në Kosovë*, 27 Maj 2010, <http://www.delprn.ec.europa.eu/?cid=2.103.873>.

²⁸ Intervista e IKS me Lovisa Ericson, zyrtare e programit për arsim të SIDA, 17 Qershor 2010; IKS e-mail korrespondencë me Lovisa Ericson, zyrtare e programit për arsim të SIDA, 18 gusht 2010.

²⁹ Intervista e IKS me Sophie Beaumont, manaxhere e programit për arsim në Zyrën Ndërlidhëse të KE-së, 24 Gusht 2010. Për më tepër hollësi shih Tabelën 4 në Shtojcën V.

³⁰ IKS e-mail korrespondenca me Inez Andrews, këshilltare e lartë në USAID për Arsim dhe Rini, 30 Korrik 2010.


përkrahjen e SIDA-së, do ti harmonizoj iniciativat e donatorëve dhe do të akomodoj burimet financiare dhe njerëzore sipas nevojave dhe kërkesave në terren. Megjithatë, në këtë drejtim duhet bërë më shumë pasi që shumë donatorë kanë theksuar kapacitetet e dobëta të MASHT-it dhe numrin e kufizuar të stafit.

Niveli i kënaqësisë së të rinjve me arsimin në Kosovë

Shumica e të rinjve kosovarë e njohin vlerën e shkollimit. Arsyt më të shpeshta për shkollim që respondentët 15-24 vjeçar përmenden në hulumtimin e IKS-it ishin ‘zhvillimi individual’ dhe t’i bëjnë familjet e tyre të ndihen krenare (84.2 përqind u pajtuan me secilën deklaratë).

Të pyetur për nivelin e përgjithshëm të kënaqësisë me cilësinë e arsimit, shumica e respondentëve u përgjigjen se janë ‘të kënaqur’: 89.4 përqind të respondentëve 10-14 vjeçar, 74 përqind 15-19 vjeçar, dhe 61.1 përqind 20-24 vjeçar. Siç shihet në Grafikon 1.1, niveli i përgjithshëm i kënaqësisë duket se shënon rënie me moshë dhe me nivelet korresponduese të arsimit fillor, të mesëm dhe terciar.

Grafiku 1.1 Niveli i përgjithshëm i kënaqësisë së të rinjve me cilësinë e arsimit, sipas moshës



Vërehet marrëdhënia statistikisht e rëndësishme në mes përkatësisë etnike dhe kënaqësisë së përgjithshme me cilësinë e arsimit.³¹ Mesatarisht, shqiptarët ishin më të kënaqur se grupet e tjera etnike. Më konkretisht, respondentët serb ishin më pak të kënaqur se të rinjtë tjerë me tavolinat, ulëset dhe pajisjet tjera në klasë, si dhe me higjienën dhe ngrohjen.³²

Përkundër kënaqësisë së përgjithshme të rinjve me cilësinë e arsimit, hulumtimet më specifike dhe intervistat më të hollësishtme dëshmojnë pakënaqësi me disa elemente të sistemit arsimor, siç shihet më hollësisht në seksionet vijuese.

³¹ Statistikisht e rëndësishme në nivelin pesë përqind të rëndësisë ($p < 0.001$).

³² Ekziston marrëdhënie statistikisht e rëndësishme në nivelin pesë përqind të rëndësisë ($p < 0.001$).

Mësimi pa libra ose pa kompjuterë

Korniza e Planprogramit të Kosovës, që daton nga viti 2001, promovon planprogram shkollor që mbetet i bazuar në lëndë e jo në aftësi.³³ Prandaj, sistemi arsimor ka mësuar shumë pak ose fare hiç aftësi që do t'iu ndihmonin të rinjve të kalojnë nga arsimi në punësim, siç janë zgjidhja e problemeve apo puna ekipore. Në fakt, më tepër se gjysma (52.8 përqind) e respondentëve 15-24 vjeçar mendojnë që planprogrami shkollor është i vjetruar dhe nuk mund të aplikohet në praktikë. Ngjashëm me këtë, 63.7 përqind mendojnë që mësimi është shumë teorik dhe ka fare pak orientim praktik. Për shembull, Berti, 10-vjeçar nga Prishtina i etur për dituri, shpjegon:

Mezi pres të shkoj në shkollë. Por nganjëherë më merr gjumi në klasë sepse veçmë i di gjërat që i shpjegon mësuesja. Mësuesja pastaj e thërret nënën time dhe i tregon që unë shoh ëndrra gjatë orës së mësimit. Mezi pres të shkoj në klasë të pestë dhe të mësoj fizikë. Babai im gjen uebfaqe në internet ku unë lexoj për gravitetin dhe shumë gjëra tjera.³⁴

Planprogrami i vjetruar është në kontrast të thellë me një pjesë të rinisë të zhvilluar teknologjike të Kosovës. Millani, student 21-vjeçar i Artit në Universitetin e Mitrovicës, thotë që vijimi i klasave nuk mjafton:

Unë studioj dizajn Grafik, që është drejtim i ri dhe shumë i ndërlidhur me teknologjinë. Profesorët e mi janë të moshuar dhe programet e tyre për këtë lëndë me siguri datojnë nga vitet e 90-ta. Kam fat që kam internet dhe mund të hulumtoj vet. Planifikoj të shkoj në Beograd pas diplomimit në mënyrë që të vijoj disa kurse kryesore të cilat nuk i kam këtu.³⁵

Për Bertin dhe shokët e tij të klasës, një grup i djelmohave energjik 10-vjeçar, sistemi arsimor i Kosovës nuk mund ta zë ritmin e dëshirës së tyre për të mësuar. 70 përqind prej tyre përdorin kompjuterin me internet në shtëpi.³⁶ Në anën tjetër, shumë pak shkolla i përdorin metodologjitë bashkëkohore të mësimit.

Edhe pse shumë shkolla kanë laboratorë kompjuterike, jo të gjithë nxënësit kanë pasur rastin t'iu përdorin ato. Driloni, nxënës 17-vjeçar i gjimnazit në Gjakovë, shpjegon që shkolla e tij rishtazi është pajisur me kompjuterë: 'Më herët kemi pasur Pentium 1, kompjuterët më të dobët të të gjitha kohërave. Mezi i mësonim programet më të lehta siç janë Wordi, e të mos flasim për diçka tjetër. Ende nuk kemi internet edhe pse kjo është shumë e nevojshme.'³⁷ Gentiana, nxënëse 18-vjeçare në Shkollën e Lartë Teknike në Prizren, ankohet që të vetmin kompjuter në shkollën e saj e përdorin 30 nxënës.³⁸

Mësimdhënësve ju mungojnë edhe materialet dhe pajisjet për metodologjitë më përfshirëse dhe të ndryshme të mësimdhënies. Për shembull, gjatë trajnimeve të organizuara nga Qendra për Arsim e Kosovës, mësimdhënësit u inkurajuan të përdorin ushtrime të kuptuarit nëpërmjet dëgjimit. Megjithatë, një profesor i gjuhës angleze

³³ Departamenti për Arsim dhe Shkencë, UNMIK, (DASH), 'Dokument për diskutim mbi Kornizën e Re të Kurrikulit për Kosovë', Prishtinë, shtator 2001.

³⁴ Intervista e IKS me Bertin, Prishtinë, 9 Prill 2010.

³⁵ Fokus grupi i IKS me të rinj nga komuniteti serb në Graçanicë, 12 maj 2010.

³⁶ Hulumtimi i IKS 'Zërat e Rinj – Kosovë' 2010.

³⁷ Fokus grupi i IKS me nxënës të shkollës së mesme dhe shkollave profesionale në Gjakovë, 29 prill 2010.

³⁸ Fokus grupi i IKS me nxënës të shkollës së mesme dhe shkollave profesionale Prizren, 28 prill 2010.

shpjegoi se nuk kishte diktafon apo ndonjë mjet tjetër audio-vizual për t'i aplikuar teknikat e mësimdhënies bashkëkohore të cilat i kishte mësuar.³⁹

Në mungesë të teksteve shkollore në shkollat e mesme profesionale, studentët thanë që mësimdhënësit vazhdojnë t'i diktojnë mësimet. Ata shumë rrallë ligjëronin për mendimin kritik apo jepnin detyra për t'u zgjidhur. 'Ne mësojmë vetëm teori; nuk kemi fare praktikë,' ankohet Dona, studente 18-vjeçare. Shoku i saj, Buraku, pajtohet, 'Në vend se të zgjidhim ushtrime, ata na diktojnë mësimet; nuk kemi libra.'⁴⁰ Një vajzë 18-vjeçare nga Shkolla e Lartë Teknike në Prizren shpjegon:

Nuk kemi libra. Jemi të ndarë në dy grupe sepse jemi 29 nxënës në një klasë dhe 15 nxënës mbajnë një orë të mësimet dhe pastaj 14 të tjerët e mbajnë mësimin në orën e dytë. Arkitektura si degë ka nevojë për hapësirë. Nuk jemi aspak të kënaqur me metodat e ligjërimit; profesori flet dhe ne shkruajmë.⁴¹

Nxënësit e tjerë të shkollave profesionale në Prizren shprehën brengat e njëjta. Një nxënës i Shkollës së Mesme të Ekonomisë dhe Drejtësisë u ankua për injorimin e kërkesave të nxënësve për libra:

Ne degën time kemi libra vetëm për gjysmën e kurseve. Në gjysmën tjetër të kurseve përdorim shënime që i diktojnë arsimtarët. Që katër vite e kemi këtë problem. Jemi ankuar por asgjë nuk u ndërmor. Një profesor e ka shkruar librin e vet, i cili është licencuar nga Ministria e Arsimit, derisa të tjerët fare nuk çajnë kokën. Ata marrin shënime nga interneti ose zot e di prej ku.⁴²

Gjendja me librat duket se është edhe më e keqe për komunitetet pakicë. Dega e mjekësisë në Shkollën e Mesme Ataturk në Mamushë u hap para katër vitesh, por një nxënës i kësaj dege thotë se kanë libra vetëm për dy nga 14 lëndët. Shoku i tij i cili studion shkencën në shkollën e njejtë, pajtohet, 'Edhe ne ballafaqohemi me gjendje të njejtë. Arsimtarët diktojnë dhe ne shkruajmë. Kjo vlen për shumicën e lëndëve. Nuk kemi libra. Kemi libra vetëm për lëndën e gjuhës turke dhe gjuhës angleze.'⁴³

Në prill të vitit 2009 u themelua Këshilli Kombëtar për Planprograme Shkollore për rishikimin dhe miratimin e Kornizës së re të Planprogramit. Planprogrami duhej ta përfronte Kosovën me standardet evropiane të arsimit. Planprogrami i rishikuar synonte të promovonte qasje të balancuar në mësimdhënie dhe mësim 'sa i përket ofrimit të njohurive valide dhe të azhurnuara për nxënësit dhe njëkohësisht t'iu ndihmoj atyre të përfitojnë aftësi të vlefshme.'⁴⁴ Megjithatë, siç tregojnë komentet e studentëve, shkalla e zbatimit të këtyre reformave mbetet për t'u parë. Sipas Dukagjin Pupovcit, Drejtor i KEC-it, 'Përgatitja e mësimdhënësve është kyçe; nëse mësimdhënësit nuk janë të përgatitur për zbatimin e metodave të reja, planprogrami nuk ka asnjë efekt.'⁴⁵

Mësimdhënësit e shkolluar para viteve të 90-ta kanë përfunduar dy dhe nganjëherë tri vite të shkollimit në atë që atëkohë quhej Instituti i Lartë Pedagogjik. Rreth 70 përqind e

³⁹ USAID, *Vlerësimi i Arsimit Themelor/Arsimit Parauniversitar në Kosovë*, korrik 2009, f. 25.

⁴⁰ Fokus grupi i IKS me nxënës turk të shkollës së mesme Ataturk në Mamushë, 6 maj 2010.

⁴¹ Fokus grupi i IKS me nxënës të shkollës së mesme dhe shkollave profesionale në Prizren, 28 Prill 2010.

⁴² Po aty.

⁴³ Fokus grupi i IKS me nxënës të shkollës mesme Ataturk në Mamushë, 6 maj 2010.

⁴⁴ MASHT, 'Korniza e kurrikulit për arsim parashkollor, fillor, sekondar dhe post-sekondar', Draft, Prishtinë, prill 2010, f. 12.

⁴⁵ Intervista e IKS me Dukagjin Pupovcin, Drejtor i Qendrës për Arsim të Kosovës (KEC), 3 qershor 2010.

mësimdhënësve në shkollat fillore sot kaluan dy vite të këtij trajnimi para shërbimit.⁴⁶ Trajnimet e mëtutjeshme të mësimdhënësve janë ndarë në trajnime para shërbimit dhe në shërbim për t'i ngërthyer të dy gjeneratat, gjeneratën e re të mësimdhënësve dhe gjeneratën e mësimdhënësve në punë. Prej vitit 2001 deri në vitin 2009, rreth 11,000 nga 24,824 mësimdhënës aktiv në Kosovë morën pjesë në programet për trajnimin e mësimdhënësve.⁴⁷ MASHT-i është i vetëdijësuar për nevojën e trajnimit të mësimdhënësve në mënyre që këta të fundit të kenë aftësi në implementimin e plan programit të ri. Për këtë, MASHT-i në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës kanë marrë masa për ri-trajnimin e të gjithë mësuesve të cilët kanë trajnim dy vjeçar në Institutin e Lartë Pedagogjik, për ti ngritur ata në kualifikim katër vjeçar. Programi është paraparë të fillon në Tetor të vitit 2010 duke parë edhe gatishmërinë e Universitetit të Prishtinës

Agjencioni Kanadez për Zhvillim Ndërkombëtar (CIDA) ishte institucioni i parë që investoi në programet për trajnimin e mësimdhënësve në Kosovë. Donatorët tjerë, siç janë UNICEF-i, Fondi Zhvillimor i Arsimit në Kosovë (KEDP), Përkrahja Finlandeze për Sektorin e Arsimit në Kosovë (FSDEK), KEC-i dhe vet MASHT-i, pastaj e ndoqën këtë shembull. Vetëm KEC-i, deri sot, ka trajnuar më tepër se 10,000 mësimdhënës në trajnimin në punë. Trajnimin e mësimdhënësve para shërbimit e ofron Fakulteti Pedagogjik i Universitetit të Prishtinës; trajnimin në punë e kanë ofruar shumë organizata të ndryshme, dhe kjo fushë nuk është rregulluar me ligj. MASHT-i është në proces të finalizimit të legjislacionit për trajnimin e mësimdhënësve, ku thuhet që vetëm institucionet e akredituara nga MASHT-i mund të ofrojnë trajnime të mësimdhënësve në Kosovë.

Përkundër përpjekjeve të MASHT-it dhe donatorëve ndërkombëtar për përmirësimin e njohurive dhe metodologjive të mësimdhënësve, problemet vazhdojnë. Derisa 80.8 përqind e të rinjve 10-14 64.8 përqind e të rinjve 15-24 vjeçar ishin në përgjithësi të kënaqur me mësimdhënësit e tyre, pyetjet më specifike, intervistat dhe fokus grupet zbuluan disa fusha të pakënaqësisë.

Më tepër se 66 përqind e të rinjve 10-14 vjeçar dhe 62.5 përqind të të rinjve 15-24 vjeçar mendojnë që mësimdhënësit kanë sjellje tejet autoritative dhe të rreptë ndaj nxënësve. Prandaj, vetëm një margjinë e vogël e studentëve dukej e kënaqur me mësimdhënësit në krahasim me hulumtimin e UNICEF-it për tërë Kosovën në vitin 2004, kur 72 përqind të respondentëve kishin thënë se mësimdhënësit kishin sjellje shumë autoritative.⁴⁸

Gjatë intervistave, nxënësit treguan hollësi të përvojave të tyre me mësimdhënësin e dobët në të gjitha nivelet. Një 18 vjeçar shpjegoi, 'nëse e bën pyetjen e gabueshme, arsimtarët na thonin "mbylle gojën" dhe "ulu."' Edhe studentët universitar përshkruanin përvoja të ngjashme. Një 22 vjeçar nga Fakulteti i Arkitekturës komentoi:

Fare nuk jam i kënaqur me cilësinë e arsimit. Profesionit të cilin e kam zgjedhur kërkon shumë punë e përkushtim dhe profesorët duhet të jenë shumë të përgatitur dhe të informuar. Fatkeqësisht, profesorët në fakultetin tim janë komunistë, vijnë të dehur dhe i ngacmojnë femrat.⁴⁹

⁴⁶ Intervista e IKS dhe email korrespondenca me Ardita Himën, KEC, Prishtinë, gusht 2010.

⁴⁷ IKS email korrespondenca me Nehat Mustafën, këshilltar politik në MASHT, 23 korrik 2010.

⁴⁸ UNICEF, *Rinia në Kosovë*, qershor 2004, f. 27.

⁴⁹ Intervista e IKS me një student 22-vjeçar të Fakultetit të Arkitekturës, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 5 prill 2010.

Ngjashëm thotë edhe Drini, 16-vjeçar:

Arsimtarët janë shumë konservativ dhe nuk janë profesional në punë. Ata nuk kanë afërsi me nxënësit; nganjëherë edhe na kanë rrahur. Për shkak të pagave të tyre të ulëta, mësimdhënia ka qenë puna e tyre e dytë. Më kujtohet kur arsimtarët nuk vinin në klasë sepse punon privatisht diku tjetër.⁵⁰

Deniza, një vajzë e re nga Gjakova, e përmbledh përvojën e saj: ‘Arsimtari hyn në klasë, shpjegon çka ka për të shpjeguar, pyet nëse i kemi kuptuar shpjegimet dhe largohet nga klasa. Asgjë interesante.’⁵¹ Në përgjithësi, më tepër se 15 përqind e të rinjve 10-14 vjeçar dhe 19 përqind e të rinjve 15-24 vjeçar thanë se ishin ‘të pavendosur’ nëse mësimdhënësit ishin të kualifikuar të ligjërojnë për lëndët e tyre. Një i ri tjetër tha:

Ajo që më brengos rreth sistemit arsimor në Kosovë është përzjerja e metodave të reja dhe të vjetra. Shumica e profesorëve të vjetër shtirren sikurse ligjërojnë sipas reformave të reja, por ata vetëm shkaktojnë konfuzion. Jam ndier shumë i turpëruar kur erdha në fakultet. Kur kërkuan të shkruaj një ese apo të bëjë një prezantim, nuk kisha ide se çka është eseja e lere më ta shkruaj një. Kohëve të fundit, po vijnë kuadro të reja dhe shpresoj se gjërat do të përmirësohen. Kemi rastin të mësojmë nga kuadrot e reja që kanë studiuar jashtë dhe të cilët përpiqen të na përgatisin për tregun e punës.⁵²

Dallimi në mes qasjeve të profesorëve ‘të rinj’ dhe ‘të vjetër’⁵³ ishte temë aktuale në mesin e të rinjve. Një student i drejtësisë në Universitetin e Prishtinës tha, ‘Profesorët e rinj janë entuziast dhe përpiqen ta bëjnë orën e mësimi më atraktive. Ata kanë njohuri dhe qasje moderne. Derisa në anën tjetër, profesorët e moshuar janë shumë konservativ dhe punojnë me metoda të vjetruara, pa marrë parasysh përpjekjeve për t’u reformuar.’⁵⁴

Të rinjtë serb në Graçanicë poashtu u ankuan për metodologjinë e mësimdhënies.⁵⁵ ‘Ka ende profesorë të moshuar dhe është vështirë t’i thuhet atyre të përdorin teknologji të re,’ thotë Milloshi, student i letërsisë angleze në Universitetin e Mitrovicës.⁵⁶ Të rinjtë serb thonë që procesi i Bolonjës funksionon në letër por që zbatimi i tij në praktikë mbetet çështje thumbuese. Mësimdhënësit ose kanë vazhduar me metodat e vjetra ose kanë bërë improvizime në mes dy metodave. Ivana, studente e mjekësisë në Universitetin e Mitrovicës, shpjegon:

Ka raste kur një profesor e ka kuptuar sistemin e Bolonjës dhe mënyrën si funksionon. Çka ndodh pastaj është që në një fakultet e keni një kurs ku ligjërohet sipas sistemit të Bolonjës derisa në kurset tjera ligjërohet sipas metodave të vjetra.⁵⁷

⁵⁰ Intervista e IKS me Drinin, student, Prishtinë, 7 prill 2010.

⁵¹ Fokus grupi i IKS me nxënësit të shkollës së mesme dhe shkollave profesionale në Gjakovë, 29 prill 2010.

⁵² Intervista e IKS me Milot Rexhepin, student i shkencave politike, Prishtinë, 9 prill 2010.

⁵³ Përgjigjet bazohen në përcëpimet e studentëve mbi ‘të vjetër’ dhe ‘të rinj.’ Ata i mbështesnin përgjigjet e tyre në moshën dhe periudhën kohore kur janë arsimuar mësimdhënësit e tyre.

⁵⁴ Intervista e IKS me Hereza Sefaj, studente e drejtësisë në Universitetin e Prishtinës, Prishtinë, 6 prill 2010.

⁵⁵ Shkollat e komunitetit serb janë nën autoritetin e Ministrisë së Arsimit në Beograd. Nxënësit serb të Kosovës vijojnë mësimet sipas kurrikutit të Republikës së Serbisë dhe nuk marrin asnjë udhëzim në gjuhën shqipe. Shih: OSCE, *Komunitetet e mëdha joshqiptare në Kosovë brenda Sistemeve Filllore dhe të Mesme të Arsimit*, prill 2009.

⁵⁶ Fokus grupi i IKS me të rinj serb në Graçanicë, 12 maj 2010.

⁵⁷ Po aty.

Derisa këto probleme mund ta pasqyrojnë tranzicionin aktual si pjesë e procesit të reformave arsimore, cilësia e mësimëve dhe qasjeve të mësimdhënësve duhet të trajtohet në thelbin e saj.

Fakulteti Pedagogjik në Universitetin e Prishtinës, ku shkollohen gjeneratat e reja të mësimdhënësve, u themelua në vitin 2002 nga MASHT-i dhe Universiteti i Prishtinës. Megjithatë, ky Fakultet e ka vështirë të rekrutoj dhe përgatis mësimdhënës të ri. Pagat e mësimdhënësve mbesin të vogla, përkundër rritjes prej 30-40 përqind në vitin 2009. Me paga prej 230 deri në 260 euro në muaj,⁵⁸ mësimdhënësit paguhën më dobët sesa profesionet e tjera. Prandaj, profesioni i cili dikur gëzonte respekt në vitet e sistemit paralel tash është bërë më pak joshës.

Studentët që zgjedhën Fakultetin Pedagogjik nuk janë të kënaqur me arsimin e ofruar. ‘Profesori i cili duhet të ligjëroj një herë në javë, ligjëron vetëm një herë në muaj dhe askush nuk kërkon llogari nga ai,’ shpjegon Valdeti, student 24-vjeçar i cili u largua nga Fakulteti Pedagogjik për t’u regjistruar në degën e Bankës dhe Financave në një universitet privat. ‘Profesorët bëjnë si t’u teket, dhe nuk i marrin parasysh nevojat e studentëve. Kohëve të fundit, është dashur të presim gjashtë orë për të hyrë në provim,’ ankohet Edona, studente 20-vjeçare në Fakultetin Pedagogjik e cila planifikon të transferohet në Fakultetin Ekonomik. Studentët ankohen që disa profesorë japin mësim më tepër se 30 vite dhe janë shumë të vjetër për t’iu përshtatur metodave të reja.⁵⁹

Studentët nuk janë të vetmit që u zhgënjyën me Fakultetin Pedagogjik. Sipas kryetares së Bordit të Agjencionit Kosovar për Akreditim, Ferdije Zhushi Etemi:

Fakulteti Pedagogjik nuk preferohet për studentë të mirë apo të shkëlqyeshëm. I tërë koncepti i Fakultetit Pedagogjik është i gabueshëm. Ai fakultet ka staf të vogël dhe të pakualifikuar. Aty punojnë mësimdhënës 72 vjeçar. Koncepti i arsimit nuk zbatohet fare. Ka mungesë të metodologjisë, strategjisë dhe didaktikës. Vetëm dy njerëz në administratë kanë përvojë në arsim; të tjerët vijnë nga disiplina tjera.⁶⁰

Edhe MASHT-i ka shprehur brengat e ngjashme. Kushtrim Bajrami, Drejtor i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Bashkërendim të Zhvillimit dhe Integritet Evropian, pajtohet, ‘Stafi akademik i Fakultetit Pedagogjik duhet të jetë më i mirë.’⁶¹

Mungesa e gjërave themelore

Sipas MASHT-it, përveç mësimdhënësve, ‘procesi i reformave varet jashtëzakonisht shumë nga hapësira fizike e shkollave.’⁶² Përkundër investimeve nga MASHT-i dhe donatorët ndërkombëtar, infrastruktura e shkollave mbetet problem i shprehur. Edhe pse MASHT-i është i obliguar me zhvillim të politikave dhe monitorim të sistemit, ka shënuar se ‘akoma mungon infrastruktura shkollore për zbatimin e suksesshëm të

⁵⁸ ETF, *Planifikimi i Politikave dhe Praktikave për Përgatitjen e Mësimdhënësve për Arsim Përfshirës në Kontekstin e Diversitetit Social dhe Kulturor*, Raport për Kosovën (nën Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244/99), dokument pune, 2010.

⁵⁹ Fokus grupi i IKS me nxënës dhe studentë të universitetit në prizren, 28 prill 2010.

⁶⁰ Intervista e IKS me Ferdije Zhushi Etemin, kryetare e Bordit të Agjencionit Akreditues të Kosovës, Prishtinë, 22 qershor 2010.


⁶¹ Intervista e IKS me Kushtrim Bajramin, Drejtor i Departamentit për Bashkëpunim, Bashkërendim të Zhvillimit dhe Integritet Evropian, MASHT, Prishtinë, 9 qershor 2010.

⁶² MASHT, *Infrastruktura e Objekteve Arsimore*, në <http://www.masht-gov.net/advCms/#id=57>.

programeve të reja mësimore.⁶³ Infrastruktura e pamjaftueshme mund të ndikoj në cilësinë e arsimit.

Në hulumtimin e IKS-it në mbarë Kosovën, infrastruktura shkollore ishte njëra ndër çështjet me të cilat të rinjtë janë më të pakënaqur.

Grafiku 1.2 Përqindja e respondentëve të rinj të pakënaqur me infrastrukturën shkollore⁶⁴



Siç ilustron Grafiku 1.2, rreth 25 përqind e respondentëve thanë që nuk janë të kënaqur me klasat, laboratorët, dhe pajisjet sportive në shkollat e tyre. Rreth 16 përqind janë të pakënaqur me higjienën dhe rreth 15 përqind janë të pakënaqur me pajisjet e klasave. Rreth 12 përqind janë të pakënaqur me sistemin e ngrohjes në shkollat e tyre. Të rinjtë nga Ferizaji dhe Gjilani, më tepër se nxënësit nga rajonet tjera, ishin të prirur t'i shprehin brengat e tyre rreth çështjeve të infrastrukturës.

Shumë respondentë pohojnë që shumë shkollave ju mungojnë pajisjet dhe shërbimet elementare, siç janë laboratorët, libraritë, hapësirat për aktivitete sportive, kompjuterët dhe kujdesi shëndetësor. Disa laboratorë janë shndërruar në klasa për ta akomoduar numrin e madh të nxënësve.⁶⁵ Libraritë nuk janë të pajisura mirë dhe hapësirat për sport zakonisht janë të shtruara në asfalt dhe kanë pak ose fare pajisje sportive. Këto terrene nuk mund të shfrytëzohen gjatë dimrit. Dona, studente 18-vjeçare nga Mamusha, thotë, 'Nuk ka laboratorë të kimisë, fizikës, etj. Nuk ka sallë për edukatë fizike. Kur bie shi nuk mund të dalim jashtë.'⁶⁶


⁶³ MASHT, Departamenti për Zhvillim të Arsimit Parauniversitar, raundi i dytë i punëtorive më mësimdhënës në arsimin parauniversitar, të mbajtura në gjashtë komuna (Podujevë, Mitrovicë, Ferizaj, Suharekë, Kaçanik dhe Skenderaj), 16 korrik 2010.

⁶⁴ Për të rinjtë e grupmoshës 15-24, janë kalkuluar vetëm përgjigjet e respondentëve që vijonin procesin mësimor.

⁶⁵ Iniciativa Kosovare për Stabilitet - IKS, *Mitrovicë/Mitrovica: Një Qytet, Dy realitete*, dhjetor 2009.


⁶⁶ Fokus grupi i IKS me nxënës turk të shkollës së mesme Ataturk në Mamushë, 6 maj 2010.

Grafiku 1.3 Disponueshmëria e hapësirave shkollore për të rinj të grupmoshës 10-14



Siç shihet në Grafikon 1.3, 38 përqind e respondentëve 10-14 vjeçar nuk kanë kujdes mjekësor në shkollë, 33.2 përqind nuk kanë laboratorë, 20.5 përqind nuk kanë internet, 13 përqind nuk kanë hapësira për aktivitete sportive, 11.6 përqind nuk kanë librari dhe 7.9 përqind nuk kanë kompjuterë. Në krahasim me rajonet e tyre, Ferizaji dhe Gjlani duket se kanë hapësirat më joadekuat shkollore. Ferizaji dhe Prizreni janë rajonet me numrin më të madh të nxënësve që thonë se shkollat e tyre nuk kanë kujdes mjekësor.

Grafiku 1.4 Disponueshmëria e hapësirave shkollore të rinj të grupmoshës 15-24 që vijojnë mësimet




Studimi tregon që respondentët 15-24 vjeçar kanë më pak qasje se respondentët 10-14 vjeçar në laborator, kompjuter, internet dhe librari. Siç ilustron Grafiku 1.4, më tepër se 36 përqind e respondentëve 15-24 vjeçar që vijojnë orët mësimore në shkollë thanë se shkollat e tyre nuk kanë laborator, 18.9 përqind nuk kanë kompjuterë dhe 28.8 përqind nuk kanë internet. Për më tepër, 26.8 përqind nuk kanë kujdes mjekësor në shkollë, 12.8 përqind nuk kanë librari dhe 9.7 përqind nuk kanë hapësira për aktivitete sportive.

Më tepër respondentë shqiptarë thanë se shkollat e tyre nuk ofrojnë kujdes mjekësor (41.7 përqind) sesa serb (30.9 përqind) apo respondentë të tjerë (25 përqind). Më tepër shqiptarë (36.2 përqind) dhe respondentë të tjerë (30.4 përqind) thanë se shkollat e tyre nuk kanë laborator në krahasim me respondentët serb (19.1 përqind). Megjithatë, më tepër respondentë serb nuk kanë internet (26.5 përqind) sesa respondentë shqiptar (20.4 përqind) dhe grupe tjera etnike (14.3 përqind). Një përqindje më e vogël e respondentëve serb nuk kanë librari (14.7 përqind) sesa shqiptarë (12.5 përqind) apo pakicat tjera (1.8 përqind). Nëntë përqind e respondentëve shqiptarë nuk kanë kompjuterë në shkollë, derisa 4.4 përqind e serbëve dhe 5.4 përqind e të rinjve nga komunitetet tjera etnike kanë.

Të rinjtë që vijojnë mësimin në shkolla të rajoneve të caktuara duket se kanë më pak qasje në laborator sesa të tjerët, siç shihet në Grafikon 1.5. Rreth 57 përqind e respondentëve 15-24 vjeçar në Ferizaj, 41.8 përqind në Pejë dhe 36.2 përqind në Gjilan thanë se nuk kanë laboratorë në shkollat e tyre të mesme.

Grafiku 1.5 Përqindja e të rinjve 15-24 vjeçar pa laboratorë në shkollë, sipas rajonit




Më shumë se 61 përqind e respondentëve 15-24 vjeçar në Ferizaj, 50.7 përqind në Gjilan dhe 43.7 përqind në Prizren thanë se nuk kanë kujdes mjekësor në shkollë. Në përgjithësi, rajoni i Ferizajit dhe rajoni i Gjilanit duket se kanë infrastrukturën më joadekuate në shkollë.⁶⁷

⁶⁷ Në Ferizaj, 38.6 përqind të respondentëve nuk kanë kompjuterë në shkollë; 47.7 përqind nuk kanë qasje në internet; 29.5 përqind nuk kanë librari dhe 29.9 përqind nuk kanë hapësira të sportit. Në Gjilan, 40.6 përqind nuk kanë qasje në internet; 17.4 përqind nuk kanë librari në shkollë; dhe 37.7 përqind nuk kanë hapësira të sportit.

Përveç kësaj, hapësira e klasave ka qenë brengë serioze e të rinjve. Më shumë se 58 përqind e respondentëve 14 vjeçar dhe 50.3 përqind e respondentëve 15-24 vjeçar thanë se klasat e tyre janë të stërngarkuara me nxënës. Përsëri, dallimet duket se varen nga rajonet e caktuara, siç shihet edhe në Grafikon 1.6. Në Ferizaj, Pejë dhe Prizren, përqindje të ngjashme të larta të respondentëve në çdo grupmoshë nënvizuan mungesën e hapësirës në klasa. Në Gjakovë dhe Mitrovicë, megjithatë, duket se ekzistojnë dallime në mes dy grupmoshave rreth madhësisë së klasave. Rajoni i Gjakovës kishte numrin më të madh të respondentëve 10-14 vjeçar që thonë se klasat e tyre janë të stërngarkuara (89.5 përqind).

Grafiku 1.6 Përqindja e të rinjve që thonë se klasat e tyre janë të stërngarkuara, rajoni dhe mosha



Vërehet një marrëdhënie statistikisht e rëndësishme në nivelin pesë përqind të rëndësisë në mes grupeve etnike dhe mendimit të rinjve se shkollat janë të stërngarkuara.⁶⁸ Mesatarisht, shqiptarët e Kosovës e të gjitha grupmoshave kishin më tepër gjasa se serbët e Kosovës të thonë se shkollat e tyre janë të stërngarkuara.

Në vitin 2008/2008, numri mesatar i nxënësve për klasë ishte 23 për shkollat fillore dhe 300 për shkollat e mesme.⁶⁹ Ky numër është dukshëm më i lartë se në vendet e tjera të rajonit, siç është Sllovenia (18.5 dhe 20.4 përqind përkatësisht), Hungari (21.1 dhe 22.6) dhe mesatarja e OECD-së (21.6 dhe 23.7).⁷⁰ Migrimi nga zonat rurale në ato urbane e ka zvogëluar madhësinë e klasave në disa shkolla rurale. Megjithatë, numri i nxënësve për klasë në disa shkolla mbetet i lartë. Numri i klasave të tejnrgarkuara është më i madh se numri i klasave të nën-ngarkuara.

⁶⁸ $p < 0.001$

⁶⁹ Enti Statistikor i Kosovës, *Statistikat e Arsimit 2008/09*, korrik 2010.

⁷⁰ OECD, *Vështrim mbi Arsimin 2010: Indikatorët e OECD për vitin 2008, 2010*.

Siç shpjegon një nxënës i Shkollës së Mesme të Mjekësisë në Prizren: ‘Ne jemi rreth 45 nxënës në një klasë; gjatë këtyre katër viteve e kemi pasur shumë vështirë të mësojmë në një ambient kaq të ngarkuar.’ Një nxënës tjetër nga Shkolla e Mesme e Ekonomisë dhe Ligjit në Prizren thotë: ‘Numri maksimal i nxënësve në klasën time duhej të ishte 32, por ne ishim 46. Nuk mund të gjenim vende për tu ulur. Çdo ditë grindeshim për ulëse. Tash jemi 35, sepse disa nxënës janë larguar nga shkolla, u kishte ardhur te hunda.’⁷¹

MASHT-i ka provuar të ofroj hapësirë më të mëdha për shkollim. Derisa 800 shkolla të dëmtuara dhe 61 të shkatërruara kryesisht janë rinovuar dhe rindërtuar, nuk është arritur numri i përgjithshëm i 1,220 shkollave nga periudha para luftës.⁷² Në çdo rast, duke marrë parasysh numrin e madh të popullatës së re të Kosovës dhe zgjatjes së shkollimit të obligueshëm në 13 vite në 2010,⁷³ nevoja për hapësira shkollore është rritur më shpejt se përpjekjet e MASHT-it për ndërtim. Me një numër total prej 985 shkollave fillore dhe 108 shkollave të mesme në vitin 2010, Kosova ende ballafaqohet me mungesë të numrit të mjaftueshëm të klasave.⁷⁴

Përkundër mangësive të lartpërmendura infrastrukturore, buxheti i MASHT-it ka shënuar rënie të konsiderueshme nga 56.5 milion në vitin 2008 në 36 milion në vitin 2010. Buxheti i Ministrisë për ndërtimin e shkollave shënoi rënie nga 38.5 milion në vitin 2008 në 24.5 milion në vitin 2010. Përkundër rritjes së pagave për mësimdhënësit, buxheti operacional i cili paguan pagat e mësimdhënësve dhe mirëmbajtjen e shkollave shënoi rënie nga 17.6 milion në vitin 2008 në 6 milion në vitin 2009. Buxheti u rrit në 11.5 milion në vitin 2010 por nuk e arriti nivelin e vitit 2008. Shkurtime të buxhetore vënë në pyetje përkushtimin e qeverisë për përmirësimin e arsimit në Kosovë. Në të njëjtën kohë, kjo i rrezikon mundësitë e të rinjve për të ardhmen.⁷⁵

Qëndrimet ndaj arsimit: Të vazhdohet apo të mos vazhdohet

Shumë të rinj e njohin vlerën e arsimit, siç tregojnë edhe studimi anembanë Kosovës dhe intervistat e hollësishme. ‘E ardhmja ime varet nga shkollimi im. Do t’i vazhdoj studimet e mia deri në shkallën e fundit edhe pse akoma nuk kam vendosur çka do të studioj,’ thotë Drini, 16-vjeçar dhe nxënës i shkollës së mesme në Prishtinë.⁷⁶ Gentiana, 18-vjeçare thotë, ‘Shkolla është çdo gjë, pa shkollë nuk ke siguri në vend të punës, dhe nuk e din çka të sjell e ardhmja.’⁷⁷ Hana 19-vjeçare pajtohet, ‘Shkolla është e nevojshme si buka.’⁷⁸ Kjo dëshmon qartë që të rinjtë e Kosovës janë të vetëdijshëm se cilat janë prioritetet e tyre.

Derisa numri i të rinjve që vijojnë shkollimin e obligueshëm fillor dhe të ulët të mesëm është luhatur nga viti në vit, numri i studentëve që vijojnë shkollimin e mesëm të lartë ka shënuar ngritje të qëndrueshme siç shihet në Tabelën 1.1.

⁷¹ Fokus grupi i IKS me nxënës të shkollës së mesme dhe shkollave profesionale në Prizren, 28 prill 2010.

⁷² Komisioni Evropian, Vlerësimi i Dëmeve në Kosovë, *Ndërtimi i Vlerësimit në Kosovë*, Grupi i Menaxhmentit Ndërkombëtar, prill 2004.

⁷³ MASHT, ‘Korniza e kurrikulit për arsim parashkollor, fillor, sekondar dhe post-sekondar,’ Drafti i Dytë, Prishtinë, prill 2010

⁷⁴ MASHT, *Statistikat e Arsimit 2009/10*.

⁷⁵ Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Tabelat e Buxhetit Qendror për vitet 2008 dhe 2009, *Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2010*, janar 2010.

⁷⁶ Intervista e IKS me Drinin, student, Prishtinë, 7 prill 2010.

⁷⁷ Fokus grupi i IKS me nxënës të shkollës së mesme dhe shkollave profesionale në Prizren, 28 prill 2010.

⁷⁸ Fokus grupi i IKS me nxënës të shkollave të mesme në Dragash, 5 maj 2010.

Tabela 1.1 Numri i nxënësve kosovar që janë të regjistruar në shkollë, 2004 – 2010

Viti shkollor	2004/05	2005/06	2006/07	2007/08	2008/09	2009/10
Fillor & Mesëm i Ulët	327,207	322,180	324,618	326,911	322,975	311,744
Mesëm i Lartë	60,760	74,781	88,691	90,207	96,172	104,053

Burimi: Statistikat Arsimore të MASHT-it, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010.

Nxënësit që vijojnë shkollimin e mesëm të lartë zgjedhin në mes gjimnazit tradicional dhe shkollave profesionale. Në vitin akademik 2008/2009, 41,692 nxënës vijuan gjimnazin, shumica prej tyre vajza. Në vitin e njejtë, 55,073 nxënës, shumica e tyre meshkuj, vijuan shkollat profesionale.⁷⁹ Sipas traditës, gjimnazi është parakusht për të vazhduar studimet universitare.⁸⁰ Edhe pse më tepër nxënës kanë vijuar trajnimin arsimor profesional, kjo është konsideruar si opsion për nxënësit me performancë të dobët. Shumë nxënës që nuk u pranuan në gjimnazin e tyre të preferuar pastaj u regjistruan në shkolla profesionale.⁸¹ Përveç imazhit të keq, arsimi profesional në Kosovë ka edhe probleme tjera.

Shkollat profesionale janë paraparë t'i përgatisin nxënësit për tregun e punës, për dallim nga gjimnazet që ofrojnë arsim më teorik. Trajnimet profesionale janë paraparë të kenë qasje më praktike ndaj arsimit, si dhe të ofrojnë praksa në biznes. Në Kosovë, megjithatë, shkollat profesionale nuk janë të përputhshme me kërkesat e tregut të punës. Shumë pak institucione të këtilla zhvilluan partneritet me biznese, dhe kjo e minoi qëllimin e trajnimit profesional. Studentët që përfunduan shkollimin profesional nuk mund të vijonin shkollimin profesional post-sekondar, sepse ky i fundit nuk ekzistonte në Kosovë.⁸² Prandaj, studentët ose duhej të hynin në tregun e punës ose të transferoheshin në universitet. Shkollimi më praktik profesional terciar, siç është kolegji teknik apo universiteti, mund t'iu ofroj të rinjve më tepër mundësi.

Nivelet e shtuara të regjistrimit në shkollim të lartë janë ndikuar nga rolet e ndryshueshme gjinore. Tradicionalisht, shkalla e tranzicionit nga shkolla e obligueshme e ulët e mesme në shkollimin opsional të mesëm të lartë ka qenë më e lartë për djemtë sesa për vajzat. Sidoqoftë, shkalla e vajzave që vazhdojnë shkollimin e tyre ka shënuar rritje në vitet e fundit. Derisa 75.6 përqind e vajzave kaluan në shkollim të lartë në vitin akademik 2004/2005, në vitin akademik 2008/2009 kjo përqindje ishte 80.4.

Në disa pjesë të Kosovës, vajzat kanë më pak qasje në arsimin e lartë të mesëm. Më tepër vajza braktisën mësimin në shkolla fillore në Ferizaj, Malishevë dhe Dragash, sesa në komunat tjera.⁸³ Për shembull, Anjeza vijoi mësimin në shkollën fillore në fshatin e saj në Dragash. Mirëpo, vetëm katër nga 12 vajzat në klasën e saj vazhduan studimet në shkollë të mesme. 'Vajzat tjera mbesin në shtëpi për shkak të mentalitetit të familjeve të tyre,' thotë ajo. Mungesa e transportit publik nga fshatrat e Dragashit në shkollë të

⁷⁹ Enti Statistikor i Kosovës, *Statistikat e Arsimit 2008/09*, korrik 2010, ff. 52-53.

⁸⁰ Punëtori e grupeve të interesit UNICEF – IKS, Prishtinë, 13 korrik 2010.

⁸¹ Fondacioni Evropian për Trajnime, *ETF Plan i Vendit - Kosova 2009*, f. 5.

⁸² MASHT, 'Korniza e kurrikulit për arsim parashkollor, fillor, sekondar dhe post-sekondar' Drafti i Dytë, Prishtinë, prill 2010.

⁸³ Enti Statistikor i Kosovës, *Statistikat e Arsimit 2008/09*, korrik 2010, ff. 38, 64-65.

mesme krijuan brenga në mesin e disa prindërve për sigurinë e fëmijëve të tyre, posaçërisht vajzave, gjatë udhëtimit deri në shkollë dhe prej shkollës në shtëpi.⁸⁴

Të rinjtë tjerë pajtohen që transporti i dobët ndikon që shumë vajza mos ta vazhdojnë shkollimin e tyre pas shkollës fillore, posaçërisht vajzat e reja në fshatra. Hana, studente 18-vjeçare nga Gjakova, shpjegon, 'Vajzat nga fshati vendosin mos ta vazhdojnë shkollimin e tyre të mesëm kur janë në klasë të nëntë kryesisht për shkak të mungesës së transportit në dimër dhe në mbrëmje. Prindërit kanë frikë t'i dërgojnë vajzat e tyre në shkollë.'⁸⁵

Në Mamushë, disa vajza nuk dëshiruan ta vazhdojnë shkollimin. Për shembull, Ahmeti shpjegon se si motra e tij e madhe e kishte mbaruar shkollën fillore, por nuk dëshironte të shkonte në shkollë të mesme.⁸⁶ Disa nga shokët dhe të njohurit e Ahmetit në Mamushë thonë se prindërit e tyre i larguan nga shkolla. Megjithatë, pas një viti ata i kishin bindur prindërit e tyre t'i lejojnë ta vazhdojnë shkollën. Seda shpjegon, 'Babai im nuk më lejoi të shkoj në shkollë. Ai tha, "Çka do të bëhesh nëse shkon në shkollë? Rri në shtëpi." Shoqja e saj, Sibeli, kishte përvojë të ngjashme: 'Nëna ime nuk më lejoi të shkoj në shkollë. Ajo tha që vajzat nuk shkojnë në shkollë. Më vonë një shoqe e imja e bindi nënën time të më dërgoj në shkollë. Babai im nuk tha asgjë. Ai kishte dëshirë që unë ta vazhdoja shkollën.'⁸⁷ Pjesëmarrësit e fokus grupit shpjeguan që krijimi i familjes është shumë i rëndësishëm për vajzat në Mamushë. Qëndrimi në shtëpi dhe mosvajtja në shkollë konsiderohej shenjë që vajzat ishin gati për martesë. 'Vitin që qëndrova në shtëpi, njerëzit vinin dhe kërkonin të martoheshin me mua, por unë nuk doja,' thotë Seda. 'Nëna dëshironte që unë të martohesha, por unë gjithmonë refuzoja dhe i thoja se dua të shkoj në shkollë. Tash që jam në shkollë askush nuk e përmend martesën më.'⁸⁸

Qëndrimi ndaj shkollimit në Mamushë po ndryshon ngadalë. Kjo është pjesërisht rezultat i qasjes më të lehtë në shkollim. Aliu shpjegon, 'Kur nuk kishte shkollë të mesme në Mamushë, njerëzit duhej të shkonin në Prizren. Edhe numri i djemve që shkonin në shkollë të mesme nuk ishte shumë i madh. Vetëm pesë prej gjashtë djelmohave shkonin në shkollë në Prizren.' Shoku i tij, Buraku, pajtohet: 'Hapja e shkollës së mesme ka ndryshuar shumë gjëra; mentaliteti i njerëzve ka ndryshuar. Sot, më tepër vajza shkojnë në shkollë.'⁸⁹

Përveç lokacionit gjeografik dhe qasjes, dukej se përkatësia etnike është faktor determinues për vendimin e të rinjve rreth vazhdimin të shkollimit të tyre pas shkollës fillore. Vajzat rome në veçanti ballafaqohen me sfida rreth vazhdimin të shkollimit të tyre. Sipas ESK-së, vajzat RAE kanë nivelin më të ulët të shkollimit në Kosovë.

⁸⁴ Fokus grupi i IKS me nxënës të shkollës së mesme në Dragash, 5 maj 2010.

⁸⁵ Fokus grupi i IKS me nxënës të shkollës së mesme dhe shkollave profesionale në Gjakovë, 29 prill 2010.

⁸⁶ Fokus grupi i IKS me nxënës të shkollës së mesme Ataturk në Mamushë, 6 maj 2010.

⁸⁷ Po aty.

⁸⁸ Po aty.

⁸⁹ Po aty.

Tabela 2. Numri i studenteve kosovare në arsim sipas përkatësisë etnike, 2008/2009

Përkatësia etnike	Fillor & Mesëm i Ulët		Mesëm i lartë	
	Total	Femra	Total	Femra
Shqiptar	306,427	147,191	94,572	42,456
Boshnjak	3312	1641	1025	419
Roma	1519	685	75	25
Ashkali	3412	1554	203	43
Egjiptas	1670	750	89	23
Turk	1618	808	746	348
Goran	960	444	41	6

Burimi: Statistikat Arsimore të ESK-së, 2008/2009

Vetëm dy prej katër vajzave që morën pjesë në fokus grupin e IKS-it në lagjen rome në Mitrovicë, kishin mbaruar shkollën fillore. Njëra vajzë ishte larguar nga mësimi në faza të ndryshme. Një vajzë tjetër kurrë nuk ishte regjistruar në shkollë; asaj i ndihmonte një shoqe ta shkruante emrin e saj në listën e pjesëmarrësve. Vajzat shpjegojnë se u larguan nga shkolla për shkak se familjet e tyre mendojnë që vajzat nuk duhet të shkollohen dhe për shkak se vajzat rome martohen në moshë të hershme.

Adelina nuk pranonte ta tregonte moshën e saj. Ajo gjithmonë kishte pasur dëshirë të shkonte në shkollë dhe kishte vijuar mësimin në shkollën e mesme të lartë pas mbarimit të shkollës së ulët të mesme në gjuhën serbe. Megjithatë, ajo u largua nga shkolla pas tre muajve sepse ishte e vetmja rome në klasën e saj. Djelmohat romë janë të prirur të largohen nga shkolla për shkak se duhet të punojnë për t'i përkrahur familjet e tyre të mëdha.⁹⁰

Është më se e qartë që transporti i përmirësuar publik dhe pa pagesë për të rinjtë deri në shkollë dhe pastaj në shtëpi mund t'iu mundësoj më tepër vajzave dhe djemve të rinj t'i vazhdojnë studimet e tyre. Fushatat e vetëdijesimit mund të ndihmojnë në trajtimin e qëndrimeve konservative dhe në inkurajimin e të rinjve në përgjithësi që ta vazhdojnë shkollimin e tyre.

Urë drejt së ardhmes apo gur shpotitës e pengesë?

Në mënyrë që arsimit të jetë 'urë drejt botës' për rininë kosovare, duhet të ndërtohet një sistem efektiv arsimor i cili iu mundëson të diplomuarve t'i vazhdojnë studimet e tyre apo të kalojnë lehtë në tregun e punës. Mirëpo, edhe pse ka kaluar një dekadë nga konflikti, institucionet mezi ofrojnë infrastrukturën bazike për arsim, si dhe vazhdojnë të ballafaqohet me disa sfida cilësore dhe infrastrukture. Përkundër reformave arsimore për zhvillimin e kurrikulit dhe trajnimin e mësimitdhënësve, mbetet akoma punë për t'u bërë në mënyrë që studenti i rëndomtë t'i ndjej efektet. Është më se e qartë që reformat arsimore matet me gjenerata dhe jo me vite akademike. Kjo është posaçërisht e vërtetë nëse marrim parasysh sfidën e rindërtimit të sektorit të shkatërruar të arsimit në Kosovën e pasluftës. Përkundër përkushtimeve të mëdha financiare për rindërtimin e sektorit të arsimit, gjendja aktuale e tij nuk jep shenja të mira për të ardhmen e rinisë

⁹⁰ Fokus grupi i IKS me të rinj të komunitetit romë në Mitrovicë, 21 maj 2010.

kosovare. Sektori i arsimit në Kosovë më parë mund të përshkruhet si gur shpotitës apo pengesë sesa si urë drejt botës.

Derisa disa sfida të identifikuara gjatë hulumtimit të IKS-it kanë filluar të trajtohen, reformat arsimore janë ende larg rezultateve të dëshiruara. Përpjekjet për reforma janë zgjeruar tepër shumë në një sektor të gjerë i cili ka nevojë për investime të vazhdueshme në një periudhë të konsiderueshme kohore. Përpjekjet aktuale duhet të shoqërohen me përkushtim serioz dhe strategjik të qeverisë dhe me alokime të buxheteve më të mëdha.

Përveç kësaj, bashkërendimi ndërministror është vendimtar. Furnizimi i punës, posaçërisht në trajnimin për arsim profesional, duhet të sinkronizohet me kërkesat e tregut të punës. MPMS-ja duhet ta caktoj si prioritet identifikimin e aftësive që nevojiten në tregun e punës dhe të koordinohet me MASHT-in për t'u siguruar që këto nevoja pasqyrohen në sektorin e arsimit.

Në fund, siç do të elaborohet edhe në kapitullin vijues, promovimi i shkëmbimit të obligueshëm me universitetet e huaja për studentët dhe mësime të shkollave private dhe publike terciare mund t'i shpejtoj reformat arsimore duke futur metoda të reja që përdoren në rajon dhe Evropë. Aftësitë dhe njohuria e fituar gjatë semestrit në universitetet e huaja do ta përmirësojnë edhe më tej cilësinë e mësimit në nivelin universitar.

S'KA PUNË, S'KA PERSPEKTIVË

*'Mendoj që një i ri apo e re e ka shumë
vështirë të gjej punë, pa marrë parasysh sa i
kualifikuar është. Në Kosovë nuk mund të bësh
asgjë pa i njohur njerëzit e duhur.'*
- Drini, nxënës 16-vjeçar nga Gjakova

Papunësia, si problem strukturor, ka histori të gjatë në Kosovë. Edhe gjatë zhvillimit industrialist të Kosovës në fund të viteve të 80-ta, niveli i papunësisë sillej në rreth 36 përqind.⁹¹ Niveli i papunësisë filloj të rritej me shpejtësi të madhe kur autoritetet serbe dëbuan punëtorët shqiptarë nga fabrikat shtetërore në fillim të viteve të 90-ta.⁹² Fabrikat filluan të prishen dhe shumë prej tyre u shkatërruan edhe më shumë gjatë luftës. Procesi i amullt i privatizimit pas luftës ka krijuar numër të vogël të vendeve të punës dhe është ende larg nga përmbushja e kërkesave të popullsisë në rritje.

Në vitin 2009, papunësia vazhdonte të pllakoste 45.4 përqind të popullsisë kosovare; më të prekurit janë të rinjtë. Popullata e re punëtore e moshës 15-24 vjeçare përbën 20 përqind të fuqisë punëtore në Kosovë (48.1 përqind) dhe 73 përqind prej tyre janë të papunë. Kjo shkallë e lartë e papunësisë është e paqëndrueshme. Shkalla e lartë e papunësisë në mesin e të rinjve jo vetëm që është e lidhur ngushtë me destabilitetin social dhe me nivel të lartë të krimeve, por ajo poashtu nënkupton që të rinjtë nuk kanë arsye të vazhdojnë të jetojnë në Kosovë. Siç ka konkluduar Banka Botërore, 'Kushtet e vështira të tregut të punës në Kosovo kanë qenë posaçërisht të rënda për të rinjtë dhe kanë pasur ndikime të dukshme në stabilitetin shoqëror.'⁹³

'Papunësia në Kosovë po e shkatërron rininë,' thotë Miloti, student 22-vjeçar në një universitet privat në Prishtinë.⁹⁴ Të rinjtë anëmbanë Kosovës e ndajnë këtë qëndrim. Derisa të rinjtë e moshës 15-24 vjeçare përbëjnë afro 20 përqind të fuqisë punëtore në Kosovë, ata poashtu përfaqësojnë 40 përqind të të papunëve në vend.⁹⁵ Me shkallë të papunësisë në mesin e të rinjve prej 73 përqind, shkallë që kjo është edhe më e lartë në mesin e femrave (81.3 përqind), Kosova ka edhe shkallën më të lartë të papunësisë si dhe shkallën më të lartë të papunësisë së të rinjve në rajon.

Punësimi ka qenë posaçërisht i vështirë për të rinjtë sepse 95.5 përqind prej tyre nuk kanë përvojë paraprake të punës. Në një treg me kërkesë shumë të ulët për punë, përvoja e pamjaftueshme e punës ka qenë faktor kyç që ndikonte në papunësinë afatgjate të të rinjve.⁹⁶ 81.7 përqind të të rinjve në Kosovë në vitin 2009 kanë qenë të ndikuar nga papunësia afatgjate, këtyre të rinjëve iu është dashtë më shumë se 12 muaj të kërkojnë për vend të punës.⁹⁷

Pas konfliktit dhe si rezultat i ndihmave ndërkombëtare dhe dërgesave nga jashtë, Kosova përjetoi rritje ekonomike.⁹⁸ Megjithatë, kjo rritje ka rënë në më pak se pesë

⁹¹ Banka Botërore, *Kosova, Zbërthimi i Potencialit për Rritje: Strategjitë, Politikat, Veprimet*, prill 2010, f. 12.

⁹² Malcolm, N., *Kosova: Histori e Shkurtë*, 1998, f. 429.

⁹³ Banka Botërore, *Shënim i Përkohshëm Strategjik për Republikën e Kosovës për periudhën FY10-11*, dhjetor 2009, f.14.

⁹⁴ Intervista e IKS me Milot Rexhepin, student i shkencave politike, Prishtinë, 9 prill 2010.

⁹⁵ Banka Botërore, *Kosova, Rinia në Rrezik: Të Qenit i Ri i Papunë dhe i Varfër në Kosovë*, shtator, 2008, f. iv.

⁹⁶ Po aty, p. 12.

⁹⁷ Enti Statistikor i Kosovës (ESK), *Seria 5: Statistikat Sociale, Rezultatet e Hulumtimit të Fuqisë Punëtore 2009*, Prishtinë, korrik 2010, f.5.

⁹⁸ Banka Botërore, *Kosova, Zbërthimi i Potencialit për Rritje: Strategjitë, Politikat, Veprimet*, prill 2010, f. v.

përqind që nga viti 2005, duke e vështirësuar kështu edhe më tej gjendjen e tregut të punës. Përveç kësaj, rritja ekonomike e Kosovës nuk është reflektuar në tregun e punës i cili karakterizohet me kërkesë të vogël për punë dhe me stagnim. Me Bruto Produktin Vendor (BPV) prej €1,760, Kosova mbetet vendi më i varfër në Ballkanin Perëndimor. Në vitin 2010, mikro-bizneset me profesione për aftësi të vogla dhe sektorët e vlerës së ulët të shtuar ende përbëjnë 90 përqind të sektorit të dobët privat.⁹⁹ Këto biznese nuk mund të absorbojnë numrin tejet të madh të papunëve e as të punësojnë rrjedhën e vazhdueshme të 25,000-40,000 të diplomuarve që futen në tregun e punës çdo vit.¹⁰⁰ Për ta ulur shkallën e papunësisë, rritja e BPV-së do të duhej të ishte më tepër se gjashtë përqind të paktën për një dekadë, e jo mesatare prej 0.9 përqind si në periudhën 2002-2007.¹⁰¹

Ky kapitull mëton ta vendos papunësinë e të rinjve në qendër të debatit për të ardhmen e Kosovës. Kapitulli analizon preokupimin e rinisë me papunësinë dhe mënyrat se si ata i përshtaten kësaj gjendje. Më tej, shqyrtohet ndikimi i arsimit në punësim si dhe sfidat me të cilat ballafaqohen të rinjtë gjatë tranzicionit nga arsimit në tregun e punës. Kapitulli poashtu vlerëson strategjitë për karrierën e të rinjve si dhe përgjigjen e qeverisë ndaj shkallës së lartë të papunësisë në mesin e të rinjve. Përqendrimi kryesor i kapitullit është teza kyçe që të rinjtë janë po aq të preokupuar me papunësinë sa edhe të rriturit.

Papunësia: Brenga më e madhe e të rinjve

Selda, studente 21-vjeçare turke, rishtazi ka hyrë në tregun e punës, dhe kishte fat të gjente punë si përkthyes. ‘Papunësia është brengë e madhe në Kosovë,’ thotë ajo. ‘Të rinjtë bredhin rrugëve; mendoj se atyre nuk iu ka mbetur asnjë nxitje për punë.’¹⁰² Gjendja e rëndë ekonomike e ka pasur ndikimin e saj tek të rinjtë dhe të rriturit. Për vite me radhë, të rinjtë kanë parë përpjekjet për mbijetesë të prindërve dhe anëtarëve të tjerë të familjeve të tyre. Ata qysh në moshë të hershme u vetëdijesuan për papunësinë. Berti, 10-vjeçar, tashmë e din rëndësinë e planifikimit për të ardhmen: ‘Natyrisht që shkolla është për të mirën e së ardhmes sime, pa shkollë do të mbes në rrugë.’¹⁰³

Njëlloj me Bertin, shumica e respondentëve të moshës 10-14 vjeçare identifikuan papunësinë (47.3 përqind të respondentëve) dhe varfërinë (28.2 përqind) si rreziqet më të madhe që i kanosen Kosovës. Për hir të krahasimit, më pak të rinj përmendën rreziqe tjera potenciale siç janë korrupsioni (7.4 përqind), përdorimi i drogës (6.1 përqind), krimi i organizuar (5.4 përqind) dhe ndotja e mjedisit (5.6 përqind).

⁹⁹ Po aty, p. ix.


¹⁰⁰ Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2009-2011, 12 qershor 2008, f.6.

¹⁰¹ Banka Botërore, *Rinia Kosovare në Rrezik: Të Qenit i Ri i Papunë dhe i Varfër në Kosovë*, shtator, 2008, f. 2.

¹⁰² Intervista e IKS me Selda Sylejmanin, studente, Prishtinë, 8 prill 2010.

¹⁰³ Intervista e IKS me Bertin, Prishtinë, 9 prill 2010.

Grafiku 2.1 Rreziqet më të mëdha që i kanosen Kosovës sipas të rinjve 10-14 vjeçar



Ngjashëm mendojnë edhe respondentët 15-24 vjeçar; 47.8 përqind prej tyre thanë se papunësia është rreziku më i madh që i kanosen Kosovës, ndërsa 24.5 përqind prej tyre identifikuan varfërinë si rrezikun më të madh. Në të vërtetë, papunësia dhe varfëria janë të ndërlidhura; njerëzit e papunë në Kosovë janë më tepër të rrezikuar nga varfëria ose varfëria e skajshme.¹⁰⁴

Rreziku i të qenit i papunë dhe skajshëm i varfër ishte jashtëzakonisht i lartë për romët në Kosovë. ‘Fillova të punoj në moshën 13-vjeçare,’ thotë Armendi 22-vjeçar, i cili jeton në *Mëhallën Rome* në Mitrovicën jugore.¹⁰⁵ ‘Në fillim punova si ngarkues i mallrave dhe pastaj punoja çdo gjë. Tash hap kanale. Do të doja të kisha një punë të përhershme, ndoshta si automekanik.’ Miqtë dhe fqinjët e Armendit ballafaqohen me probleme të ngjashme. Senadi, i cili u largua nga shkolla në klasën e pestë, beson që ‘varfëria dhe papunësia janë problemet më të mëdha. Ne duhet ta sigurojmë jetesën tonë dhe punojmë çka të mundemi.’¹⁰⁶ Shoku i tij, Artani, shpjegon që largimi nga shkolla është tipik për djelmoshat e komunitetit romë: ‘Fëmijët romë janë të obliguar të punojnë për shkak të kushteve të vështira dhe varfërisë. Senadi, për shembull, punon si taksist. Është vështirë të mbahet familja, prandaj ai u desh të largohej nga shkolla dhe të filloj të punoj. Varfëria i detyron të rinjtë të largohen nga shkolla.’¹⁰⁷

Pa marrë parasysh se a vijojnë mësimet në shkollë, punojnë apo janë duke kërkuar punë, të gjithë të rinjtë preokupohen me punësimin. Siç shihet në Grafikon 2.1, 56.3 përqind të respondentëve të moshës 15-24 vjeçare thanë se janë ‘shumë të preokupuar’ me papunësinë, derisa 31.3 përqind janë ‘të preokupuar.’


¹⁰⁴ Banka Botërore, *Rinia Kosovare në Rrezik: Të Qenit i Ri i Papunë dhe i Varfër në Kosovë*, shtator, 2008, f. vii.

¹⁰⁵ Fokus grupi i IKS me të rinj romë në Mitrovicë, 21 maj 2010.

¹⁰⁶ Po aty.

¹⁰⁷ Po aty.

Grafiku 2.2 Shkalla e preokupimit të rinjve 15-24 vjeçar me papunësinë



Ekziston marrëdhënie statistikisht e rëndësishme në mes përkatësisë etnike dhe preokupimit me papunësinë. Të rinjtë shqiptarë dhe të rinjtë nga komunitetet pakicë janë më të preokupuar se serbët me papunësinë.¹⁰⁸ Derisa 60.2 përqind e respondentëve shqiptarë dhe 72.4 përqind të pakicave tjera thanë se ishin ‘shumë të preokupuar’ me papunësinë, vetëm 23.3 përqind e të rinjve serb u deklaruan kështu.

Megjithatë, në një fokus grup me të rinj serb nga Graçanica, papunësia u përmend si brengë e madhe. Aleksandri, student në Universitetin e Mitrovicës, shpjegon: ‘Shumë gjenerata janë shkolluar në dhjetë vitet e fundit, por ata nuk kanë gjetur punë. Kanë kërkuar punë por nuk gjetur asgjë.’ Bojana, kolege e tij, thotë që arsyeja pse nuk kanë gjetur punë është pse të rinjtë nuk kërkojnë punë posaçërisht në Prishtinë: ‘Duhet ta kemi parasysh që kur të rinjtë diplomojnë ata as nuk mendojnë të kërkojnë punë në Prishtinë, kryesisht për shkak të faktit se komuniteti serb nuk është tërësisht i integruar në shoqërinë e gjerë kosovare.’ Ivani, i diplomuar 24-vjeçar nga Universiteti i Mitrovicës, thotë që ‘të rinjtë që kanë diplomë universitare nuk aplikojnë për punë në institucionet kosovare për shkak të pagave shumë të ulëta,’ në krahasim me pagat që ofron qeveria e Serbisë. Sipas një hulumtimi të ri mbi reformat lokale në Kosovë, nëpunësit publik në sistemin paralel serb marrin paga relativisht të larta: të ardhurat e tyre mujore prej €892 janë shumë më të mëdha se pagat mesatare në Serbi prej €508.¹⁰⁹ Në pyetjen se a do të dëshironin të shkonin në punonin në Serbi, pjesëmarrësit u përgjigjen që edhe ata do t’i priste një situatë e njejtë.

Marrëdhënie statistikisht e rëndësishme ekziston edhe në mes rajonit gjeografik dhe preokupimit me papunësi. Të rinjtë në Mitrovicë, Gjakovë dhe Gjilan janë të prirur të jenë më pak të preokupuar me papunësinë sesa të rinjtë në Prishtinë.¹¹⁰ Për shembull,

¹⁰⁸ Të rinjtë shqiptarë ($p = 0.001$), serb ($p = 0.01$), pakicat tjera ($p = 0.011$).

¹⁰⁹ Shumica e nëpunësve publik financohen nga tri agjenci të qeverisë serbe: Ministrisë për Arsim, Fondit për Sigurim Shëndetësor dhe Ministrisë për Kosovë dhe Metohi. György Hajnal dhe Gábor Péteri, *Reforma Lokale në Kosovë: raporti final / Forum 2015* (ed.) Prishtinë, Forum 2015, 2010, ff.77-78.

¹¹⁰ ($p \leq 0.01$).

në Mitrovicë vetëm 23.9 përqind thanë se ishin ‘shumë të preokupuar’ me papunësinë në krahasim me 67.3 përqind të respondentëve në Prishtinë. Kjo ishte befasuese sepse Mitrovica ka shkallën më të lartë të papunësisë së të rinjve në mbarë vendin. Këto të dhëna mund të ilustrojnë pranimin e heshtur të të rinjve me të qenit të papunë në Mitrovicë.¹¹¹

Të vetëdijshëm për përhapjen e papunësisë, disa të rinj kanë gjetur mënyra për t’iu përshtatur kësaj gjendjeje. Për shembull, Agoni, nxënës 17-vjeçar në Gjimnazin Hajdar Dushi në Gjakovë, planifikon ta studioj fizioterapinë:

Në Gjakovë nuk ka shumë fizioterapeut dhe do të ketë nevojë për ta në të ardhmen. Ky profesion sjell gjendje më të mirë financiare edhe pse studimet zgjasin më tepër. Më tepër jam i interesuar se ku do të punoj; nuk është se më pëlqen shumë ky profesion, por e di që ofron të ardhme më të mirë. Dhe nëse punoj mirë mund të krijoj reputacion.¹¹²

Të rinjtë në çdo vend preokupohen me pyetjen nëse profesioni i tyre i preferuar do të siguroj jetë modeste. Megjithatë, për shkak të tregut të kufizuar dhe të pazhvilluar të punës, këto zgjidhje kanë qenë shumë më të rënda për rininë kosovare. Shumica prej tyre i kanë braktisur ëndrrat e tyre në moshë të hershme dhe kanë filluar të mendojnë për gjasat e një të ardhme më të mirë. Për shembull, Rona 22-vjeçare studion arkitekturën në Universitetin e Prishtinës, por ajo kishte mëdyshje: ‘Po mendoj të regjistrohem në ndonjë kolegji ose universitet privat dhe të studioj bankat dhe financat sepse mendoj se kjo do të ndihmoj të gjej punë në të ardhmen. E dua arkitekturën por nuk shoh ndonjë të ardhme si arkitekte.’¹¹³

Në mungesë të informatave të besueshme për kërkesat e tregut të punës, nxënësit zgjedhin profesione bazuar në perceptimet e tyre vetanake e jo në nevojat e tregut të punës. Komunikimi i pamjaftueshëm në mes institucioneve arsimore dhe bizneseve iu ka vështirësuar edhe më tepër nxënësve të marrin vendime adekuate për studimet e tyre; ata nuk kanë informata për kërkesat e bizneseve. Përkundër perceptimit të përgjithshëm në mesin e të rinjve që arsimit terciar do t’ju ofron gjasat më të mëdha për punësim, punëdhënësit në fakt preferojnë arsim profesional të shoqëruar me përvojë të punës. Një hulumtimi i USAID-it tregon që 69.7 përqind të punëdhënësve thanë se preferojnë arsim profesional për punët e krahut dhe 45.4 përqind preferojnë arsimin profesional për pozita profesionale. Kjo dëshmon mospërputhshmëri të qartë në mes perceptimeve të studentëve dhe preferencave të punëdhënësve për përgatitjen arsimore të aplikantëve.

Në anën tjetër, Organizata Ndërkombëtare e Punës tregon që kornizat e dobëta të vlerësimit të kualifikimeve tregojnë që punëdhënësit përdorin diplomat universitare si kriter gjatë përzgjedhjes së aplikantëve; derisa vendi i punës mund të mos jetë fare i lidhur me diplomën e tyre universitare.¹¹⁴ Kjo ka krijuar një situatë ku të diplomuarit kryejnë punë që janë nën kualifikimet e tyre.

¹¹¹ Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, *Puna dhe Punësimi 2007*, f. 12.

¹¹² Fokus grupi i IKS me nxënës të shkollës së mesme dhe shkollave profesionale në Gjakovë, 29 prill 2010.

¹¹³ Intervista e IKS me Rona Binakaj, studente, Prishtinë, 5 prill 2010.

¹¹⁴ Organizata Ndërkombëtare e Punës, *Tranzicioni i të Rinjve në Punë Modeste: Dëshmi nga Kosova*, prill 2007, f. 44.


Tregu i vogël i punës dhe mundësitë e kufizuara të punësimit kanë ndikuar edhe më tepër në zgjidhjet e të rinjve në Kosovë. Banka Botërore ka gjetur se kërkesa e vogël për punë është arsyeja kryesore e performancës së dobët të tregut të punës. Arsyeja e dytë është niveli i ulët i aftësive në mesin e popullatës. Arsimi mbetet çështje kyçe për sigurimin e vendit të punës.¹¹⁵ Hulumtimi i Buxheteve të Ekonomive Familjare i vitit 2009 tregoi që arsimi i lartë nënkupton më tepër të ardhura nga punësimi i rregullt në krahasim me arsimin fillor dhe të mesëm i cili në masë të konsiderueshme siguron një jetesë me punë me pagesë ditore, pensione nga jashtë, biznese vetanake dhe përkrahje nga jashtë.¹¹⁶ Prandaj, sistemi arsimor është tejet i rëndësishëm për tregun e punës.

Arsimi nuk të përgatit për punë

Shkallët e papunësisë në Kosovë dallojnë thelbësisht në bazë të nivelit të arsimit. Shkalla e papunësisë është jashtëzakonisht e lartë në mesin e atyre me shkollim më të ulët se ai i mesëm i lartë (64 përqind).¹¹⁷ Të diplomuarit e arsimit terciar kanë shkallën më të ulët të papunësisë (14.9 përqind).¹¹⁸ Shumica e të rinjve kosovar janë të vetëdijshëm për korrelacionin pozitiv në mes të shkollimit dhe punësimit; 62 përqind e respondentëve të moshës 15-24 vjeçare thanë që përfundimi i shkollimit ka ndikim pozitiv në gjasat për punësim. Meqë të rinjtë janë të vetëdijshëm për vështirësitë e punësimit, mbetja në sistemin e arsimit ka qenë alternativë për punësim e jo zgjidhje specifike për disa prej tyre.¹¹⁹

Edhe vlera e perceptuar për përfundimin e shkollimit të tyre ishte më se e qartë. Të rinjtë u pyetën nëse kanë pasur oferta për punë gjatë studimeve, dhe nëse do ta kishin pranuar vendin e punës apo më parë do t'i kishin përfunduar studimet; 50 përqind u përgjigjen se më parë do t'i kishin përfunduar studimet e tyre.

Grafiku 2.3 Përqindja e respondentëve 15-24 vjeçar që vijnë në mësimet dhe që do të vazhdonin studimet apo do ta pranonin ofertën për punë



¹¹⁵ Banka Botërore, *Kosova, Zbërthimi i Potencialit për Rritje: Strategjitë, Politikat, Veprimet*, prill 2010, f. ix.

¹¹⁶ Enti Statistikor i Kosovës (ESK), *Seria 5: Statistikat Sociale, Hulumtim mbi Ekonomitë Familjare 2009*, Prishtinë, qershor 2010, f.21.

¹¹⁷ Enti Statistikor i Kosovës (ESK), *Seria 5: Statistikat Sociale, Rezultatet e Hulumtimit mbi Fuqinë Punëtore 2009*, Prishtinë, korrik 2010, f.37.

¹¹⁸ Po aty.

¹¹⁹ USAID, *Sistemi për Zhvillimin e Fuqisë Bashkëkohore të Punës është Kyç për Zhvillimin e Kosovës*, maj 2009, f. 32.


Të rinjtë janë posaçërisht të brengosur nëse shkollimi i tyre nuk do t'i përgatis për tregun e punës. Të rinjtë brengosen që planprogrami shkollor ofron pak praktikë profesionale, qoftë në nivelin universitar ashtu edhe në shkollat profesionale. 'Pas katër viteve të studimit të arkitekturës, mendoj se jemi të aftë vetëm t'i pastrojmë zyret. Asgjë tjetër,' ankohet Mirandi, student 19-vjeçar në Shkollën e Mesme Teknike në Prizren.¹²⁰ Shkollat profesionale janë paraparë të ofrojnë përzierje të edukimit të bazuar në shkollë dhe trajnimeve në punë, nëpërmjet lidhjeve të ngushta me tregun e punës dhe bizneset. Në Kosovë nuk kanë ekzistuar këto lidhje në mes shkollave profesionale dhe bizneseve, gjë që e ka minuar rëndësinë e edukimit profesional.

Mungesa e trajnimit praktik nuk ka qenë e pranishme vetëm në shkollimin sekondar profesional. Yllka, studente 23-vjeçare në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, poashtu brengoset për trajnimin e pamjaftueshëm praktik:

Nuk mbajmë praktikë. Edhe pak do të diplomoj në Fakultetin Juridik dhe asnjëherë nuk kam marr pjesë në një dëgjim gjyqësor. Herën e vetme kur e organizuam një vizitë në Kuvend, profesori nuk erdhi. Nëse nuk mbajmë praktikë, si do të bëhemi gati për tregun e punës? Nëse shkojmë në gjykatë, një teknik do të jetë më i mirë se unë sepse ai ka bërë praksë në profesionin e tij. Nëse i pyet studentët e Fakultetit Juridik se çka është 'amendamenti' ata do të përgjigjen përmendsh. Nëse iu kërkon ta bëjnë një amendament, ata do të ngecin sepse kurrë nuk e kanë bërë këtë në praktikë.¹²¹

Tranzicioni nga shkollimi në tregun e punës kurrë nuk ka qenë i lehtë. Megjithatë, një të riu në Kosovë i duhen dhjetë vite për ta kaluar këtë tranzicion, derisa një të riu me moshë të njejtë në Maqedoni do t'i duhen vetëm katër-pesë vite.¹²² Përgatitjet adekuate mund të sigurojnë tranzicion të lehtë në tregun e punës. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me njohurinë për profesionin e caktuar, por edhe me aftësi të transferueshme dhe 'të buta.' Këto të fundit përfshijnë aftësitë siç janë hartimi dhe prezantimi i CV-së; përvojë në punë ekipore; dhe aftësinë komunikuese me kolegë dhe mbikëqyrës. Ato poashtu mund të përfshijnë aftësi të mendimit kritik, të zgjidhjes së problemeve, llogaritjeve dhe mësimin të gjërave të reja.

Grafiku 2.4 Shkalla e të rinjve 15-24 vjeçar që pajtohen apo nuk pajtohen që arsimi të përgatit për punë



¹²⁰ Fokus grupi i IKS me nxënës të shkollës së mesme dhe shkollave profesionale në Prizren, 28 prill 2010.

¹²¹ Fokus grupi i IKS me studentë të universitetit dhe të diplomuar në Gjakovë, 29 prill 2010.

¹²² Banka Botërore, *Kosova, Zbërthimi i Potencialit për Rritje: Strategjitë, Politikat, Veprimet*, prill 2010, f. 60.

Siç është cekur më lartë, shumica e të rinjve janë të vetëdijshëm për rëndësinë e arsimit për karrierën e tyre të ardhshme. Megjithatë, siç shihet në Grafikun 2.4, 14 përqind e të rinjve 15-24 vjeçar ‘pajtohen fuqimisht’ dhe 26.3 përqind ‘pajtohen’ që shkollimi të përgatit për punë. Anasjelltas, 28.4 përqind ‘nuk u pajtuan’ apo ‘nuk u pajtuan fuqimisht’ me deklaratën e Grafikut. 16 përqind as nuk u pajtuan as nuk kundërshtuan dhe 15.3 përqind nuk ditën si të përgjigjen. Përqindja e lartë e përgjigjeve ‘nuk e di’ mund të jetë për shkak të mënyrës se si ishte formuluar pyetja: të rinjtë mund të mos kenë kuptuar nëse pyetja ka të bëjë me teorinë ose praktikën. Hulumtimet e mëtutjeshme, si dhe pyetje më specifike shtesë, mund të ndihmojnë në këtë drejtim.

Studimet jashtë vendit mund të jenë njëra prej mënyrave për të gjetur punë. Më tepër se 71 përqind e respondentëve pajtohen që studimi jashtë vendit mund të ketë ndikim pozitiv në punësim. Arbëri, nxënës 19-vjeçar në Shkollën e Mesme të Mjekësisë në Prizren, komenton:

Mendoj se të rinjtë që studiojnë jashtë vendit kanë gjasa më të mira të gjejnë punë. Nëse diplomon në kontabilitet në Kosovë mund të punosh si llogaritar në supermarketin Ben-Af apo në ndonjë supermarket tjetër. Por nëse studion jashtë vendit mund të gjesh punë në ministri apo në ndonjë vend tjetër më të mirë.¹²³

Megjithatë, shumë pak studentë kanë mundësi të studiojnë jashtë. Kështu që ata duhet të zgjedhin në mes Universitetit të Prishtinës dhe ndonjërit nga institucionet private të arsimit terciar që kanë mbirë si kërpudha në Kosovë në vitet e fundit.¹²⁴

Praktika dhe praksa mund të luaj rol kyç në përgatitjen e të rinjve për tregun e punës. Programet e suksesshme çojnë në gatishmërinë dhe vetëbesimin e të rinjve që të ndërmarrin iniciativa. Nxënësit e Shkollës së Mesme Profesionale *Gjon Nikollë Kazazi* në Gjakovë ishin më të kënaqur me shkollimin e tyre. Ata mendojnë që janë më të përgatitur për tregun e punës sesa moshatarët e tyre në shkollat tjera profesionale për shkak se praksa konkrete ishte përfshirë në planprogramin e tyre. Shpejtimi, nxënës 18-vjeçar në *Gjon Nikollë Kazazi*, flet me siguri dhe vetëbesim për të ardhmen e tij:

Planifikoj t’i vazhdoj studimet në shkenca kompjuterike, dhe dua ta hap biznesin time për furnizimin dhe riparimin e pajisjeve meqë unë specializoj në riparimin e kompjuterëve. Ka shumë biznese të këtij lloji, mirëpo ata nuk e kanë shkollimin adekuat dhe punojnë sipas metodave të vjetra. Ata nuk i din gjërat që ne i kemi mësuar rishtazi. Ndjej se jam i përgatitur për punë dhe se nuk dalloj fare nga dikush që tashmë e ka një biznes të tillë.¹²⁵

Karitasi Zviceran e ka financuar Shkollën e Mesme Profesionale *Gjon Nikollë Kazazi*. Shkolla ka gjashtë laboratorë për gjashtë profesionet të cilat i ofron. Ekzotina, nxënëse 17-vjeçare në degën e administrimit të biznesit, komenton:

¹²³ Fokus grupi i IKS me nxënës të shkollës së mesme dhe shkollave profesionale në Prizren, 28 prill 2010.

¹²⁴ Institucionet private të arsimit terciar, pas procesit të akreditimit të zhvilluar nga Këshilli Britanez në vitin 2008, ekzistojnë në formë të kolegjeve, dhe ‘shkollave të larta profesionale’ varësisht nga kapacitetet dhe profilet e tyre.

¹²⁵ Fokus grupi i IKS me nxënës të shkollës së mesme dhe shkollave profesionale në Gjakovë, 29 prill 2010.

I kemi të gjitha kushtet e nevojshme. Administrata e biznesit e ka laboratorin e vet, e po kështu edhe dega e shkencave kompjuterike. Studentët e degës së bujqësisë e kanë zonën e tyre të vogël të gjelbër në oborrin e shkollës. I kemi dy laboratorë kompjuterik ku mund të hulumtojmë dhe të praktikojmë atë që mësojmë. Gjatë dy viteve të fundit të shkollimit, duhet ta bëjmë praksën një herë në javë jashtë shkollës dhe në kompani të ndryshme.¹²⁶

Ekzotina dëshiron të studioj marketing dhe ta hap biznesin e saj.

Ngjashëm me këtë, njëri prej dallimeve kryesore në mes studentëve të Universitetit të Prishtinës dhe universitetit më prestigjioz privat, Universitetit Amerikan në Kosovë (AUK), ka qenë përfshirja e obligueshme e praktikës në planprogramin shkollor. Në AUK, studentët duhet të kryejnë 400 orë të praktikës gjatë katër viteve të studimit dhe 85 përqind e studentëve kanë marrë oferta për punë si rezultat i praktikës së tyre. Në anën tjetër, Universiteti i Prishtinës, nuk ka paraparë praksë për shumicën e programeve të studimit. Studentët e interesuar janë mbështetur në kontaktet e tyre apo në angazhimin e profesorëve përkrahës.¹²⁷

Nëpërmjet praksave apo trajnimeve në punë, studentët mund të mësojnë për profesionin e tyre në një mjedis realist, si dhe t'i kuptojnë kërkesat e tregut të punës. Sipas hulumtimit të USAID-it për punëdhënësit në mbarë Kosovën, 'Të gjitha ndërmarrjet besojnë përgjithësisht që shkollat e mesme, si dhe universitetet (me disa përjashtime të universiteteve private) janë të vjetruara dhe i përgatisin studentët për profesione të vjetruara.'¹²⁸ Bazuar në përvojën e tyre në intervistimin e nëpunësve potencial, ndërmarrjet thanë që shumë pak kandidatë 'posedojnë nivelin adekuat të aftësive teknike për vendin e caktuar të punës; të gjithë kanë nevojë për trajnim të mëtutjeshëm.' Një problem tjetër është mungesa e 'aftësive të buta.' Nëpunësit aktual si dhe kuadrot e reja në përgjithësi nuk posedonin këto aftësi. Disa ndërmarrje thanë që kanë ofruar praksa, dhe ishin të interesuar të jenë pjesë e programeve të praksës, mirëpo universitetet nuk i kishin kontaktuar ato.¹²⁹

Për ta rritur rëndësinë e shkollimit për punësim, USAID sugjeron përfshirjen e përfaqësuesve të bizneseve lokale në bordet e shkollave. Nëpërmjet kësaj, përfaqësuesit e biznesit do të mund të jepnin kontributin e tyre në hartimin dhe përqendrimin e planprogramit shkollor. Deri më tani, kanë munguar tërësisht lidhjet në mes bizneseve rajonale dhe shkollimit. Për shembull, hulumtimi i IKS-it në komunën e Rahovecit zbuloi që përkundër përqendrimit të fuqishëm rajonal në prodhimin e verës, asnjë shkollë profesionale nuk ofron specializime në profesione që kanë të bëjnë me prodhimin e verës.¹³⁰ Përshtatja e shkollimit profesional me kërkesat dhe mundësitë e çdo komune si dhe përfshirja e bizneseve përkatëse në këtë proces do t'iu mundësonte studentëve të punojnë në komunën e tyre anë dhe me gjasë do ta zvogëlonte edhe shpërnguljen rurale-urbane në Prishtinë. Përveç kësaj, kjo do t'iu mundësonte bizneseve lokale ta trajnojnë gjeneratën e re të nëpunësve në aftësitë konkrete që kërkohen.

Për ta bërë shkollimin me relevant për tregun e punës dhe për ta lehtësuar kështu tranzicionin nga shkollimi në punësim, planprogramet e shkollave dhe universiteteve

¹²⁶ Po aty.

¹²⁷ USAID, *Sistemi për Zhvillimin e Fuqisë Bashkëkohore të Punës është Kyç për Zhvillimin e Kosovës*, maj 2009, f. 32.

¹²⁸ Po aty, p. 22 and p. 34.

¹²⁹ Po aty, p. 23.

¹³⁰ IKS, *Rahovec – Brussels Express*, nëntor 2009.

duhet t'i përshtaten kërkesave të tregut të punës. Këshillat për karrierë luajnë rol të rëndësishëm në vendimet e të rinjve për të ardhmen e tyre. Informatat rreth opsioneve të ndryshme pas shkollës, siç janë mundësitë shtesë të punësimit, praksat, përvoja e punës apo kurset profesionale, mund të jenë të dobishme për të rinjtë që vendosin për profesionet e tyre të ardhshme. Këto zgjidhje duhet të jenë të bazuara mirë në analizën konkrete të kërkesave të tregut të punës.

Megjithatë, në Kosovë pothuajse nuk ka pasur fare këshilla për karrierë për studentë dhe të diplomuar. Iniciativat e pakta të këshillave për karrierë financoheshin dhe udhëhiqeshin nga donatorët, prandaj nuk mund të ofronin zgjidhje të qëndrueshme për çdo komunë. Kosova ende ka mungesë të të dhënave të besueshme për tregun e punës dhe ekonominë. Enti Statistikor i Kosovës dhe ministritë më relevante nuk kanë kapacitetet adekuate financiare dhe njerëzore për mbledhjen e këtyre të dhënave. Futja e këshilltarëve për karrierë në shkollat e mesme të larta dhe në universitete, siç ndodh në vendet e tjera, mund t'i pajis të rinjtë me informata për vendimet rreth profesioneve të tyre të ardhshme. Informata dhe trajnimet mund të përfshijnë këshillat për karrierë, mësimet për hartimin e CV-së, zhvillimin e intervistave dhe praksat e obligueshme, posaçërisht në shkolla profesionale dhe në universitete. Uebportalet ku të rinjtë mund t'i prezantojnë CV-të e tyre dhe punëdhënësit mund të shpallin vende të lira të punës mund të shërbejnë si lidhje në mes kërkesave të tregut dhe aftësive ekzistuese. Vendet e tjera e përdorin shpesh dhe me sukses këtë praktikë.

Njerëzit që i njoh

Një brengë tjetër e të rinjve ishte joformaliteti gjatë procesit të punësimit. Graniti, një 22-vjeçar i zhgënjyer shpjegon: 'Fatkeqësisht, në Kosovë, kualifikimet nuk merren parasysh. Askush nuk të pyet çka din, por kush je dhe kënd e njeh, apo në cilën parti je. Edhe unë e kam gjetur këtë vend të punës nëpërmjet lidhjeve personale.'¹³¹ Miloti, 22-vjeçar, shprehet ngjashëm:

Nuk është me rëndësi sa i kualifikuar je; është shumë vështirë të gjesësh punë në Prishtinë nëse nuk ke lidhje personale. Unë kam aplikuar në çdo vend të lirë të punës që kam parë por asnjëherë nuk më kanë ftuar në intervistë. Mund të them lirshëm që asnjëri prej shokëve të mi që punojnë nuk e kanë ftuar vendin e punës nëpërmjet konkurrimit apo intervistës; të gjithë i kanë ftuar vendet e tyre të punës me anë të lidhjeve personale, dhe e njëjta vlen edhe për mua.¹³²


Valdeti, student 24-vjeçar i bankave dhe financave në një kolegji privat, pajtohet me këtë, 'Në përgjithësi, bizneset janë biznese familjare dhe ta fitosh një vend të punës aty duhet të kesh lidhje familjare me ata njerëz.'¹³³ Shumë të rinj tjerë e ndajnë këtë mendim. 76.5 përqind të respondentëve të moshës 15-24 vjeçare pajtohen që gjasat për punësim janë më të mëdha nëse ke kontakte familjare apo të njohshëm. Për më tepër, siç shihet në Grafikun 2.5, 38.3 përqind të respondentëve të moshës 15-24 vjeçare thanë se strategjia për karrierë është 'të njohësh njerëzit e duhur,' derisa 45.7 përqind përmendën 'punën e madhe' dhe 40.9 përqind thanë që 'shkollimi i përfunduar' është strategji për karrierë.

¹³¹ Intervista e IKS me Granit Abdullahun, Prishtinë, 9 prill 2010.

¹³² Intervista e IKS me Milot Rexhepin, student i shkencave politike, Prishtinë, 9 prill 2010.

¹³³ Fokus grupi i IKS me studentë universitar dhe të kolegjit në Prizren, 28 prill 2010.

Grafiku 2.5 Tri strategjitë kryesore të karrierës sipas respondentëve të moshës 15-24 vjeçare



Strategjitë e të rinjve për kërkim të punës dhe anekdotat personale përshkruajnë mungesën e besimit të tyre në Shërbimet për Punësim Publik (SHPP). Edona thotë, ‘që disa vite, sa herë që dilnim jashtë, nëna ime gjithmonë ndalej tek zyra për punësim dhe thoshte se duhet të regjistrohej. Tash e kam fituar përshtypjen se vetëm duhet të shkosh në zyrën për punësim për t’u regjistruar vetëm sa për formalitet.’¹³⁴ Në fakt, nga të gjitha ndërmarrjet e hulumtuara nga USAID, vetëm njëra prej tyre tha se e kishte punësuar një person nëpërmjet shpalljes në Shërbimet për Punësim Publik (SHPP).¹³⁵

SHPP ka shtatë qendra rajonale, 23 zyra komunale dhe gjashtë nën-zyre për punësim. Ato janë përgjegjëse për mbledhjen e shpalljeve për punësim dhe përputhjen e aplikantëve për punë me këto vende të lira të punës, si dhe për informimin dhe këshillimin e të papunëve. Në anën tjetër, shkalla e tyre e suksesit në sigurimin e vendeve të punës për të papunët ka qenë e ulët për shkak të kapaciteteve të tyre të dobëta njerëzore dhe financiare. Në vitin 2009, një zyrtar kosovar për punësim duhej të merrej me 1,862 të papunë, që është 12 herë më e lartë se mesatarja evropiane.¹³⁶ Përveç kësaj, shumica e shpalljeve për vende të lira të punës nuk u postuan në SHPP. Në ato që u postuan, mesatarisht për çdo muaj, konkurruan 490 të papunë për një vend të lirë të punës.¹³⁷ Prandaj, SHPP ka pasur rol të parëndësishëm në gjetjen e vendeve të punës.¹³⁸ Kjo mund të jetë rezultat i shkallës së ulët të regjistrimit të njerëzve të papunë. Në vitin 2006, 84 përqind e të rinjve të papunësuar nuk u regjistruan kurrë në SHPP. Në mesin e tyre që u regjistruan, 88 përqind thanë se nuk kishin marrë ndihmë.¹³⁹

Të dhënat e pamjaftueshme për kërkesat e tregut të punës, të shoqëruara me joefikasitetin e SHPP-së, dëshmojnë që procesi i përputhjes së aplikantëve për punë dhe vendeve të lira të punës nuk ka shkuar nëpërmjet kanaleve zyrtare të SHPP-së por nëpërmjet rrjeteve joformale shoqërore. Kjo nuk përfaqëson një mekanizëm të qëndrueshëm dhe të barabartë të kërkimit të vendeve të punës sepse iu jep përparësi njerëzve me lidhjet e duhura. Rritja e efikasitetit të SHPP-së mund të çojë në uljen e këtij fenomeni. Si lidhje e rëndësishme në mes aplikantëve për punë dhe tregut të punës, SHPP ka nevojë të forcohet. SHPP poashtu ka nevojë për një buxhet të mjaftueshëm për kurse të trajnimit, këshilla për karrierë dhe informata mbi tregun e punës. SHPP ka nevojë edhe për kuadro të kualifikuara dhe të afta që janë dëshmuar si iniciatorë aktiv në kërkimin e vendeve të lira të punës.

¹³⁴ Po aty.

¹³⁵ USAID, *Sistemi për Zhvillimin e Fuqisë Bashkëkohore të Punës është Kyç për Zhvillimin e Kosovës*, maj 2009, f. 23.

¹³⁶ Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, *Puna dhe Punësimi 2009*, f. 9.

¹³⁷ Po aty, p. xii.

¹³⁸ Fondacioni Evropian për Trajnime, *HRD Analizë e Vendit Kosovë*, Draft i Dokumentit të Punës, korrik 2009, f. 8.

¹³⁹ Kuddo, A., *Opsionet e Politikave për Tregun e Punës dhe Punësimin për të Rinjtë në Kosovë*, Uashington, D.C.: Banka Botërore, 2008.

Përgjigja e qeverisë?

Prioriteti afatmesëm i qeverisë për periudhën 2006-2008 kishte paraparë të ulte papunësinë dhe të krijonte vende të punës për fuqinë e re punëtore e cila po shtohet shpejt. Për ta arritur këtë qëllim, strategjitë makroekonomike dhe fiskale ishin drejtuar kah zhvillimi i sektorit privat dhe rritja e konkurrencës në sferën ndërkombëtare. Megjithatë, qeveria ka dështuar ta zbatoj këtë prioritet siç tregojnë edhe shkallët në rritje të papunësisë në Tabelën 3.¹⁴⁰ Në përgjithësi, shkalla e papunësisë është rritur nga 41.4 përqind në vitin 2005 në 45.4 përqind në vitin 2009. Në mesin e të rinjve të moshës 15-24 vjeçare, kjo shkallë është rritur nga 70.5 në 73 përqind.

Tabela 3.

	2005	2006	2007	2008	2009
Të papunë (15-64)	41.4%	44.9%	43.6%	47.5%	45.4%
Të papunë (15-24)	70.5%	75.5%	70%	73%	73%

Burimi: ESK, Hulumtimet e Fuqisë Punëtore, 2005-2008

Përkundër shkallës së lartë të papunësisë në mesin e të rinjve, prioritetet e qeverisë për periudhën afatmesme 2008-2011 ndryshuan. Me këtë ndryshoi edhe orientimi i buxhetit të Departamentit të Punës në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Në vitin 2009, qeveria akordoi €159.9 milion për MPMS-në, që nënkuptonte ngritje prej 1.4 përqind krahasuar me buxhetin e vitit 2008. Megjithatë, kjo rritje nuk u pasqyrua në buxhetin e Departamentit për Punë dhe Punësim, i cili është përgjegjës për hartimin e politikave për të rinjtë. Përkundrazi, buxheti i këtij departamenti në vitin 2009 (€2.7 milion) u zvogëluar për 36 përqind krahasuar me vitin 2008 (€4.2 milion). E njëjta vlen për SHPP-në, e cila në atë kohë ishte agjencioni udhëheqës për zbatimin e *Planit të Veprimit për Punësimin e Rinisë Kosovare 2007-2013 (PVPRK)*, dokumenti kyç i politikave për punësimin e të rinjve në Kosovë.

PVPRK përmbante strategjinë kryesore të qeverisë për trajtimin e papunësisë së të rinjve me anë të ‘promovimit të punësimit,’ ‘rritjes së mundësive modeste për punë’ dhe ‘parandalimit të përjashtimit shoqëror me anë të masave në tregun e punës.’ Këto synime duhet të administroheshin dhe bashkërendoheshin nga MPMS dhe të zbatoheshin nga SHPP-ja. Plani parashihte përfshirjen e institucioneve joqeveritare dhe krijimin e Komitetit Ndërmintor për Punësimin e të Rinjve për ta mbikëqyr zbatimin e dokumentit dhe për të raportuar tek ministrinë individuale. Përkundër ose për shkak të synimeve ambicioze, mekanizmi zbatues nuk u themelua kurrë. Mungesa e bashkërendimit ndërministror e pengoi zbatimin e planit të veprimit për punësimin e të rinjve. Kapacitetet administrative të MPMS-së kanë mbetur të dobëta.¹⁴¹

Deri më sot nuk është hartuar asnjë strategji e re si vazhdimësi e PVPRK-së e cila mbaroi në vitin 2010. Synimet ambicioze të qeverisë, sado të lavdërueshme që janë, kanë dështuar të prodhojnë rezultate konkrete në luftën kundër papunësisë së të rinjve dhe nuk ka fare zhvillimore strukturore. Ndërrimi i orientimit dhe zvogëlimi i buxhetit të Departamentit për Punë dhe Punësim shtron pyetje rreth përkushtimit afatgjatë të

¹⁴⁰ Mbi faktorët që kontribuojnë në dështime, shih Zyra Ndërkombëtare e Punës, *Trancizioni i të Rinjve në Punë Modeste: Dëshmi nga Kosova*, prill 2007, f. 43.

¹⁴¹ Komisioni Evropian, Raport i Progresit për Kosovën nën Rezolutën 1244/99 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Bruksel, tetor 2009.

qeverisë për reforma në ekonomi dhe në tregun e punës dhe në frenimin e papunësisë së të rinjve.

Donatorët ndërkombëtar në Kosovë kanë provuar ta ulin papunësinë e të rinjve, kryesisht me anë të kurseve dhe praksave. Disa donatorë kanë zbatuar programe aktive të tregut të punës, dhe programet më të mëdha janë udhëhequr nga Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara (UNDP), Asistenca Teknike Gjermane (GTZ), Komisioni Evropian (KE) dhe Lux Development.

Programet Aktive të Tregut të Punës (PATP) synuan të përkrahin grupet e papunësuarra dhe të ndjeshme siç janë rinia, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit, që të gjejnë punë duke e stimuluar tregun e punës. Programet mund të ndahen pak a shumë në programe aktive dhe pasive. Programet aktive përfshijnë trajnime, praksa dhe programe të punës publike.¹⁴² Këto programe duhet të përshtaten me nevojat dhe kushtet specifike të vendit. Megjithatë, përvojat e kaluara tregojnë që as subvencionet e punësimit e as skemat e mëdha të punësimit publik nuk janë treguar të suksesshme në Kosovë për shkak të kapaciteteve të dobëta të administratës publike dhe mungesës së bashkërendimit në mes ministrive, shoqatave të nëpunësve dhe partnerëve social.¹⁴³

Zbatimi dhe financimi i PATP-ve ka qenë kryesisht në duart e donatorëve. Megjithatë, disa prej tyre kanë punuar me ose nëpërmjet MPMS-së si ministri relevante, me SHPP-të apo më Zyrat Komunale për Punësim (ZKP). Përkundër faktit që rreth €7 milion janë shpenzuar çdo vit në PATP-të në Kosovë, me 19 programe që nga viti 2000, programet kanë pasur mbulim të kufizuar.¹⁴⁴ Meqë shumica e programeve kanë qenë në shkallë të ulët, kosto e trajnimit të çdo përfituesi individual ka qenë rreth €700 në vit. Bashkërendimi i dobët në mes donatorëve ne qasjen dhe zbatimin e programeve, si dhe mungesa e MPMS-së si forcë qendrore e organizimit, e ka larguar vëmendjen nga programet sistematike që mund të sjellin përfitime për më shumë njerëz dhe t'i ulin shpenzimet. Edhe pse rreth 10,000 të rinj kanë përfituar nga PATP-të në vitin 2007, ky numër përfaqëson vetëm 6.3 përqind të të gjithë të rinjve të papunë të moshës 15-24 vjeçare.

Shumica e PATP-ve në Kosovë kanë prekur sektorin e Trajnimit dhe Shkollimit Profesional (10 programe). Në anën tjetër, kërkesa e ulët për punë e ka minuar suksesin afatgjatë të këtyre programeve. Prandaj shumë pak të trajnuar kanë gjetur vende të punës.¹⁴⁵ Kërkesa e ulët për punë dhe shkollimi i dobët duhet të adresohen njëkohësisht në mënyrë që të rriten gjasat e të rinjve për punësim. Derisa kjo e fundit mund të përkrahet nga veprimet e përbashkëta, të qëndrueshme dhe afatgjate të qeverisë dhe donatorëve, e para kërkon reforma më të gjëra afariste, përfshirë nxitjet më të mëdha për bizneset në Kosovë.¹⁴⁶

Të ikim apo të mos ikim!

Papunësia nuk është ndonjë risi për kosovarët, sepse edhe në kohën e Jugosllavisë Kosova kishte shkallën më të lartë të papunësisë, prandaj edhe rajoni ishte më së paku

¹⁴² Muckavilli, S., *Vlerësimi i Programit të Tregut Aktiv të Punës në Kosovë*, 2008, ff. 9-10.

¹⁴³ Fondacioni Evropian për Trajnime, *HRD Analizë e Vendit Kosovë*, Draft i Dokumentit të Punës, korrik 2009, f. 9.

¹⁴⁴ Banka Botërore, *Rinia Kosova në Rrezik: Të qenit i Ri, i Papunë dhe i Varfër në Kosovë*, shtator 2008, ff. 37-38.

¹⁴⁵ Po aty, p. 40.

¹⁴⁶ Banka Botërore, *Të Bërit Biznes 2010*, 2010, f. 2.

i zhvilluar dhe në fillim të viteve 1970-ta shumë njerëz filluan të mendojnë të shpërngulen nga vendi. Migrimi, për një kohë të gjatë, ka mundësuar shkarkimin e presionit mbi tregun e vogël të punës në Kosovë.¹⁴⁷ Popullata e vjetruar e Evropës shumë shpejt mund të ketë nevojë për një fuqi të punëtore. Qeveria e Kosovës mund të hyj në marrëveshje bilaterale me vendet e interesuara të BE-së për t'i identifikuar kërkesat e tregut të punës dhe të hartoj programe për ofrimin e punës. Shpërngulja afatshkurtre mund të bashkërendohet, kontrollohet dhe rregullohet në mënyrë bilaterale. MPMS duhet ta marrë rolin udhëheqës në hartimin e programit në emër të Qeverisë së Kosovës. MPMS tashmë e ka zhvilluar një pilot projekt duke qenë e para kështu që hap rrugën në këtë drejtim.

Hulumtimi tregoi që papunësia është brenga më e madhe e të rinjve; shkalla e papunësisë për grupmoshën 19-24 vjeçare arrin në 73 përqind. Të rinjtë kosovarë marrin vendime për shkollimin e tyre të mëtutjeshëm kryesisht në bazë të perceptimit të kërkesave të tregut të punës, dhe në mungesë të këshillave apo udhëzimeve profesionale për zgjedhjen e karrierës së tyre. Prandaj, këshillat për karrierë duhet të zbatohen urgjentisht nëpër shkolla, të përcjella me hulumtim të hollësishëm të kërkesave të tregut të punës në Kosovë.

Kërkesat e tregut të punës duhet të përshtaten me aftësitë ekzistuese. Një zgjidhje në këtë drejtim janë uebportalet ku të rinjtë mund t'i paraqesin CV-të e tyre dhe punëdhënësit mund të shpallin vende të lira të punës, kjo është dëshmuar si praktikë e suksesshme në vendet e tjera. Kjo mund të ndihmojë në zvogëlimin e joformaliteteve gjatë procesit të përzgjedhjes dhe rekrutimit. Kjo uebfaqe do të ishte në dispozicion të të rinjve anëmbanë Kosovës. MPMS, në bashkëpunim të ngushtë me bizneset, mund ta inicioj një projekt të tillë.

Për t'i përgatitur më mirë të diplomuarit për tregun e punës, praktika e obligueshme duhet të jetë pjesë e planprogramit universitar. AUK është shembull i shkëlqyeshëm në këtë drejtim. Duhet të merren parasysh edhe marrëveshjet për zhvillimin e praksës në organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë. MASHT-i duhet të studioj mundësi të tjera për lidhjen e marrëveshjeve për zhvillimin e praksës në mes universiteteve në Kosovë dhe atyre në rajon.

Universiteti i Prishtinës së bashku me institucionet private terciare në Kosovë mund të organizojnë 'Panaire të Karrierës.' Kjo iniciativë do të shërbente si platformë ku bizneset e suksesshme mund t'i promovojnë kërkesat e tyre të punës dhe studentët mund të marrin informata adekuate për tregun e punës. Në këtë mënyrë e kanë më të lehtë të identifikojnë se çfarë kursesh dhe praktikë ju duhet. Kompanitë në të njëjtën kohë kanë mundësinë e promovimit të punës së tyre dhe të njoftohen me fuqinë puntore. Mundësia e praktikës në këto kompani mund të promovohet edhe gjatë 'Ditëve të Karrierës'. Kjo iniciativë nuk duhet të përfshij vetëm bizneset në Kosovë por duhet të jetë platformë për lidhjen me bizneset tjera në rajon dhe Evropë. Do të duhej të studiohej edhe roli i ambasadave të huaja në Kosovë në këtë drejtim.

¹⁴⁷ Banka Botërore, *Kosova, Zbërthimi i Potencialit për Rritje: Strategjitë, Politikat, Veprimet*, prill 2010, f. 56.

INKURAJIMI I PJESËMARRJES SË TË RINJVE

‘Ka shumë gjëra që nuk shkojnë si duhet për të rinjtë në Kosovë. Ato më brengosëse janë papunësia dhe përjashtimi i të rinjve nga proceset vendimmarrëse.’

- Iliri, student 22-vjeçar nga Prishtina

Në mungesë të kanaleve zyrtare për përfaqësimin e interesave të tyre, zhgënjimit me status kuon, përfshirë këtu edhe arsimin e dobët dhe shkallën e lartë të papunësisë, të rinjtë kosovarë më parë mund të shndërrohen në faktorë të destabilitetit sesa të ndryshimeve pozitive. Integrimi i përmirësuar i të rinjve në shoqëri dhe në punë është kyç për të siguruar kthimin kah rritja e vazhdueshme dhe e qëndrueshme.¹⁴⁸

Në vitin 2006, Raporti për Zhvillim Njerëzor i Programit Zhvillimor të Kombeve të Bashkuara argumentonte që rinia kosovare ka ndikim tejet të vogël në institucionet vendimmarrëse për shkak të dy arsyeve. Së pari, institucionet shpeshherë nuk ndejnë obligim t’i respektojnë të drejtat e të rinjve për pjesëmarrje, dhe e dyta, të rinjtë nuk e shohin të drejtën e tyre për pjesëmarrje si detyrim qytetar.¹⁴⁹

Ky kapitull trajton etjen e të rinjve për të qenë pjesë e proceseve vendimmarrëse si dhe përfshirjen e të rinjve nga ana e qeverisë. Kapitulli së pari trajton pjesëmarrjen e hershme në vendimmarrje përbrenda familjes, gjë që mund të ndikoj në pjesëmarrjen e gjerë të të rinjve si qytetarë aktiv. Së dyti, kapitulli trajton etjen e të rinjve për të qenë pjesë e proceseve vendimmarrëse dhe pjesëmarrjen e tyre në organizata rinore. Së treti, kapitulli trajton përgjigjen e qeverisë ndaj të rinjve dhe përpjekjet e të rinjve për të siguruar që zëri i tyre po dëgjohet. Në fund, kapitulli shqyrton disa sfida për të ardhmen.


Zhvillimi i gjeneratës së re të qytetarëve aktiv: Pjesëmarrja në familje

Brenda shtëpive të tyre, fëmijët mësojnë nëse zëri i tyre dëgjohet. Shkalla e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje në familjet e tyre mund të ndikoj në pjesëmarrjen e tyre në proceset vendimmarrëse më vonë në jetë. Prandaj, IKS ka ekzaminuar pjesëmarrjen e të rinjve në familjet e tyre. Të rinjtë e grupmoshave 10-14 vjeçare u pyetën, ‘Kur në shtëpi merret një vendim që ka të bëjë me ty, a e marrin prindërit parasysh mendimin tënd?’ Fëmijët interpretuan vet se cilat vendime ‘kanë të bëjnë’ me ta. Siç ilustron Grafiku 3.1, 36.3 përqind të respondentëve mendojnë se mendimi i tyre gjithmonë merret parasysh. Shumica e respondentëve (46.4 përqind) thanë që mendimi i tyre nganjëherë merret parasysh, dhe 15.8 përqind mendonin se mendimi i tyre kurrë nuk merret parasysh. Prandaj, shumica e të rinjve mendojnë se ata kanë hise në vendimet që merren në familjet e tyre.

¹⁴⁸ Komisioni Evropian, Komunikatë e Komisionit për Këshillin, Shtojcë në “Adresimin e brengave të të rinjve në Evropë – zbatim i Paktit Evropian për Rininë dhe promovimi i qytetarisë aktive,” SEC (2005) 693, Bruksel, 30 Maj 2005.

¹⁴⁹ Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara (UNDP), *Rinia: Një Gjeneratë e Re për Kosovën*, Raport i Zhvillimit Njerëzor, 2006, f. 75.

Grafiku 3.1 Pjesëmarrja në vendimmarrje në shtëpi e grupmohave 10-14-vjeçare



Më tepër vajza (41.8 përqind) se djem (30.8 përqind) mendojnë se mendimi i tyre gjithmonë merret parasysh. Megjithatë, diskutimet në fokus grupet e IKS-it tregojnë që kjo situatë dallonte për vajzat në Mamushë, ku banon shumica e turqve të Kosovës, dhe në zonën rurale të Dragashit.

Mamusha ka qëndrim konservativ ndaj pjesëmarrjes së vajzave në vendimmarrje dhe në aktivitete të kohës së lirë.¹⁵⁰ Normat e vendimmarrjes brenda familjes vendosin se si vajzat e shkollës së mesme lokale e kalojnë kohën e tyre të lirë. Seda, 18-vjeçare dhe studente e shkencës shpjegon, 'Për djelmoshat nuk është problem. Ata mund të bëjnë çka të donë dhe të shkojnë ku të donë. Sapo e mbarojmë mësimin ne shkojmë menjëherë në shtëpi.' Djelmoshat në shkollën e saj janë anëtarë të klubit lokal rinor, Aplerenler Gençlik Derneği (*Klubi Rinor Aplerenler*), ku organizohen aktivitete siç janë kurset e gjuhëve dhe kurset kompjuterike. Thotë Ajshja, 'Vajzat nuk shkojnë aty. [...] Ne rrimë në shtëpi, i kryejmë punët e shtëpisë, stolisim me gajtanë ose shkojmë në kurse të Kuranit.' Vajzat kanë shprehur interesim të vijnë kurset që ofrohen në klubin rinor, por shpjeguan që nuk mund të shkojnë vetëm. Prandaj, pjesëmarrja e vajzave në aktivitete rinore dukej të ishte problem i veprimit kolektiv: nëse më tepër vajza mund të organizohen të shkojnë bashkë, ato mund të kenë mundësi të marrin pjesë në aktivitete sociale dhe mësuese jashtë shtëpive të tyre.

Situatë e ngjashme mbretëron edhe në komunën e Dragashit.¹⁵¹ Derisa djemtë gëzojnë lirinë të bëjnë çka të donë, vajzat duhet të kthehen menjëherë në shtëpi pas mësimit. Në Dragash, kjo ka të bëjë pjesërisht me qëndrimin konservativ ndaj sjelljes së vajzave, por poashtu është e lidhur edhe me brengat e sigurisë. Transporti i kufizuar publik e vështirëson kthimin e nxënësve nga shkolla në fshat, dhe prindërit nuk dëshirojnë që vajzat e tyre të ecin në këmbë deri në shtëpi pa përcjellje ose në errësirë.¹⁵²

Prandaj, normat gjinore në disa pjesë të Kosovës duket se kanë ndikuar në mundësinë e disa të rinjve për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse në shtëpi. Kjo posaçërisht vlen për vajzat në viset rurale dhe ka ndikuar në pjesëmarrjen e tyre publike. Transporti më i mirë dhe më i lirë publik deri në shkollë dhe pastaj në shtëpi

¹⁵⁰ Fokus grupi i IKS me nxënës të shkollës së mesme Ataturk në Mamushë, 6 maj, 2010.

¹⁵¹ Fokus grupi i IKS me nxënës të shkollës së mesme Ruzhdi Berisha, Komuna e Dragashit, 5 maj, 2010.

¹⁵² Për më tepër shih kapitullin për arsimin.


si dhe aktivitetet rinore që përqendrohen tek vajzat e reja mund t'i ulin brengat e prindërve dhe t'iu mundësojnë vajzave pjesëmarrje më të madhe në aktivitete pas mësimit.

Etja e të rinjve për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse

Është më se e ditur që organizatat rinore mund të luajnë rol të rëndësishëm në inkurajimin e pjesëmarrjes së vajzave dhe djemve të rinj në jetën publike.¹⁵³ Këshillat e shkollave, grupet rinore dhe aktivitetet ekstrakurrikulare mund t'iu mundësojnë të rinjve që nga moshë e hershme të zhvillojnë aftësi në vendimmarrje, demokraci, lidhshmëri dhe avokim. Pavarësisht nga kjo, hulumtimi i IKS-it në mbarë Kosovën ofroi dëshmi që shumë pak të rinj kosovar marrin pjesë në këto aktivitete. Vetëm 16 përqind të respondentëve të grupmoshave 10-14 dhe 14 përqind e grupmoshës 15-24 thanë se kanë marrë pjesë në ndonjë organizatë ose klub. Në të dyja grupmoshat, numri i respondentëve meshkuj ishte më i madh se ai i femrave.

Për anëtarët e grupmoshës 10-14 që morën pjesë në organizata, aktivitetet më joshëse ishin sporti, vallëzimi dhe muzika. Siç ilustron Grafiku 3.1, 6.5 përqind morën pjesë në klub sporti, 4.1 përqind në klub vallëzimi dhe 3.2 përqind në klub muzike. Rreth 2 përqind ishin anëtarë të klubeve lokale rinore, 1.6 përqind ishin anëtarë të këshillit të shkollës, 1.1 përqind ishin të përfshirë në organizata artistike dhe 0.2 përqind në grupe fetare.

Grafiku 3.2 Lloji i organizatave në të cilat marrin pjesë grupmoshat 10-14 vjeçare



Trende të ngjashme janë vërejtur edhe në mesin e të rinjve 15-24 vjeçar. Në mesin e 14 përqind të atyre që marrin pjesë në grupe të organizuara, më së shpeshti frekuentohen klubet e sportit (7.6 përqind). Më pak të rinj janë anëtarë të klubeve rinore (2 përqind), klubeve artistike (1.6 përqind), këshillave të shkollës (1.2 përqind), OJQ (1.1 përqind), partive politike (0.2 përqind) dhe grupeve fetare (0.2 përqind).

Në përgjithësi, nëse kaq pak të rinj marrin pjesë në aktivitete ekstrakurrikulare, atëherë çka bëjnë të rinjtë kosovar në kohën e lirë? Oktaj, 18-vjeçar i diplomuar në

¹⁵³ Annica Holmberg, Sekretare e Përgjithshme e Forumit SYD, Fjalim në Konferencë e Dytë Rajonale të Forumit Syd mbi Politikën për të Rinjtë dhe Pjesëmarrjen Qytetare të të Rinjve, 13-14 prill, 2010.

shkollë të mesme, e konfirmon përshtypjen që mund ta ketë çdo vizitor në Kosovë: ‘Si çdo i ri tjetër pasiv, unë e kaloj kohën e lirë në kafeteri. Nuk kemi ndonjë alternativë tjetër.’¹⁵⁴ Kur nuk janë në shtëpi, kafeteritë duket të jenë zgjidhja më e preferuar e të rinjve kosovar që të mblidhen me shoqëritë e tyre. Afro 48 përqind e grupmohave 15-24 vjeçare thonë se takimi me shoqërinë është aktiviteti më i shpeshtë i kohës së lirë.

Të rinjtë poashtu kalojnë një pjesë të madhe të kohës së tyre pranë kompjuterit, qoftë në shtëpi apo në internet kafe. IKS zbuloi se 23.2 përqind e të rinjve 10-14 vjeçar pëlqejnë përdorimin e internetit në kohë të lirë, dhe 60 përqind e grupmohës 15-24 vjeçare i kalojnë dy-tri orë para kompjuterit. Më tepër se 48 përqind përdorin kompjuterin për rrjetëzim social, kryesisht në Facebook dhe MSN Instant Messenger.

Edhe pse shumë pak të rinj kosovar janë të përfshirë në aktivitete ekstrakurrikulare, Engelbert, aktivist i ri i cili udhëheq një organizatë të suksesshme rinore në Pejë, beson që rinia ka dëshirë të marr pjesë. Megjithatë, rinia heziton sepse nuk janë të vetëdijshëm për të drejtën e tyre për pjesëmarrje, thotë ai. Ai përmend shembullin e një rasti që ka pasur rishtazi në organizatë:

Iniciativa ishte t’i testojmë të rinjtë në fushën e ideve kreative për hapjen e bizneseve që mund t’iu ndihmojnë në të ardhmen. Të rinjtë nga i tërë qyteti kanë aplikuar për ta vijuar testin, përveç të rinjve të lagjes ku është mbajtur testi. Ata nuk kishin guxim të afrohen dhe të pyesin për çka po bëhej fjalë. Nuk u ndjeva mirë sepse e njoh shumicën e njerëzve në lagje, dhe i pyeta pse nuk po aplikojnë. Ata u përgjigjen, ‘Askush nuk më ka treguar. Askush nuk më ka thënë të aplikoj.’¹⁵⁵

Organizata ka pasur fushatë shumë të mirë informuese. Kanë vendosur posterë anembanë qytetit dhe e kanë lajmëruar ngjarjen në radiostacion lokal. Engelbert shton:

Të rinjtë e lagjes kishin dëgjuar për ngjarjen por thjeshtë nuk kishin menduar se edhe ata mund të jenë pjesë e kësaj dhe se porosia vlente edhe për ta. Të rinjtë nuk kanë njohuri për pjesëmarrjen. Ata nuk janë të vetëdijshëm për vlerën dhe rëndësinë e përfshirjes së tyre në procese që kanë ndikim në jetën e tyre. Të rinjtë hezitojnë të bëhen pjesë e proceseve dhe zhvillimeve jo pse nuk dëshirojnë por pse nuk mendojnë që mendimi i tyre merret parasysh.

Të rinjtë nuk kanë hezituuar gjithmonë të marrin pjesë në vendimmarrje. Përkundrazi, gjatë viteve 1980 dhe 1990, të rinjtë ishin në ballë të rezistencës civile në Kosovë, duke kërkuar kushte më të mira në Universitetin e Prishtinës, qasje në arsim për të gjithë dhe fund të shkeljes së drejtave të njeriut.¹⁵⁶ Megjithatë, dëshmitë cilësore flasin për rënie të pjesëmarrjes së të rinjve me kalimin e kohës.

Pas konfliktit, mijëra OJQ u financuan nga ndihmat financiare që derdheshin në Kosovë. Në vitin 2005, rreth 20 përqind e të gjitha OJQ-ve të regjistruara ishin

¹⁵⁴ Intervista e IKS me Oktay Pomak, 18-vjeçar, nxënës i shkollës së mesme nga Prizreni, 25 prill 2010.

¹⁵⁵ Engelbert Zefaj, diskutim në mes IKS dhe organizatave rinore, 20 maj 2010, Prishtinë.

¹⁵⁶ Clark, H., *Rezistenca Civile në Kosovë*, Londër: Pluto Press, 2000.

organizata rinore.¹⁵⁷ Albani, ish-lider rinor, përshkruan frymën e aktivizmit dhe voluntarizmit që ka ekzistuar menjëherë pas luftës:

Angazhimi im i parë ishte iniciativa e tetë nxënësve në Malishevë. Ne e hapëm qendrën rinore, e cila ishte shkatërruar gjatë luftës. KFOR-i zviceran na ndihmoi ta ndërtojmë një shtëpi të vogël druri. Qendra ishte pikëtakimi i aktivistëve rinor. Ne kryesisht organizonim aktivitete rekreative. Aty merrnin pjesë rreth 300-500 të rinj, por në aspektin logjistik ishte e pamundur të regjistroheshin të gjithë. Të gjithë punonim në baza vullnetare. Është me rëndësi të ceket entuziazmi për punë i atyre ditëve.¹⁵⁸

Periudha menjëherë pas luftës pa bollëk të aktivizmit rinor dhe të ndihmave nga donatorët e huaj. Rrjeti Rinor Kosovar (RRK) u nis si organizatë ombrellë për organizatat e ndryshme lokale rinore. RRK mbajti kongresin e parë në vitin 2001 dhe krijoi momentum deri në vitin 2004 kur edhe u regjistrua në mënyrë formale. Në atë kohë, rrjeti kishte rreth 130 OJQ anëtare. Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara (UNDP) përkrahu rrjetin, i cili shërbente si forum për diskutime në mes anëtarëve, shpërndante informata dhe zbatonte projekte në nivelin lokal dhe qendror.

Megjithatë, pas vitit 2005 RRK filloi të shpërbëhej. Albioni, ish-drejtor i Rrjetit, shpjegon, 'Në vitin 2005/2006 donatorët u tërhoqën dhe e ndërprejnë financimin e tyre. Kjo e dobësoi shoqërinë civile në përgjithësi si dhe organizatat rinore.'¹⁵⁹ Organizatat rinore duhej të bënin përpjekje maksimale për ta ruajtur anëtarësinë e tyre e lere më për ta rritur atë. Meqë donatorët ndërkombëtarë nuk kishin strategji adekuate dalëse, rënia e fondeve i detyruan shumë organizatat të mbyllen, përfshirë këtu edhe anëtare të RRK-së. Ato që vazhduan të punojnë u ballafaquan me probleme të financimit dhe me garë të fortë për burime. Rënia e RRK-së koïncidon me rënien e aktivizmit rinor anëmbanë Kosovës, kryesisht për shkak të frustrimit, sipas Albanit:

[RRK] kryesisht promovonte voluntarizëm dhe solidaritet. Megjithatë, ky entuziazëm u venit pas vitit 2005. Atëherë filluan edhe problemet. Çështjet e rinisë nuk u përfshin në agjendën e vendimmarrësve. Më e rëndësishme se kjo arsye ishte përkrahja ndërkombëtare. Prioritetet për sektorin e rinisë nuk u hartuan sipas nevojave dhe kërkesave të rinisë. Prioritetet nuk ishin të orientuara drejt rinisë por drejt donatorëve. Prioritet ishin çështjet si multietniciteti, paqja dhe tolerance dhe jo zhvillimi i rinisë.¹⁶⁰

Dështimet e vendimmarrësve politik dhe donatorëve që t'i trajtojnë nevojat e identifikuar të rinisë kanë kontribuar në dekurajimin dhe zhgënjimin e të rinjve. Përqendrimi i programeve drejt donatorëve, mbështetja e madhe në voluntarizmin e pavdekshëm të aktivistëve të rinj dhe amullia qeveritare në trajtimin e prioriteteve të rinisë, e la rininë aktive të frustruar dhe të zhgënjyer. Ngritjet dhe rëniet e sektorit të rinisë i kanë lënë të rinjtë kosovarë të pakënaqur me institucionet vendimmarrëse që ndikojnë në jetën e tyre. Edhe pse mendojnë që zëri i tyre nuk merret parasysh, të rinjtë kosovarë nuk e kanë humbur optimizmin dhe entuziazmin e tyre për ardhmërinë e Kosovës dhe për gatishmërinë për ta ndërtuar vendin e tyre. Megjithatë, etja e të

¹⁵⁷ Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara (UNDP), *Rinia: Një Gjeneratë e Re për Kosovën*, Raport i Zhvillimit Njerëzor, 2006, f. 77.

¹⁵⁸ Intervista e IKS me Alban Krasniqin, ish-Drejtor i Rrjetit Rinor të Kosovës, 4 mars 2010, Prishtinë.

¹⁵⁹ Intervista e IKS me Albion Zekën, ish-Drejtor i Rrjetit Rinor të Kosovës, 25 shkurt 2010, Prishtinë.

¹⁶⁰ Intervista e IKS me Alban Krasniqin, ish-Drejtor i Rrjetit Rinor të Kosovës 4 mars 2010, Prishtinë.

rinjve për pjesëmarrje varet shumë nga krijimi i kanaleve nga institucionet kosovare për angazhimin e rinisë që të avokojë për interesat e saj.

Tepër pak, tepër vonë!?

Që nga themelimi i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) në vitin 2002, çështjet e rinisë janë nën autoritetin e Departamentit të Rinisë në MKRS. Ky departament është i vogël dhe përbëhet nga katër nëpunës administrativ dhe katër menaxherial.¹⁶¹ Sipas Ligjit për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e të Rinjve, çdo komunë duhet ta ketë një Zyrtar për Rininë dhe ta themeloj Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Mirëpo, jo të gjitha komunat e kanë bërë këtë.¹⁶² ‘Sektori i rinisë ka probleme të mëdha dhe ky është vetëm fillimi i qasjes së qëndrueshme institucionale ndaj këtyre sfidave,’ tha Fatmir Hoxha, ish-drejtor i Departamentit të Rinisë.

Në vitin 2006, MKRS inicioi projektin tre-vjeçar për Zhvillimin e Rinisë Kosovare, të përkrahur nga Banka Botërore. Njëri nga komponentët e projektit ishte përmirësimi i performancës dhe qëndrueshmërisë së qendrave ekzistuese rinore.¹⁶³ Në vitin 2010, Kosova kishte 13 qendra aktive rinore, shtatë prej të cilave nuk kishin kushte adekuate për funksionim.¹⁶⁴ Që nga fillimi i projektit të MKRS-së, më pak se 5,000 të rinj kanë përfituar nga qendrat rinore, numër ky i vogël duke marrë parasysh faktin se rreth gjysma e popullsisë së Kosovës është nën moshën 25 vjeçare.¹⁶⁵ Qendrat rinore u ballafaquan me probleme strukturore që e vështirësonin dhe nganjëherë e pamundësonin në përgjithësi kontaktin me të rinjtë. Në mungesë të buxhetit të tyre, qendrat u bazuan në fonde nga MKRS-ja dhe organizatat ndërkombëtare. Ato mbështeteshin në përkrahje komunale për hapësira dhe shërbime gratis. Shumë pak komuna iu ofruan qendrave hapësira për punë dhe shumë pak prej tyre i mbuluan shpenzimet e qendrave siç janë rryma dhe uji.

Për shembull, në Prishtinë, komuna e pagoi qiranë e qendrës rinore, në mënyrë që të mund të operonte në një ndërtesë private. Megjithatë, qendra rinore u ballafaqua me probleme serioze në vitin 2006 për shkak të rënies së fondeve nga donatorët ndërkombëtar. Linda, drejtoreshë e qendrës, kujton:

Në vitin 2006 dhe 2007 nuk kishte pothuajse fare frekuentim të qendrës rinore. Qendra rinore në Prishtinë ka pasur shumë vështirësi me hapësirë. Nëse ofroni hapësira adekuate, të rinjtë do të vijnë dhe do të kalojnë kohë në qendër. Por nëse të rinjtë nuk ndihen rehat në qendër, ata më parë dalin dhe kalojnë kohë në kafeteri.¹⁶⁶

Kjo dhe qendrat tjera rinore kanë filluar të zbatojnë pagesën prej 5-7 euro në muaj për kurse të gjuhëve të huaja në mënyrë që t’i mbulojnë shpenzimet e zyrës. Burimet e

¹⁶¹ Intervista e IKS me Fatmir Hoxhën, ish-Drejtor i Departamentit për Rini, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), 25 shkurt, 2010.

¹⁶² GTZ studim 2010.

¹⁶³ Pa statut të qartë, këto qendra fillimisht u regjistruan si OJQ. Ligji i ri për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e të Rinjve (i diskutuar më vonë në këtë kapitull) i definon qendrat rinore si hapësira ‘të funksionalizuara për zhvillimin e aktiviteteve rinore të licencuara nga drejtorati komunal për rini’. Ligji i ri parasheh që ato do të licencohen nga drejtorat komunale për kulturë, rini dhe sport (Neni 12). Këshillat Lokal për Veprimtari Rinore do t’i ndihmojnë qendrat në sigurimin e burimeve financiare dhe hapësirave për veprim.

¹⁶⁴ Intervista e IKS me Fatmir Hoxhën, ish-Drejtor i Departamentit të Rinisë, MKRS, 25 shkurt 2010.

¹⁶⁵ Intervista e IKS me Ilir Hoxhën, Koordinator i Projektit për Zhvillimin e Rinisë Kosovare, financuar nga Banka Botërore, zbatuar nga MKRS, 4 mars 2010, Prishtinë.

¹⁶⁶ Po aty.

pamjaftueshme financiare kanë ndikuar edhe në cilësinë e kuadrove në qendra,¹⁶⁷ si dhe në shërbimet që ata i ofrojnë për të rinjtë.

Përveç fondeve të Bankës Botërore për qendrat rinore, buxheti total i alokuar për Departamentin e Rinisë në MKRS ka qenë tejet i vogël. Në vitin 2006, Qeveria e Kosovës alokoj €6.4 milion për MKRS-në, dhe vetëm 4.5 përqind e kësaj shume, apo €289,454 u dhanë për Departamentin e Rinisë. Në vitin 2008, buxheti i Ministrisë u rrit në €9.4 milion. Megjithatë, Departamenti i Rinisë morri €342,040 që me 3.6 përqind paraqiste rënie proporcionale krahasuar me një vit më herët.¹⁶⁸ Investimi minimal nga qeveria nënkupton që shumica e organizatave dhe qendrave rinore u desh të mbështeten në financim të donatorëve, burim ky i pasigurt dhe i paqëndrueshëm i financimit. Prandaj, të paktën historikisht, rinia nuk duket se ka qenë prioritet i qeverisë.

Zhvillimet e kohëve të fundit tregojnë se gjendja mund të ndryshoj. Në kohën kur aktivizmi rinor kishte filluar të shpërbëhej dhe qendrat rinore kishin probleme të jashtëzakonshme me financim, qeveria inicioi përpjekjet për institucionalizimin e politikave rinore dhe zhvillimit të rinisë. Në vitin 2005, qeveria themeloi Sekretariat e Politikave Rinore. Enver Gashi, konsulent lokal, përshkruan këtë ndryshim në qasjen e qeverisë:

Pas luftës, numri i madh i të rinjve është parë si disavantazh për zhvillimin e vendit. Vetëm kohëve të fundit kemi parë hartime të strategjive dhe planeve të veprimit për rininë për ta kanalizuar veprimtarinë rinore në drejtim më pozitiv.¹⁶⁹

Indikatori kryesor i këtij ndryshimi ishte iniciativa e qeverisë për hartimin e Ligjit për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e të Rinjve në vitin 2005. Në hartimin e ligjit morën pjesë shumë OJQ rinore dhe hisedarë të shoqërisë civile.¹⁷⁰ Ligji ka katër synime: definimi i përgjegjësive për fuqizimin e sektorit rinor të Kosovë dhe rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve; themelimi i mekanizmave dhe institucioneve këshilluese për rininë; definimi i punës vullnetare; dhe licencimi i qendrave rinore.¹⁷¹

Ligji për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e të Rinjve, i miratuar në shtator të vitit 2009, paraqet përkushtimin më serioz të qeverisë ndaj zhvillimit dhe përfshirjes së rinisë deri më sot. Ligji është komplementuar nga Strategjia për Rininë Kosovare dhe Plani i Veprimit për Rininë Kosovare, të miratuara në nëntor të vitit 2009. Nëpërmjet miratimit të udhëzimeve administrative në të ardhmen, Ligji parasheh themelimin e Këshillit Qendror dhe Këshillave Lokal të Veprimit Rinor. Këshilli Qendror i Veprimit Rinor (KQVR) do të jetë strukturë këshillëdhënëse për institucionet e qeverisë kombëtare dhe do të përfaqësoj brenga dhe nevojat e përfaqësuesve të rinisë.¹⁷² Këshillat Lokal të Veprimit Rinor (KLVR) do të operojnë në nivelin komunal, duke dërguar përfaqësues në KQVR për t'i përfaqësuar prioritetet

¹⁶⁷ Linda Loshi, drejtoreshë e Qendrës Rinore në Prishtinë. Diskutimi në mes IKS dhe organizatave rinore, 20 maj 2010, Prishtinë.

¹⁶⁸ Në vitin 2007, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit kishte buxhet prej €7,267,852, ndërsa buxheti i akorduar për Departamentin e Rinisë ishte €331,166 (4.5 përqind).

¹⁶⁹ Enver Gashi, fjalim në Konferencën e Dytë Rajonale të Forumit Syd mbi Politikën për të Rinjtë dhe Pjesëmarrjen Qytetare të të Rinjve, 13-14 prill 2010, Prishtinë.

¹⁷⁰ Intervista e IKS me Albion Zeka, ish-Drejtor i Rrjetit Rinor Kosovar, 25 shkurt 2010, Prishtinë dhe Fatmir Hoxhën, ish drejtor i Departamentit për Rini, MKRS, 25 shkurt 2010, Prishtinë. Departamenti për Rini zhvilloi më tepër se 80 takime me të rinj, përfshirë këtu edhe përfaqësues të organizatave rinore, OJQ-ve dhe qendrave rinore.

¹⁷¹ Ligji për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e të Rinjve, Nr. 03/L-145; Republika e Kosovës, 2009, Neni 2.

¹⁷² Ligji për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e të Rinjve, Nr. 03/L-145; Republika e Kosovës, 2009 Nenet 8 dhe 10.

komunale. KLVR-të do t'i përfaqësojnë OJQ-të aktive në nivelin komunal, qendrat rinore dhe këshillat studentorë të shkollave lokale.

Për ta promovuar pjesëmarrjen e të rinjve që nga mosha e hershme, draft ligji për Arsimin Parauniversitar ka paraparë edhe themelimin e Këshillave të Nxënësve në shkollat e ulëta dhe të larta të mesme. Këshillat do të përbëhen nga kryetarët e klasave nga çdo klasë, të zgjedhur çdo vit.¹⁷³ Këshilli do t'i përfaqësoj nevojat dhe brengat e nxënësve në bordin udhëheqës të shkollës. Për ta rritur lidhjen në mes shkollës dhe pjesëmarrjes së shtuar të rinjve, përfaqësuesit e këtyre Këshillave do të përfaqësohen në KLVR-të komunale.¹⁷⁴

Ligji për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e të Rinjve ka paraparë që KLVR-të dhe KQVR-ja do të krijojnë një zinxhir të komunikimit në mes të këshillave studentor, qendrave rinore dhe organizatave lokale në nivelin komunal nëpërmjet KQVR-së tek qeveria kombëtare. Udhëzimet administrative do t'i caktojnë përgjegjësitë e sakta dhe mekanizmat punues të KQVR-së dhe KLVR-ve. Grupet punuese përgjegjëse për hartimin e udhëzimeve administrative nisën punën e tyre në janar të vitit 2010, por rezultatet e punës së tyre akoma duhen miratuar.¹⁷⁵

Shumë komuna kanë vazhduar me qasje proaktive duke i themeluar KLVR-të. Në vitin 2010 janë krijuar 20 KLVR dhe shtatë komuna tjera ishin në proces të krijimit të KLVR-ve të tyre. Megjithatë, në mungesë të udhëzimeve administrative për qeverisjen e punës së tyre dhe të financimeve, KLVR-të ekzistuese nuk ishin aktive.¹⁷⁶ Për të hartuar objektiva për punët komunale, KLVR-të do ta hartojnë draftin e Planeve të Veprimit të Këshillave Lokal, i cili pastaj duhet të miratohet nga kuvendi komunal së bashku me buxhetin i cili do t'i bënte KLVR-të funksionale.

Koha do të tregoj nëse plani ambicioz dhe i hollësishëm për filtrimin e prioriteteve rinore në proceset vendimmarrëse komunale dhe qendrore do të funksionoj sipas parashikimeve. Megjithatë, Programi i Qeverisë së Kosovës (2008-2011) nuk jep shenja të mira për vëmendjen e ardhshme të qeverisë tek rinia; dokumenti 55-faqesh i cili përcakton prioritetet e qeverisë, e përmend 'rininë' vetëm tetë herë.¹⁷⁷ Vetëm dy fjali të dokumentit merren me rininë.

Përpjekjet e rinisë që zëri i tyre të dëgjohet

Përfshirja e rinisë nga proceset vendimmarrëse ishte temë e shpeshtë në mesin e të rinjve gjatë intervistave dhe punës në grupe. 'Ne nuk kemi qasje në proceset vendimmarrëse,' thotë Herëza, studente 19-vjeçare nga Prishtina. 'Interesat dhe kërkesat tona merren fare pak parasysh nga institucionet vendimmarrëse. Unë mendoj që problemi është tek udhëheqësit e vendit tonë të cilët nuk dëshirojnë ta përfshijnë rininë.'¹⁷⁸ Naimi, aktivist i ri, pajtohet me këtë; ai nuk ndihej i përfaqësuar nga Komuna e Prishtinës e as nga Lëvizja Vetëvendosje ku ai është anëtar: 'Askush nuk na përkrah,' thotë ai.¹⁷⁹

¹⁷³ Draft i Ligjit për Arsimin Parauniversitar; Republika e Kosovës, Neni 18.

¹⁷⁴ Albion Zeka, Punëtori e IKS me Grupet Kyçe të Interesit për Pjesëmarrjen e Të Rinjve, 13 korrik 2010.

¹⁷⁵ Intervista e IKS me Fatmir Hoxhën, ish drejtor i Departamentit për Rini, MKRS, 25 shkurt 2010.

¹⁷⁶ Takim në mes GTZ-së dhe Komunës së Prishtinës, Departamenti për Kulturë, Rini dhe Sport dhe OJQ të të rinjve, 19 korrik 2010.

¹⁷⁷ Qeveria e Kosovës, *Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2008-2011*, Prishtinë, prill 2008.

¹⁷⁸ Intervista e IKS me Hereza Sefaq, studente në Fakultetin Juridik, Universiteti i Prishtinës, 6 prill 2010.

¹⁷⁹ Fokus grupi i IKS me të rinjtë në Prishtinë, 18 maj 2010.

Edhe të rinjtë e tjerë mendojnë që politikanët nuk i marrin seriozisht mendimet dhe brengat e tyre. Pali, student i shkollës së mesme në Prizren shpjegon:

Nëse unë, ti dhe 100 të rinj tjerë pajtohemi që kjo rrugë [afër shkollës] duhet të mbyllet për komunikacion, dhe shkojmë te kryetari i komunës dhe ja dorëzojmë kërkesën tonë, përgjigja do të jetë ‘Kjo nuk është punë e juaja. Shkoni përfundojini studimet dhe pasi të keni diplomuar mund të vini e të ankoheni.’¹⁸⁰


Ngjashëm me këtë, Albulena jep një shembull konkret: para dy vitesh, të rinjtë organizuan një peticion për hapjen e një kinemaje në Prizren. U siguruan nënshkrimet e peticionit dhe kërkesa iu dorëzua autoriteteve komunale, por këta të fundit nuk ndërmorën asgjë. Mungesa e veprimit politik dukej ironike duke marrë parasysh shumën e parave që ishin dhënë për krijimin e imazhit të Prizrenit si ‘Qytet i Filmit’ nëpërmjet ‘Dokufest’ festivalit ndërkombëtar të filmit që mbahet aty çdo vit.¹⁸¹

Të rinjtë serbë janë poashtu të zhgënjyer. Ivan-i, lider aktiv rinor në Graçanicë, komenton: ‘Është shumë vështirë të jesh pjesë e procesit vendimmarrës. Edhe pse jemi shumë të rinj, ne po përpiqemi të jemi sa më aktiv dhe ta ngremë zërin tonë.’¹⁸²

Në përgjithësi, siç ilustron Grafiku 3.3, vetëm 5.5 përqind të respondentëve të grupmoshës 15-24 vjeçare, besojnë që institucionet vendimmarrëse i kanë marrë shumë parasysh interesat dhe nevojat e të rinjve. Afro 32 përqind mendojnë që brengat e tyre janë trajtuar ‘deri diku.’ 28.3 përqind mendojnë që brengat e tyre u morën parasysh ‘pak,’ dhe 19.7 përqind thanë që nevojat e tyre nuk u morën ‘fare’ parasysh. Në krahasim me të rinjtë e komuniteteve tjera joshqiptare, serbët kishin shumë më pak gjasa të mendojnë që vendimmarrësit i marrin parasysh qëndrimet e tyre.¹⁸³

Një përqindje e lartë e respondentëve, 14.8 përqind, nuk e dinin nëse institucionet e kishin marrë parasysh interesat e tyre. Gjasat e përgjigjes ‘nuk e di’ ishin 364 përqind më të larta për një serb sesa për një shqiptar dhe 183 përqind më të larta për të rinjtë e komuniteteve tjera etnike.¹⁸⁴ Hulumtimet e mëtejshme mund ta trajtojnë në mënyrë më specifike pasigurinë në mesin e të rinjve, posaçërisht në mesin e qytetarëve serb.

Grafiku 3.3 Shkalla në të cilën grupmoshat 15-24 vjeçare besojnë që institucionet vendimmarrëse i morën parasysh interesat e tyre



¹⁸⁰ Fokus grupi i IKS me studentët të gjimnazit dhe shkollave profesionale në Prizren, 28 prill 2010.

¹⁸¹ <http://www.dokufest.com/2010/>

¹⁸² Fokus grupi i IKS me të rinjtë nga komuniteti serb në Graçanicë, 12 maj 2010.

¹⁸³ Vërehet marrëdhënie statistikisht e rëndësishme në nivelin pesë përqind në mes të qenit serb dhe të gjitha përgjigjeve përveç ‘aspak’ ($p \leq 0.008$). Marrëdhënia në mes të qenit shqiptar dhe përgjigjeve në këtë pyetje nuk ishte mjaft e qartë.


¹⁸⁴ Për respondentët serb, kishte marrëdhënie statistikisht të rëndësishme në nivelin pesë përqind në mes përkatësisë etnike dhe mosdijes nëse vendimmarrësit i marrin parasysh interesat e të rinjve ($p = 0.001$).

Votimi është element i rëndësishëm i pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, dhe është kyç për pjesëmarrje në proceset politike. Gjatë intervistave dhe fokus grupeve, të rinjtë e shprehën besimin e tyre në rëndësinë e votimit. Erzeni, student 18-vjeçar nga Dragashi, komentoi, ‘E drejta e votës është njëra prej të drejtave më të çmueshme individuale në jetë. Zëri ynë mund të dëgjohet vetëm kur votojmë. Nëse nuk votojmë, e humbin të drejtën të kërkojmë llogaridhënie nga autoritetet.’¹⁸⁵ Albulena nga Prizreni pajtohet, ‘Besoj që vota e çdo qytetari është shumë e vlefshme. Pa marrë parasysh nëse ka zgjidhje në mes kandidatëve, votimi është obligim të cilin ne duhet ta përmbushim si qytetarë.’¹⁸⁶ Ndoshta jo të gjithë të rinjtë e përshkruajnë në mënyrë kaq mbresëlënëse rëndësinë e votimit.

Siç ilustron Grafiku 3.4, 46.5 përqind e respondentëve në hulumtimin që përfshiu tërë Kosovën, mendojnë se votimi ishte ‘shumë efektiv’ ose ‘mjaft efektiv’ për përmirësimin e vendit të tyre. Megjithatë, 18.8 përqind thanë se ‘nuk ishte as efektiv as joefektiv,’ 10.9 përqind thanë se ishte ‘joefektiv’ dhe 8.8 përqind thanë se ishte ‘tejet joefektiv.’ Shqiptarët, më tepër se të rinjtë e komuniteteve tjera etnike, ishin më të prirur të besojnë që votimi në zgjedhje ishte efektiv.¹⁸⁷ Në krahasim me të rinjtë e komuniteteve tjera etnike, serbët ishin më apatik; vetëm 1.5 përqind e respondentëve serbë thanë se votimi ishte efektiv, derisa 58.7 përqind të shqiptarëve dhe 36.2 përqind të të rinjve nga komunitetet tjera thanë se ishte efektiv. Në përgjithësi, 15.1 përqind e respondentëve thanë se nuk e dinë nëse votimi ishte efektiv ose jo. Në krahasim me grupet e tjera etnike, një përqindje pak më e vogël e serbëve u përgjigjen me ‘nuk e di.’

Diskutimet me serbët e Kosovës sugjerojnë që shumica prej tyre ende besojnë që e ardhmja e tyre politike në Kosovë është pak a shumë e paqartë. Që nga përfundimi i luftës, qeveria e Kosovës me shumicë shqiptare dhe Qeveria e Serbisë kanë garuar për ta fituar vëmendjen e tyre në mënyrë që t’i qeverisen komunat dhe fshatrat me shumicë serbe në Kosovë. Kjo mund t’i kontribuoj apatisë ose mungesës së njohurisë për shkallën në të cilën qeveria vërtetë dëshiron t’i trajtoj brengat e tyre (shih f.59) dhe kjo e shpjegon edhe besimin e tyre në vlefshmërinë e votimit.

Grafiku 3.4 Besimi i të rinjve në vlefshmërinë e votimit në përmirësimin e vendit grupmosha 15-24 vjeçare



¹⁸⁵ Fokus grupi i IKS me nxënës të shkollës së mesme në Dragash, 5 maj 2010.

¹⁸⁶ Fokus grupi i IKS me nxënës të shkollës së mesme dhe shkollave profesionale në Prizren, 28 prill 2010.

¹⁸⁷ Vërehet marrëdhënie statistikisht e rëndësishme në mes përkatësisë etnike dhe besimit të të rinjve në efektshmërinë e të votuarit (për shqiptarët që besojnë se votimi është efektiv, $p < 0.001$).

Në praktikë, përqindja e të rinjve që mund të votojnë dhe që morën pjesë në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2004, ishte 49 përqind,¹⁸⁸ përafërsisht e ngjashme me përqindjen e respondentëve që menduan se vota e tyre ishte efektive. Në përgjithësi, dalja e votuesve ishte e ulët, 53 përqind. Shkalla krahasimisht e ulët e të rinjve mund të jetë tregues i dyshimeve të tyre që votimi është efektiv apo i zhgënjimit me politikanët, edhe pse këto marrëdhënie kërkojnë hulumtime të më tutjeshme. Nëse të rinjtë nuk besojnë që politikanët do t'i trajtojnë brengat e tyre, ata mund të mos jenë të nxitur të votojnë në zgjedhje. Siç thotë Miloti 22-vjeçar, 'Nuk i besoj asnjë institucioni. E vetmja gjë që bëjnë janë premtimet gjatë fushatës zgjedhore. Është bërë si traditë, ata bëjnë premtime, i vjedhin votat tona dhe pastaj na harrojnë.'¹⁸⁹

Vëmendja sporadike që iu kushtohet të rinjve gjatë fushatave zgjedhore i kontribuon frustrimit në mesin e të rinjve.¹⁹⁰ Periudhat e zgjedhjeve janë rastet e rralla kur politikanët i drejtohen të rinjve, të paktën me anë të diskursit. Çdo zgjedhje, kandidatët premtojnë që do t'iu kushtojnë më tepër rëndësi çështjeve të rinisë, por ata rregullisht dështojnë t'i përmbushin premtimet e tyre. Albulena, 19-vjeçare dhe nxënëse në shkollë të mesme, shprehet me zemërim: 'Kur vjen koha t'i mbledhin votat tona, të gjithë politikanët vijnë dhe na pyesin për brengat tona [dhe] na dëgjojnë. Sapo të kryhen zgjedhjet, ata na harrojnë!'

Përmbushja e premtimeve në praktikë

Fuqizimi i pjesëmarrjes së shtuar të të rinjve në proceset vendimmarrëse mbetet sfida zhvillimore afatgjate e shoqërisë kosovare. Nëse të rinjve do t'i besohet e ardhmja e qeverisjes së vendit, atëherë tash duhet të inkurajohet lidershipi dhe pjesëmarrja e tyre. Në përpjekjet e tyre për të krijuar demokraci të qëndrueshme, qeveria dhe hisedarët kyç, siç janë donatorët, në rend të parë USAID, Banka Botërore dhe SIDA, qendrat rinore dhe OJQ-të duhet të jenë shumë inovative. Dëshmitë tregojnë që kafenetë janë lokacion i mirë për lançimin e fushatave informuese për të rinjtë dhe për mundësitë e pjesëmarrjes. Duke marrë parasysh përdorimin e madh të teknologjisë bashkëkohore të komunikimit në mesin e të rinjve, interneti poashtu mund të përdoret më gjerësisht për përfshirjen e të rinjve.

Në të njëjtën kohë, gjetjet e hulumtimeve tregojnë që sigurimi i besimit të të rinjve do të jetë njëra ndër sfidat më kritike për rritjen e pjesëmarrjes së tyre. Përkundër retorikës, deklaratat e vendimmarrësve që rinia është prioriteti i tyre mbesin të përkthehen në veprime. Rinia kosovare akoma ndjen se ka ndikim shumë të kufizuar në proceset vendimmarrëse. Për ta fituar besimin e rinisë, vendimmarrësit duhet t'i përmbushin premtimet e tyre dhe t'i trajtojnë nevojat e identifikuarat të të rinjve. Këto veprime me gjasë do të inkurajojnë përfshirje më të madhe të rinisë në proceset vendimmarrëse në të ardhmen.

Me Ligjin për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë, Qeveria e Kosovës ka bërë përpjekje të lavdërueshme për institucionalizimin e përpjekjeve për fuqizimin e rinisë. Megjithatë, përkushtimet e bëra në letër tash duhet të zbatohen në praktikë. Buxheti i pamjaftueshëm i alokuar për Departamentin e Rinisë deri më tani ka qenë indikator që diskursi qeveritar mbetet i ndarë nga realiteti. Qeveria duhet t'i zbatoj premtimet e saj

¹⁸⁸ Komisioni Qendror Zgjedhor, Rezultatet e Zgjedhjeve 2004.

¹⁸⁹ Intervista e IKS me Milot Rexhepin, student i shkencave politike, Prishtinë, 9 prill 2010.

¹⁹⁰ Intervistat e IKS me grupet e fokusit në Prizren, Gjakovë, Dragash, Prishtinë, prill-maj 2010.

në praktikë duke alokuar buxhet të mjaftueshëm për Departamentin e Rinisë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Programi i ardhshëm qeveritar mund t'i plotësoj përkushtimet e qeverisë duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave dhe prioriteteve të rinisë.

Pjesëmarrja e të rinjve ka të bëjë me ndikimin e vërtetë të rinisë në institucionet dhe proceset vendimmarrëse, e jo me prezencën e tyre pasive si shikues në disa takime. Është e thjeshtë, ka të bëjë me pjesëmarrjen kualitative dhe kuantitative. Në mënyrë që të arrihet pjesëmarrja kualitative dhe kuantitative e të rinjve në proceset vendim marrëse, duhet të bëhen përpjekje paralele nga institucionet fillimisht duke qenë proaktiv në përpjekjet për stimulimin e pjesëmarrjes së të rinjve dhe në anën tjetër të rinjtë duke sfiduar energjinë për një pjesëmarrje më të madhe. Kjo ka të bëjë me përpjekjet e të rinjve të planifikojnë programe sipas dëshirës së tyre dhe me përfshirjen e të rinjve në procese vendimmarrëse nga ana e institucioneve. Vetëm me anë të gërshetimit të këtyre përpjekjeve, do të krijohen mundësi që rinia të jetë akter i ndryshimit dhe ta marrë përsipër rolin udhëheqës për zhvillimin e vendit.

TË RINJTË KOSOVARË BALLAFAQOHEN ME TË ARDHMEN E TYRE

*‘Nuk e ndjej veten “Evropian të Ri,”
ndoshta pse kurrë nuk kam pasur rastin të shkoj në Evropë.’
- student 22-vjeçar*


Ky kapitull trajton nivelin e kënaqësisë së përgjithshme të rinisë kosovare me jetën e tyre dhe parashikimet e tyre për të ardhmen. Kapitulli i parë studion shkallën në të cilën të rinjtë janë të kënaqur me jetën e tyre dhe optimizmin e tyre për të ardhmen. Kapitulli pastaj diskuton mbi perceptimet e të rinjve për Kosovën dhe të ardhmen e saj si shtet i ri. Duke marrë parasysh pritjet e tyre të zymta për arsim dhe punësim, si dhe historinë e shpërnguljes nga Kosova, kapitulli pastaj heton mundësinë e të rinjve për t’u shpërngulur. Në fund, kapitulli trajton mendimet e të rinjve kosovarë për integrimet evropiane.

E ardhmja ime është e ndritshme?

Respondentët më të rinj, të moshës 10-14 vjeçare, u pyetën nëse ishin të gëzuar me jetën e tyre. Rreth 90 përqind u përgjigjen me po. Shumica prej tyre ishin të gëzuar ‘shumicën e kohës’ (78.2 përqind), 18.2 përqind ishin ‘nganjëherë’ të gëzuar, 2.3 përqind nuk e dinë, dhe 1.4 përqind thanë se nuk janë të gëzuar.

Derisa ‘gëzimi’ dhe kënaqësia me jetën nuk janë e njëjta gjë, 15-24 vjeçari mesatar dukej se e shihte jetën me sy më kritik sesa 10-14 vjeçari. Siç ilustron Grafiku 4.1, shumica ishin të ‘kënaqur’ (54.6 përqind) ose ‘shumë të kënaqur’ (20 përqind) me jetën e tyre. Megjithatë, 19 përqind ishin ‘as të kënaqur as të pakënaqur,’ 3.9 përqind ishin ‘të pakënaqur’ dhe 2.2 përqind ishin ‘tejet të pakënaqur.’ Vetëm 0.4 përqind thanë se nuk e dinë.


Grafiku 4.1 Kënaqësia me jetën grupmoshat 15-24



Pyetjet vijuese për të rinjtë kishin të bënin me kënaqësinë e tyre me gjendjen e tyre financiare dhe punën. Afro gjysma e respondentëve thanë se ishin të kënaqur me të dyja. Megjithatë, 17 përqind ishin të pakënaqur me gjendjen e tyre financiare dhe rreth 15 përqind ishin të pakënaqur me punën e tyre.

Grafiku 4.2 ofron hollësi rreth asaj se sa pozitivisht respondentët 15-24 vjeçar e shohin të ardhmen e tyre. Derisa shumica pajtohen që e ardhmja e tyre është e ndritur (52.8 përqind), afro 26.9 përqind ishin të pavendosur, dhe rreth pesë përqind thanë se nuk e dinë. Më tepër se 15 përqind nuk kishin mendim pozitiv për të ardhmen e tyre.

Grafiku 4.2 E ardhmja e ime duket e ndritur grupmosha 15-24



Vërehet një marrëdhënie statistikisht e rëndësishme në mes optimizmit të të rinjve për të ardhmen dhe përkatësisë së tyre etnike. Derisa të rinjtë shqiptarë¹⁹¹ si dhe të rinjtë e grupeve të tjera minoritare¹⁹² kanë prirje të pajtohen se e ardhmja e tyre duket e ndritur, të rinjtë serbë¹⁹³ nuk pajtohen me këtë. Pjesëmarrësit e fokus grupit në Graçanicë shprehën pasiguri rreth të ardhmes së tyre. Ivani nga Graçanica shpjegon: ‘Kemi kuptuar se nuk është aq lehtë t’i arrijmë qëllimet tona, dhe fatkeqësisht në dhjetë vitet e fundit kemi kuptuar se dikush tjetër e kontrollon fatin tonë. Kjo është arsyeja pse është shumë vështirë ta planifikosh të ardhmen.’¹⁹⁴ Në shkallë mesatare, respondentët serb pajtohen me mendimin e Ivanit,¹⁹⁵ duke thënë se nuk gëzojnë lirinë e kontrollimit të ardhmes së tyre, 59.4 përqind nuk pajtohen me deklaratën që njerëzit në Kosovë mund ta zgjedhin të ardhmen e tyre.

Optimizmi i të rinjve dallon nga rajoni në rajon. Derisa të rinjtë në Prishtinë janë të prirur të mendojnë se e ardhmja e tyre është e ndritur,¹⁹⁶ të rinjtë në Prizren¹⁹⁷ dhe Gjakovë¹⁹⁸ nuk janë të prirur të pajtohen e as të mos pajtohen me këtë. Të rinjtë në Gjiilan¹⁹⁹ kishin më së paku pritje pozitive, duke mos u pajtuar se e ardhmja e tyre do të jetë e ndritur.

Një faktor i cili ndikon në optimizmin në Prishtinë mund të jetë mundësia krahasimisht më e mirë e punësimit në krahasim me vendet tjera. Përparimi, student 24-vjeçar nga Prizreni, shpjegon, ‘Dua të jetoj në Prizren, por me siguri do të më duhet të shkoj në

¹⁹¹ $p < 0.001$

¹⁹² $p = 0.048$

¹⁹³ $p < 0.001$

¹⁹⁴ Fokus grupi i IKS me të rinj serb në Graçanicë, 12 maj 2010.

¹⁹⁵ $p < 0.001$

¹⁹⁶ $p < 0.001$

¹⁹⁷ $p < 0.001$

¹⁹⁸ $p = 0.012$

¹⁹⁹ $p < 0.001$


Prishtinë. Prishtina ofron më shumë mundësi. Në Prizren duhet të kesh rrjete. I kam tre shokë që po kalojnë shumë mirë në Prishtinë. Edhe unë do të shkoj meqë tregu i punës është në Prishtinë.²⁰⁰

Kosova në sytë e mi

Si shteti më i ri në botë, Kosova ballafaqohet me sfida të shumta. Shkalla e kënaqësisë së të rinjve me vendin e tyre mund të shërbej si indikator shtesë i shkallës së kënaqësisë së tyre me jetën në përgjithësi si dhe ofron një indikator fillestar për tendencën e të rinjve për tu larguar nga vendi. Në pyetjen se sa janë të kënaqur me gjendjen e përgjithshme në Kosovë, 36.1 përqind të grupmoshës 15-24 vjeçare thanë që janë të kënaqur, 32.4 përqind nuk ishin të kënaqur, 29.9 përqind nuk ishin as të kënaqur as të pakënaqur, dhe 1.6 përqind thanë se nuk e dinë.

Edhe pse disa të rinj kosovarë ishin kritik ndaj gjendjes së përgjithshme në Kosovë, shumica megjithatë shpresonin se kjo gjendje do të përmirësohet. Siç ilustron Grafiku 4.3, rreth 67.5 përqind të grupmoshës 10-14 vjeçare besojnë që Kosova do të jetë vend më i mirë për të jetuar në të ardhmen. Rreth 8 përqind nuk presin fare ndryshime, derisa më pak se gjashtë përqind thanë se Kosova do të bëhej vend edhe më i keq për të jetuar. Afro 19 përqind thanë se nuk e din se çka do të sjell e ardhmja.


Grafiku 4.3 Optimizmi për të ardhmen e Kosovës



Në pyetjen pse mendojnë që Kosova do të jetë vend më i mirë për të jetuar në të ardhmen, 46 përqind e të rinjve 10-14 vjeçar përmendën zhvillimin ekonomik, 21.3 përqind standardin më të mirë të jetesës, 15.3 përqind thanë se ju pëlqen vendi i tyre, 7.7 përqind thanë më pak probleme sociale dhe 4 përqind më pak ndotje. Siç ilustron Grafiku 4.4, rreth gjashtë përqind u përgjigjen se nuk e dinë.

²⁰⁰ Intervista e IKS me Përparim Abrashi, 24 vjeçar, Prizren, 25 prill, 2010.

Grafiku 4.4 Arsyet e perceptuara në mesin e grupmoshave 10-14 vjeçare pse Kosova do të jetë vend më i mirë për të jetuar në të ardhmen



Siç shihet në Grafikon 4.3, shumica e respondentëve të moshës 15-24 vjeçare ishin poashtu optimist për të ardhmen e Kosovës; 67.5 përqind thanë se Kosova do të ishte vend më i mirë për të jetuar. Rreth 12 përqind ishin skeptik se do të ketë ndryshime, 12 përqind thonë se nuk e dinë dhe 10 përqind besojnë që Kosova do të jetë vend më i keq për të jetuar. Në pyetjen pse mendojnë që Kosova do të jetë vend më i mirë, afro gjysma e respondentëve optimist shprehën shpresa për gjendje më të mirë ekonomike dhe 41.6 përqind përmendën standarde më të mira të jetesës. Përqindja e të rinjve 15-24 vjeçar të cilët besojnë se Kosova do të jetë vend më i keq për të jetuar, ishte relativisht e ulët në krahasim me ata që ishin optimist për të ardhmen e Kosovës. Më pak se 4 përqind përmendën problemet sociale dhe 3.4 përqind përmendën gjendjen ekonomike si arsyen kryesore për mendimin se Kosova do të jetë vend më i keq për të jetuar në të ardhmen.

Është vërejtur një marrëdhënie statistikisht e rëndësishme në mes përkatësisë etnike dhe optimizmit për të ardhmen e Kosovës.²⁰¹ Derisa shqiptarët dhe të rinjtë e komuniteteve tjera etnike janë të prirur të besojnë që Kosova do të jetë vend më i mirë, mesatarisht të rinj serb janë më të prirur të mendojnë se Kosova do të mbetet e njejtë ose do të jetë vend më i keq për të jetuar në të ardhmen. Në anën tjetër, një e treta e respondentëve serb thanë se nuk e dinë, që do të thotë se është vështirë të nxirren përfundime vendimtare në këtë drejtim. Hulumentimet e mëtutjeshme mund të përqendrohen në mënyrë më specifike në prioritetet e të rinjve serb dhe ta hetojnë tendencën e shkallës së lartë të atyre që përgjigjen me ‘nuk e di.’

Migrimi: Sefi i sigurisë për të rinjtë


Për dekada të tëra, migrimi ka qenë strategjia e kosovarëve për jetesë. Gjatë gjithë shekullit XX, meshkujt kosovarë punuan në vendet e jashtme në ndërtimtari, bujqësi dhe në industri tjera të shërbimit. Në kohën socialiste, shumë prej tyre emigruan në Zagreb ose Beograd. Në fund të viteve 1960, ata emigruan në Evropë si punëtorë sezonal. Në vitet e 1990-ta, shkalla e migrimit u rrit si rezultat i konfliktit dhe shënoi

²⁰¹ $p < 0.001$

pikën më të lartë në vitin 1999 kur qindra shqiptarë të Kosovës u dëbuan me dhunë nga Kosova. Në vitin 2010, Kosova kishte një rën nga shkallët më të larta të emigrimit në mesin e ekonomive në tranzicion, derisa emigrantët kryesisht kishin lëvizur në drejtim të Evropës Perëndimore.²⁰²

Mundësia e emigrimit të vazhdueshëm në mesin e rinisë kosovare mbetet e lartë. Marrë parasysh që shumica e popullsisë kosovare është nën moshën 25 vjeçare, kjo mund të përfshij një përqindje të konsiderueshme të popullsisë. Siç ilustron Grafiku 4.5, 13.7 përqind të respondentëve 10-14 vjeçar, 21.7 përqind e të rinjve 15-19 vjeçar dhe 23.6 përqind e të rinjve 20-24 vjeçar shprehin dëshirën të jetojnë jashtë në të ardhmen. Prandaj, të rinjtë kanë më shumë gjasa të mendojnë për shpërngulje me kalimin e kohës. Ky dallim mund t'i atribuohet faktit që me kalimin e kohës të rinjtë vetëdijësohen për mundësitë e kufizuara të shkollimit të mirë dhe punësimit në Kosovë.

Grafiku 4.5 Përqindja e respondentëve që dëshirojnë të jetojnë jashtë në të ardhmen



Të rinjtë e komuniteteve tjera janë më të interesuar të jetojnë jashtë sesa shqiptarët dhe serbët e Kosovës; 40.2 përqind prej tyre dëshirojnë të jetojnë jashtë në krahasim me 20.3 përqind të shqiptarëve të Kosovës dhe 10.5 përqind të serbëve të Kosovës. S'është interesante, 18 përqind e serbëve të Kosovës thanë se nuk e dinë ku dëshirojnë të jetojnë, krahasuar me 3.4 përqind të shqiptarëve të Kosovës dhe 3.9 përqind e respondentëve të komuniteteve tjera etnike.

Sipas Bankës Botërore, shkalla e lartë e varfërisë dhe papunësisë e kanë bërë migrimin opsion atraktiv për shumë njerëz, posaçërisht për të rinjtë.²⁰³ Në fakt, të rinjtë i identifikuan të dyja këto çështje gjatë intervistave dhe fokus grupeve. 'Po ta kisha rastin të studioj dhe të jetoj jashtë, kurrë nuk do të isha kthyer në Kosovë,' thotë Albulena, studente 19-vjeçare e cila ëndërron të bëhet ekonomiste e suksesshme.²⁰⁴ 'Nuk mendoj se do të rri në Kosovë. Dua të shkoj te daja im në Zvicër,' thotë Mirandi, 19-vjeçar dhe nxënës në shkollë të mesme.²⁰⁵ Ai beson se në Zvicër ka perspektivë më të mirë se në fshatin e tij në rrethinë të Prizrenit.

Njëlloj si Mirandi, shumë të rinj kanë të afërm që jetojnë në vendet e huaja; çdo e katërta familjare e ka së paku një anëtar të familjes jashtë Kosovës.²⁰⁶ Ekzistimi i këtyre rrjeteve sociale në vendet e huaja mund ta lehtësoj migrimin e ardhshëm të të rinjve.

²⁰² Banka Botërore, *Kosova, Zbërthimi i Potencialit për Rritje: Strategjitë, Politikat, Veprimet*, prill 2010, f. 71.

²⁰³ Banka Botërore, *Rinia e Kosovës në Rrezik: Të Qenit i Ri, i Papunë dhe i Varfër në Kosovë*, raport mbi punësimin e e të rinjve në Kosovë. Raport Nr. 43596-XK, shtator, 2008, ff. 22-23.

²⁰⁴ Fokus grupi i IKS me nxënës të shkollës së mesme dhe shkollave profesionale në Prizren, 28 prill 2010.

²⁰⁵ Po aty.

²⁰⁶ Banka Botërore, *Kosova, Zbërthimi i Potencialit për Rritje: Strategjitë, Politikat, Veprimet*, prill 2010, f. 71.

Destinacionet kryesore kanë qenë Gjermania dhe Zvicra. Ndoshta jo çuditërisht, rreth 30 përqind e respondentëve 15-24 vjeçar që dëshirojnë të shpërngulen thonë se dëshirojnë të jetojnë në Gjermani dhe 17 përqind përmendin Zvicrën. Të tjerët shpresojnë të jetojnë në SH.B.A dhe në Angli (12.2 përqind përkatësisht) dhe Suedi, Itali dhe Francë (4.9 përkatësisht).

Megjithatë, shpërngulja mund të mos iu ofroj të rinjve mundësitë që i kanë ëndërruar. Jo të gjitha shpresat e emigrimit do të përmbushen; faktet tregojnë njerëzit posaçërisht të varfrit nuk arrijnë të migrojnë për shkak të politikave strikte të migrimit dhe rrjeteve joadekuate sociale.²⁰⁷ Përveç kësaj, në vitet e fundit, emigrantët kanë më së tepërmi gjasa të mbesin papunë dhe kjo i ka përfshirë edhe të rinjtë.²⁰⁸

Derisa papunësia dhe varfëria mund të jenë arsyt kryesore për migrim, të rinjtë kanë emigruar edhe për t'u shkolluar. Disa të rinj kanë ëndërruar të jetojnë jashtë vendit, mirëpo të tjerët kanë planifikuar të kthehen pasi ta përfundojnë shkollimin e lartë. Për shembull, Pali, 19-vjeçar dhe nxënës i shkollës së mesme në Prizren, planifikon t'i vazhdoj studimet e tij jashtë vendit por dëshiron të kthehet pas studimeve për t'i ndihmuar vendit të tij. 'Unë dua të jetoj në Prizren sepse ky është qytet i bukur,' thotë ai. 'Për shkak të gjendjes aktuale, nuk dëshiroj të jetoj në Prizren, Prishtinë apo Kosovë. Por jetoj me shpresën që gjërat do të përmirësohen.'²⁰⁹ Naimi, student universitar nga Prishtina, ndan mendim të ngjashëm, 'nëse vendos të shkoj jashtë do ta bëjë këtë vetëm për studime dhe shkollim më të mirë. Por definitivisht do të kthehem në Kosovë dhe do t'i kontribuoj vendit tim'. Derisa shumë të rinj dëshirojnë të studiojnë jashtë, trendi i vazhdueshëm është kthimi për 'të kontribuar në Kosovë.'²¹⁰

Temat siç janë dëshira për shkollim të lartë dhe mundësitë më të mira të punës u shtruan shpesh në fokus grupin me pjesëmarrës nga fshatrat e Dragashit. Shumë pak prej tyre e shihnin ndonjë të ardhme në Dragash. Arbëri, 19-vjeçar dhe nxënës në shkollë të mesme, dëshiron të migroj në Prishtinë për të studiuar shkencat kompjuterike, 'për shkak të profesionit të cilin e kam zgjedhur, nuk mendoj se do të jetoj në Dragash. Do të jetoj në ndonjë vend tjetër në Kosovë.'²¹¹ Në anën tjetër, shoqja e tij e klasës, Anesa, akoma nuk e ka zgjedhur profesionin e saj, mirëpo ajo që do të zgjedh ajo do ta përcaktoj vendin ku do të jetoj 'Nëse e studioj psikologjinë, nuk mendoj se do të jetoj në Kosovë, por nëse studioj letërsinë atëherë mund të punoj këtu si mësimdhënëse.' Filloreta dëshiron t'i vazhdoj studimet e saj jashtë vendit dhe pastaj të kthehet në Kosovë: 'Dëshiroj ta studioj fizioterapinë në Turqi. Pastaj dëshiroj të kthehem dhe të jetoj ndoshta në Prishtinë por jo në Dragash.'²¹² Lëvizshmëria e të rinjve përbrenda vendit apo jashtë tij në masë të madhe varet nga mundësitë që i ofron tregu i punës.

Banka Botërore argumenton që emigrimi ka pasur efekte pozitive në rezultatet e tregut të punës në Kosovë. Përveç lehtësimit të presionit të tregut të punës (meqë shumë emigrantë nuk kanë aftësi të punës dhe janë të papunë), ekonomia ka përfituar nga 'përfitimi i trurit' nga një numër i vogël i emigrantëve që janë kthyer në vendlindje.²¹³

²⁰⁷ Për shembull, shih, S., *Enciklopedia Ndërkombëtare e Shkencave Sociale dhe të Sjelljes*, Amsterdam: Elsevier, 2001.

²⁰⁸ Sipas Bankës Botërore moshat mesatare e emigrantëve është rritur që nga viti 1990; moshata mesatare dikur ishte 19 vjeç në fillim të viteve 1990, dhe gradualisht u rrit në 29 në vitin 2009. Në disa vitet e fundit, më tepër se 90 përqind e të gjithë emigrantëve janë 20-35 vjeçar, duke ndikuar kështu në një numër më të madh të rinjve. Banka Botërore, Banka Botërore, *Kosova, Zbërthimi i Potencialit për Rritje: Strategjitë, Politikat, Veprimet*, prill 2010, f. 72.

²⁰⁹ Fokus grupi i IKS me nxënës të shkollës mesme dhe shkollave profesionale në Prizren, 28 prill, 2010.

²¹⁰ IKS fokus grupet dhe intervistat e hollësishme me të rinj kosovar, prill-maj, 2010.

²¹¹ Fokus grupi i IKS me nxënës të shkollës së mesme në Dragash, 5 maj 2010.

²¹² Po aty.

²¹³ Banka Botërore, *Kosova, Zbërthimi i Potencialit për Rritje: Strategjitë, Politikat, Veprimet*, prill 2010, f. 75.

Megjithatë, për shkak të nivelit të lartë të papunësisë në mesin e të rinjve, ‘humbja e trurit’²¹⁴ sipas Bankës Botërore mund të jetë më tepër problem në të ardhmen.

Përkundër shkallës së lartë dhe historisë së migrimit, Kosova ende nuk ka politika të migrimit. Qeveria e Kosovës duhet të hartoj politika të qëndrueshme të migrimit, si dhe një vizion strategjik për rolin që migrimi duhet ta ketë në Kosovë, siç është për shembull migrimi i rregulluar dhe kontrolluar. Kërkimet e hollësishme mund t’i ndihmojnë këto strategji, duke përfutur nga mësimet historike të vendeve të tjera dhe duke i përshtatur ato për rrethanat specifike të Kosovës sot. Migrimi mund të luaj rol të rëndësishëm në zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive në Kosovë. Siç tregojnë hulumtimet, dëshira e të rinjve kosovarë për të migruar ishte nxitur nga dëshira për të zhvilluar aftësi dhe për të studiuar në vendet e jashtme. Prandaj, qeveria mund të ndihmoj duke hartuar programe që i përkrahin të rinjtë të studiojnë jashtë dhe pastaj t’i kthejnë aftësitë dhe potencialin e tyre në Kosovë. Nënshkrimi i kontratës në mes qeverisë dhe individit i cili do të duhej të punonte pesë vite për qeverinë pas përfundimit të studimeve do të ishte mekanizëm i mirë i kontrollit.

Ndihmat nga jashtë kanë luajtur rol të rëndësishëm si burim i të ardhurave për shumë familje kosovare. Derisa ato kanë pasur ndikim kritik në uljen e varfërisë, ka shumë pak indikacione rreth ndikimit të tyre në stimulimin e aktiviteteve ekonomike. Dërgesat nga jashtë kryesisht janë përdorur për ushqim dhe veshmbathje.²¹⁵ Një mjedis më i favorshëm për bizneset si dhe sektori fleksibil financiar do të mund ta hapnin rrugë për përdorimin e dërgesave për investime dhe për krijimin e vendeve të reja të punës.

‘Kosova: Evropianët e Rinj’

Anëtarësimi në BE është forca lëvizëse prapa reformave në Kosovë. Megjithatë, Kosova ende ballafaqohet me sfida shumë të mëdha të cilat e bëjnë integrimin në BE një ëndërr të largët. Raporti i progresit i vitit 2009 i Komisionit Evropian për Kosovën ka identifikuar një listë të gjatë fushash të cilat duhen reformuar: ndërtimi dhe konsolidimi i sundimit të ligjit; ndërtimi i një rekordi në luftën kundër korrupsionit; forcimi i administratës publike; përmirësimi i mjedisit ekonomik; dhe ndërtimi i politikave makroekonomike dhe fiskale.²¹⁶

Diskursi politik në Kosovë tregon që shpresat për integrimin e ardhshëm të Kosovës në BE janë shumë të mëdha. Popullsia e re e Kosovës është gjetur rregullisht në qendër të këtyre reformave. Fushata ndërkombëtare promovuese për Kosovën, e lançuar më 26 tetor 2009, e shpalli sloganin e saj ‘Kosova: Evropianët e Rinj’ në gjashtë stacione televizive në Evropë dhe SH.B.A, përfshirë këtu CNN, BBC, Euronews, Bloomberg dhe Eurosport. Fushata synon ta paraqes Kosovën si komb të ri, duke e përqendruar në fuqinë e rinisë.

Derisa fushata i ka emëruar ata si ‘Evropianët e Rinj,’ disa të rinj kosovarë mendojnë se ata jetojnë më së paku si Evropë. Në fjalët e Milotit:

Nuk e ndjej vetën ‘Evropian të Ri,’ ndoshta pse kurrë nuk kam pasur mundësinë të shkoj në Evropë dhe t’i shoh ngjashmëritë dhe dallimet në mes nesh dhe

²¹⁴ Humbja e trurit është emigrimi i njerëzve me kualifikime dhe aftësi të zhvilluara nga vendi. Përfitimi i trurit është kthimi në shtëpi i njerëzve që kanë studiuar jashtë.

²¹⁵ Banka Botërore, *Kosova, Zbërthimi i Potencialit për Rritje: Strategjitë, Politikat, Veprimet*, prill 2010, f. 79.

²¹⁶ Komisioni Evropian, Raport i Progresit për Kosovën nën Rezolutën 1244/99 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Bruksel, tetor 2009.

evropianëve të rinj. Nëse e krahasoj vetëm me njerëzit që jetojnë jashtë, mund të them se ata janë më të hapur ndaj gjërave të reja. Ata jetojnë në vende ku mbijetesa nuk është çështje dhe merren me gjërat e tyre siç është arsimit dhe zhvillimi i tyre personal.²¹⁷


Në fakt, shumë pak të rinj ishin gjallë ose mund ta kujtojnë kohën e Jugosllavisë së dikurshme, kur të gjithë kosovarët mund të udhëtonin lirshëm nëpër Evropë. Shumë pak prej tyre gëzojnë mundësitë që i kishin gëzuar prindërit e tyre për të udhëtuar jashtë. Pasaporta e re e Kosovës, e lëshuar për herë të parë nga Qeveria e Kosovës në korrik të vitit 2008, është njëri prej dokumenteve të udhëtimit që përdoret më së paku në mbarë botën. Poseduesit e këtij dokumenti mund të udhëtojnë vetëm në pesë vende pa vizë: Shqipëri, Mal të Zi, Maqedoni, Turqi dhe Haiti.²¹⁸ Prandaj, në vitin 2010, Kosova ka mbetur njëri prej vendeve më të izoluara në botë.

Ky izolim ka ndikuar në perceptimet e shumë të rinjve kosovarë për të rinjtë evropian. Rona, studente 20-vjeçare nga Prishtina, thotë, ‘dallimet në mes rinisë kosovare dhe asaj evropiane janë shumë të madhe, duke filluar më mënyrën si jetojnë, cilësinë e arsimit, pavarësinë e tyre, e mos ta përmendim zhvillimin ekonomik dhe teknologjik.’²¹⁹ Majlinda, gazetare 22-vjeçare, thotë që jeta në një vend të pazhvilluar dhe izoluar e vë rininë në rrezik:

Në Evropë, të rinjtë kanë shumë hapësirë. Ata jetojnë në vende me ekonomi të zhvilluar dhe janë të përfshirë në të gjitha fushat e jetës. Ata kanë teknologji më të zhvilluar si dhe mentalitet tjetër. Janë më të hapur. Nuk janë të izoluar, dhe mbi të gjitha janë të pavarur. Rinia kosovare nuk gëzon asnjëherë nga këto.²²⁰

Ngjashëm me këtë, edhe respondentët e studimit u shprehën për dallimin në mes rinisë kosovare dhe asaj evropiane. Afro 7 përqind e të rinjve 15-24 vjeçar thanë se nuk kishin asgjë të përbashkët me të rinjtë evropian dhe 38.8 përqind thanë se nuk janë ‘aq të ngjashëm.’ Siç ilustron Grafiku 4.6, një e treta thanë se janë të ngjashëm në disa aspekte. Vetëm 4 përqind mendojnë se janë shumë të ngjashëm, dhe 17.6 përqind thanë se nuk e dinë nëse janë të ngjashëm ose jo.

Grafiku 4.6 Perceptimet e të rinjve kosovar të grupmoshës 15-24 vjeç për ngjashmëritë me të rinjtë evropian



²¹⁷ Intervista e IKS me Milot Rexhepin, student i shkencave politike, Prishtinë, 9 prill 2010.

²¹⁸ Iniciativa Evropiane për Stabilitet, *Izolimi i Kosovës? Kosova vs. Afganistan 5:22*, Berlin, Prishtinë, nëntor 2009.

²¹⁹ Intervista e IKS me Rona Kelmendin, studente, Prishtinë, 6 prill, 2010.


²²⁰ Intervista e IKS me Majlinda Kosumoviq, gazetare, Prishtinë, 7 prill, 2010.

Sa i përket ngjashmërive, 34.7 përqind të respondentëve thanë që të rinjtë kosovarë janë të ngjashëm me të rinjtë evropian sa i përket moshës ('ne të gjithë jemi të rinj'). Tjerët (21.5 përqind) thanë se ballafaqohen me çështje të ngjashme të moshës. Megjithatë, 22.2 përqind të respondentëve thanë se nuk e din si të rinjtë kosovarë janë të ngjashëm me të rinjtë evropian.

Në pyetjen se si dallojnë, 45.5 përqind thanë se të rinjtë evropian gëzojnë gjendje më të mirë ekonomike dhe janë më të zhvilluar. Tjerët përmendën dallimet në kulturë dhe traditë (43.4 përqind). Më tepër se 40 përqind thanë se të rinjtë evropian kanë 'jetë më të mirë' dhe 37 përqind përmendën 'arsimin më të mirë'.²²¹ Respondentët tjerë thanë se të rinjtë evropian kanë 'më shumë mundësi' (22.2 përqind), më të informuar (16.8 përqind), veshën ndryshe (10.7 përqind) apo dallojnë në çdo aspekt (9.8 përqind). Rreth 19 përqind e respondentëve nuk e dinin se si dallojnë nga të rinjtë tjerë evropian.

Anëtarësimi në BE do ta ulte izolimin e kosovarëve dhe do të ofronte mundësi të reja në arsim dhe zhvillim ekonomik. Shumica e respondentëve të rinj shikojnë drejt anëtarësimit në BE. Siç ilustron Grafiku 4.7, më tepër se 80 përqind e respondentëve 15-24 vjeçar pajtohen me anëtarësimin e Kosovës në BE. Më pak se 10 përqind nuk e dinin dhe vetëm disa nuk pajtoheshin (5.6 përqind) ose ishin të pavendosur (3.3 përqind). Ngjashëm me këtë, 70 përqind të respondentëve 10-14 vjeçar pajtohen me anëtarësimin e Kosovës në BE. Rreth 25 përqind e respondentëve më të rinj thanë se nuk e dinë, me siguri për shkak të mosnjohurisë rreth BE-së në moshë të re.

Grafiku 4.7 Perceptimi i të rinjve të grupmoshës 15-24 vjeçare rreth asaj se a duhet Kosova të anëtarësohet në BE



Disa të rinj shprehin që anëtarësimi në BE do ta ndihmojë Kosovën. Për shembull, Selda, 21-vjeçare dhe studente e marketingut, asnjëherë nuk ka qenë në Evropë. Përshtypja e saj për rininë evropiane bazohet në përvojën e miqve të saj që jetojnë jashtë vendit:

Kam shumë miq dhe të njohur që jetojnë jashtë vendit. Sa i përket arsimit, ata janë shumë para nesh. E kanë shumë të zhvilluar mendimin kritik, dhe horizont më të gjerë për të ardhmen e tyre [...]. Mendoj se ne kemi shumë më pak

²²¹ Kjo ishte pyetje e përafërt e cila mundësonte disa përgjigje.

mundësi sepse jemi të izoluar, dhe prindërit tonë luftojnë për mbijetesën tonë. Mendoj se kur Kosova të bëhet anëtare e BE-së, atëherë do të kemi shumë më tepër mundësi. Ndryshimi është evident në mesin e të rinjve nga Kosova të cilët shkojnë jashtë për të studiuar dhe pastaj kthehen këtu dhe i ndajnë përvojat e tyre.²²²

Është e vërtetë që duke studiuar jashtë dhe duke e kthyer në Kosovë, shumë të rinj kanë fituar përvojë dhe njohuri për ta sjell Kosovën më afër integritit në BE. Gjatë takimeve të fokus grupeve, të rinjtë shprehën shpresën që institucionet kosovare do t'i përfshijnë të rinjtë që kanë studiuar jashtë në mënyrë që ata ta ndajnë njohurinë e tyre dhe t'i kontribuojnë vendit. Qeveria e Kosovës do të bënte mirë në qoftë se do të eksploronte mënyra shtesë për përfshirjen e kapitalit shoqëror²²³ të të rinjve dhe për stimulimin e 'përfitimit të trurit.'

Në fund, anëtarësimi në BE varet nga ndryshimi brenda në vend. Politikbërësit evropian e kanë sfiduar mendimin që BE-ja do t'i ndihmojë Kosovën t'i zgjedh problemet e saja të shumta të lartpërmendura.²²⁴ Anëtarët e Parlamentit Evropian kanë deklaruar se nuk ekzistojnë as burimet financiare e as përkushtimi politik për ta bërë këtë.²²⁵ Megjithatë, anëtarësimi eventual në BE do të kërkojë kombinimin e përbushjes së kriterëve nga ana e lidershit kosovar si dhe përkushtimin politik të Evropës. Kosova mund ta ndjek ëndrrën e saj evropiane vetëm duke investuar, fuqizuar dhe zërbërthyer potencialin e fontanës së natyrisht të rinisë.

Edhe pse të rinjtë shprehën besimin e tyre të fortë se Kosova duhet të jetë anëtare e BE, shumë të dhëna themelore për institucionet dhe vlerat e BE-së mungojnë. Prandaj, iniciativa për hapjen e qendrave informative dhe kulturore²²⁶ të BE-së në vende të tjera jashtë Prishtinës duhet të inkurajohet. Po ashtu, Qeveria e Kosovës dhe BE, që të dyjat, duhet të shfrytëzojë këtë moment të qëndrimeve pozitive të të rinjëve kosovarë ndaj BE-së. Përveç kësaj, ata mund të organizojnë kurse të detyrueshme të integritit në BE (institucionet dhe vlerat) për pjesëmarrësit e shkollave të mesme, si pjesë e subjektit përkatës e shkencave sociale ose edhe si lëndë e veçantë.

Në sytë e të rinjve, kushtet ekonomike dhe sociale kanë shërbyer si njësi matëse për cilësinë e jetës në Kosovë. Të dy grupmoshat konsideruan një situatë më të mirë ekonomike dhe standardin e jetesës si arsye pse Kosova do të jetë një vend më i mirë për të jetuar në të ardhmen. Në anën tjetër, varfëria dhe problemet sociale janë përmendur si arsye pse Kosova mund të jetë një vend më i keq për të jetuar. Nëse Kosova do të ndjekë rrugën e saj drejt integritit evropian dhe të jetë ekonomi konkurruese në tregun evropian, arsimit, integritit dhe fuqizimi i brezave të rinj është një 'nevojë' që Kosova duhet të përbush. Është momenti i fundit që Kosova të çliroj potencialin e të rinjve të saj dhe ti vendos ata në zemrën e politikave të qeverisë dhe kjo do ti jep Kosovës mundësin për tu transformuar nga vendi i vetëm në rajon pa një marrëdhënie kontraktuale me BE-në - në rrugën e shpejt drejt BE-së.

²²² Intervista e IKS me Selda Sylejmani, studente, Prishtinë, 8 prill 2010.

²²³ Në literaturën e migrimit 'dërgesat sociale janë idetë, sjelljet, identitetet dhe kapitali shoqëror që rrjedhin nga komunitetet që dërgojnë tek ato që pranojnë.' Shih Levitt, F., 'Social remittances: migration driven local-level forms of cultural diffusion,' *International Migration Review*, 1998, 32(4), f. 926.

²²⁴ Për shembull, shih pikat folëse të Ingeborg Grässle, Anëtare e Parlamentit Evropian, Diskutim në Panel, 'Zgjerimi i BE-së në Ballkanin Perëndimor: Qasja e Trakës së Shpejtë apo Rrugës së Ngadalshme?' organizuar nga London School of Economics dhe Political Institute, LSEE – Hulumtim mbi Evropën Juglindore, Londër, 18 mars 2010.

²²⁵ Po aty.

²²⁶ Qendra e pare informative dhe kulturore e BE-së u hap në Prishtinë më 5 tetor 2010. Për më shumë shih: <http://www.delprn.ec.europa.eu/?cid=2,49,995>.

FUSHAT PËR HULUMTIME TË MËTUTJESHME

Analiza e sakta e kërkesave të tregut të punës është më se e domosdoshme dhe urgjente. Për ta rritur rëndësinë e arsimit në tregun e punës dhe për të siguruar kalim të lehtë nga arsimi në punësim, planprogramet e shkollave dhe universiteteve duhet t'i përshtaten kërkesave të tregut të punës.

Hulumtimet e mëtutjeshme cilësore mund të eksplorojnë në mënyrë më të hollësishme arsyet e pjesëmarrjes në rënie të të rinjve në proceset vendimmarrëse, si dhe arsyen pse vendimmarrësit nuk kanë arritur t'i përfshijnë të rinjtë. Hulumtimet e mëtutjeshme poashtu mund të ofrojnë rekomandime shtesë për fuqizimin e shtuar të pjesëmarrjes së të rinjve.

Një analizë e hollësishme e Buxhetit të Kosovës mund të ofroj rekomandime specifike për fushat ku mund të bëhen përshtatje buxhetore të cilat do ta përmirësonin arsimin, cilësinë e qendrave të punësimit si dhe përkrahjen financiare për Drejtoratin e Rinisë. Rekomandimet e qarta pastaj mund të përdoren në fushata avokuese që përfshijnë të rinjtë dhe qytetarë të tjerë për ndryshime në buxhetin aktual.

Debatet aktuale mbi marrëdhënien në mes migrimit dhe zhvillimit duhet t'i kushtojnë më tepër vëmendje efekteve pozitive dhe negative të emigrimit, përfshirë këtu rezultatet e veçanta të migrimit të të rinjve.


Përdorimi i drogës si dhe dhuna në shkollë janë fusha për të cilat nuk janë bërë hulumtime të mjaftueshme.

Në fund, asnjë hulumtim nuk është i përsosur dhe të gjitha hulumtimet përmbajnë një margjinë të gabimit. Ne synojmë t'i minimizojmë gabimet dhe ta vlerësojmë shkallën deri në cilën gabimi është prezent dhe pse. Prandaj, fushat e njohura të gabimeve, paqartësitë dhe fushat ku gjetjet nuk janë të qarta apo jo përfundimtare, janë raste për hulumtime të mëtutjeshme. Për shembull, përqindja e mungesës së përgjigjeve apo e përgjigjeve 'nuk e di' ishin mjaft të larta në disa pyetje, poashtu disa nga pyetjet ishin të ashtuquajtura me dy tyta²²⁷ apo me strukturë të dobët, dhe kjo e pengonte analizën. Për rastet e ardhshme, do të ishte mirë të rishikohej pyetësi, në veçanti me ndihmën e ekspertëve të hartimit të pyetësorëve studiues. Kjo do ta shtonte besueshmërinë dhe vlefshmërinë e gjetjeve të studimit. Zhvillimi i studimit të njëjtë duke përdorur strategjinë e njëjtë të mostrave çdo 5 ose 10 vite mund të mundësojë krahasime në mes viteve. Hulumtimet e mëtutjeshme ndoshta me formulim më të kujdesshëm të pyetjeve, mund të reduktojnë përgjigjet e tilla e me këtë edhe mundësinë e gabimeve.


²²⁷ Pyetja me dy 'tyta' shtron disa pyetje në formë të një pyetje të vetme. Kjo është problematike sepse respondentët mund të mos dinë në cilën pjesë të pyetjes të përgjigjen ose mund të kenë mendime të ndryshme për pjesë të ndryshme të pyetjes.

Annex I. Grafikë nga anketa e IKS-it në mbarë Kosovën


Grafiku 1. Elementë formues të identitet që konsiderohen si ‘shumë të rëndësishëm’ nga grup moshë 15-24 vjeçare




Grafiku 2. Vlerat më të rëndësishme që të rinjtë në moshën 10-14 vjeçare inkurajohen të mësojnë në shtëpi




Grafiku 3. Vlerat që të rinjtë në moshën 15-24 vjeçare janë ‘shumë’ të inkurajuar të mësojnë në shtëpi




Grafiku 4. Aspekte të rëndësishme që i japin kuptim jetës së të rinjve, për moshën 15-24 vjeçare




Grafiku 5. Sa të rinjtë pajtohen me ‘Duhet të ketë rregulla më strikte...’




Grafiku 6. Lehtësia e diskutimit të problemeve në shkollë për të rinjtë e moshës 15-24 vjeç




Grafiku 7. Të rinjtë i diskutonin problemet e tyre...




Grafiku 8. Niveli i besimit në institucionet e mëposhtme për të rinjtë e moshës 15-24 vjeç




Grafiku 9. Përdorimi i televizorit gjatë ditëve të javës nga të rinjtë e moshës 10-14 vjeç




Grafiku 10. Kontrolli i prindërve ndaj përdorimit të televizorit për të rinjtë e moshës 10-14 vjeç




Grafiku 11. Programet më të vëzhguara në televizor nga të rinjtë e moshës 10-14 vjeç




Grafiku 12. Koha e kaluar në kompjuter nga të rinjtë e moshës 10-14 vjeç




Grafiku 13. Përse përdoret më shumë kopjuteri nga të rinjtë




Grafiku 14. Kontrolli i prindërve ndaj përdorimit të kompjuterit nga të rinjtë e moshës 10-14 vjeç
Prindërit e mi...




Grafiku 15. Pakënaqësia me shërbimet komunale për të rinjtë në moshën 15-24 vjeç




Grafiku 16. Sa dinë të rinjtë në moshën 10-14 vjeçare për të drejtat e fëmijëve




Grafiku 17. Përqindja e të rinjëve të moshës 10-14 që kanë dijeni për të drejtat e fëmijëve




Grafiku 18. Vendet që të rinjtë do të donin të jetonin në të ardhmen




Grafiku 19. Shqetësimi me papunësinë sipas grupit etnik për rininë në moshën 15-24 vjeç




Grafiku 20. Ndryshimi midis respondentëve Shqiptarë dhe Serbë të moshës 15-24 vjeç që do të zgjidhnin të vazhdonin shkollën ose të praninin ofertën e punës gjatë studimeve




Grafiku 21. Ndryshimi midis respondentëve meshkuj dhe femra të moshës 15-24 vjeç që do të zgjidhnin të vazhdonin shkollën ose të praninin ofertën e punës gjatë studimeve



Grafiku 22. Sa bashkohen ose kundërshtojnë thënien se edukimi nuk i përgatit për tregun e punës rinia e moshës 15-24 vjeç nga grupe të ndryshme etnike



Grafiku 23. Sa besojnë rinia Kosovare Shqiptare dhe Kosovare Serbe në moshën 15-24 vjeç se interesat e tyre merren parasysh nga institucionet vendim marrëse



ANEKS II. Pyetësi për të Rinjtë e Moshës 10-14 vjeçare

Pëlqimi i informuar është dhënë nga:

1. Nëna
2. Babai
3. Kujdestar Mashkull
4. Kujdestar Femër

PL1. Le të flasim për jetën tuaj të përditshme, a je i/e lumtur?

1. Po, jam i/e lumtur
2. Nuk jam as i/e lumtur as i/e pa lumtur
3. I/e pa lumtur
4. Nuk e di / pa përgjigje

PL2. Sa shpesh ndiheni i/e lumtur?

1. Shumicën e kohës
2. Vetëm ndonjëherë
3. Pothuajse asnjëherë
4. Asnjëherë
5. Nuk e di / pa përgjigje

PL3. Kur ndiheni më tepër i/e lumtur?

(Mos e lexoni me zë. Shënoni përgjigjen e parë dhe të dytë sipas radhës në hapësirat e vendosura më poshtë)

PL3A _____

PL3B _____

- | | |
|-----------------------------------|--|
| 1. Koha e lirë / koha e argëtimit | [Koha e lirë (e pa specifikuar), pushimet/deti, kur nuk ka mësim/vikendi/,pas shkollës, hobi (të gjitha përveç sporti), aktivitete sportive, televizioni, kinemaja, koha për të luajtur, kompjuteri/lojrat në kompjuter, udhëtimi,eskursioni. shëtitja, të tjera.] |
| 2. Familja | [Kur jam me familje, vizita te/nga të afërmit, familja është e mirë/kënaqësi, familja është në shtëpi, festat në familje, të tjera.] |
| 3. Shokët | [Kur jam me shokë, kënaqësia me shokë/argëtimi me shokë, të tjera] |
| 4. Shkolla | [Në shkollë (e paspecifikuar). Kur marr nota të mira, performancë të mirë në shkollë, aktivitetet shkollore, të tjera |
| 5. Paratë | [Kur kam para, kur marr para xhepi, të tjera] |
| 6. Shpërblime dhe dhurata | [Kur lavdërohem nga prindërit dhe të tjerët, kur marr shpërblime, dhurata, kur më blen dikush dicka, të tjera] |
| 7. Tjera _____ (specifiko) | |
| 8. Nuk e di, nuk ka përgjigje | |

PL4. Kur ndiheni të pakënaqur? (*Mos e lexoni me zë. Shënoni përgjigjen e parë dhe të dytë sipas rradhës në hapësirat e vendosura më poshtë*)

PL4a _____

PL4b _____

1. Problemet me familje [Kur ka problem/grindje në shtëpi, problem/grindje me prindër, problem/grindje me vëllezer/motra, babanë/ familjar të largët, antarët e familjes të ndjerë keq, të tjera]
2. Problemet me shokët [Problem/grindje me shoqëri (jo e specifikuar), kur shoqëria ndihet keq, kur dicka e keqe ju ndodh atyre, kur nuk i shoh, të tjera.]
3. Në shkollë [Në shkollë (jo e specifikuar), problemet në shkollë, grindjet në shkollë, nota të keqija/përformancë e dobët në shkollë, detyra, provime, kur duhet të shkoj në shkoll, të tjera]
4. Dënimi / mungesa e lirisë [Kur jam i dënuar, i përjashtuar, nuk lejohej të..., i detyruar të bëj dicka, të tjera.]
5. Ndjenja negative [I vetmuar, i mërzhitur, i ngacmuar, kur më qeshin, kur më lëndohen ndjenjat, fizikisht i lënduar/i rrahur, pamundësia për të arritur dicka, ngatërresa/brengosje, dëshirat nuk realizohen, fajtor/ ndjenjë e fajit (diçka e bërë keq/gabim, të tjera.)]
6. Vdekja / sëmundja [Anëtar i familjes vdes, dikush që e dua vdes, sëmundjet në familje, sëmundje të shokut/shoqes apo dikënd që e dua, kur jam i sëmurë, të tjera.]
7. Te tjera _____ (specifikoj)
8. Nuk e di/ pa përgjigje

PA1. Pse shkon në shkollë ti? (*Mos e lexoni me zë. Shënoni përgjigjen e parë dhe të dytë sipas rradhës në hapësirat e vendosura më poshtë*)

PL4a _____

PL4b _____

1. Për të mësuar gjëra të reja [Për të mësuar (jo e specifikuar), për të mësuar gjëra të reja, gjuhë të huaja, për të vijuar në universitet/arsimim i lartë, mësim për jetën, përgatitja për jetë/për të ardhmen, për të marrë nota të mira, arsimim të mirë, për tu bërë i mençur/intelegjent, të tjera.]
2. Për tu edukuar [Për tu edukuar, person i edukuar, mashkull/femër e mirë, për të menagjuar gjërat në jetë, i pavarur, i disiplinuar/edukuar mirë, i ndershëm, mos me qenë budalla/idiot, mos me qëndru prapa tjerëve/për shkak të shoqërisë, për të qenë person i përgjegjshëm, të tjera]
3. Ambicie profesionale [Gjetja e një profesioni (jo e specifikuar), punë interesante, mundësi trajnimi, për tu bërë i famshëm në jetë, i suksesshëm, të tjera]
4. Gjendje më e mirë financiare [Përfitimi i parave në të ardhmen, të tjerat të lidhura me situatën financiare.]
5. Familja [Për ta bërë familjen krenare, për ti siguruar familjes një jetë më të mirë në të ardhmen, të kujdesem për familjen/familjen e ardhshme, të tjera të lidhura me familje.]

6. Arsye të tjera _____ (specifiko)

7. Nuk e di / pa përgjigje

PA2. Si kalon/çfarë raporte ke me:

		Shumë mirë	Mirë	Mesatare	E keqe	Shumë e keqe	Nuk ka përgjigje
12.1	Mësuesit						
12.2	Shoqet e klasës						
12.2	Shokët e klasës						

PA3. Pse thua se ja kalon keq /shumë keq me mësuesit? (Përgjigje e shumëfishtë) (Në rast se i anketuari është përgjigjur në pyetjen e PA2 me: Shumë mirë, Mirë ose Mesatare, atëherë kaloje këtë pyetje)

1. Mungesa e komunikimit
2. Trajtim i keq
3. Kërkesa të mëdha
4. Mësuesit e dobët
5. Nuk më pëlqen shkolla
6. Arsye tjera _____ (specifiko)
7. Nuk e di / pa përgjigje

PA4. Pse thua se ja kalon keq/shumë keq me shokët e klasës? (Përgjigje e shumëfishtë) (Në rast se i anketuari është përgjigjur në pyetjen e PA2 me: Shumë mirë, Mirë ose Mesatare, atëherë kaloje këtë pyetje)

1. Nuk ka mirëkuptim reciprok
2. Nuk më trajtojnë mirë
3. Karakteri i tyre
4. Unë nuk mund ti besoj atyre
5. Ata më maltretojnë
6. Arsye të tjera _____ (specifiko)
7. Nuk e di / pa përgjigje

PA5. Pse thua se ja kalon keq/shumë keq me shoqet e klasës? (Përgjigje e shumëfishtë) (Në rast se i anketuari është përgjigjur në pyetjen e PA2 me: Shumë mirë, Mirë ose Mesatare, atëherë kaloje këtë pyetje)

1. Nuk ka mirëkuptim reciprok
2. Nuk më trajtojnë mirë
3. Karakteri i tyre
4. Unë nuk mund ti besoj atyre
5. Ato më maltretojnë
6. Arsyet tjera _____ (specifiko)
7. Nuk e di / pa përgjigje

PA6. Kur keni probleme në shkollë me kë flisni së pari? (Përgjigje e shumëfishtë)

1. Me Shokët
2. Me Mësuesit
3. Me Prindërit / Familja
4. Me Drejtorinë e Shkollës
5. Me Këshillin e Nxënësve
6. Me të tjerë _____ (specifiko)
7. Nuk e di / pa përgjigje

PA7. Sa jeni të kënaqur me cilësinë e arsimit që ju merrni?

1. Shumë i kënaqur
2. I/e Kënaqur
3. As i/e kënaqur as i/e pakënaqur
4. I/e Pakënaqur
5. Shumë i/e pakënaqur
6. Nuk e di / pa përgjigje

PA8. Sa të kënaqur jeni me çështjet e mëposhtme në lidhje me shkollën tuaj? (Shkalla 1-5)

(1-shumë i pakënaqur, 2-pakënaqur, 3-as i kënaqur as i/e pakënaqur, 4-i/e kënaqur, 5-shumë i kënaqur, 6 nuk e di / pa përgjigje)

	SHP	P	AKAP	K	SHK	ND
a. <u>Gjërat e reja që mësoni</u>	1	2	3	4	5	6
b. <u>Pastërtinë/ kushtet higjienike</u>	1	2	3	4	5	6
c. <u>Orarin e mësimi</u>	1	2	3	4	5	6
d. <u>Plan-programet</u>	1	2	3	4	5	6
e. <u>Klasat / laboratorët/ pajisjet sportive</u>	1	2	3	4	5	6
f. <u>Bankat / karriget / pajisjet e klasës</u>	1	2	3	4	5	6
g. <u>Librat dhe materialet mësimore</u>	1	2	3	4	5	6
h. <u>Ngrohjen në klasë</u>	1	2	3	4	5	6
i. <u>Sjelljen e mësuesve</u>	1	2	3	4	5	6
j. <u>Sjelljen e personelit administrativ</u>	1	2	3	4	5	6
k. <u>Sjelljen e drejtorisë</u>	1	2	3	4	5	6
l. <u>Aktivitetet zbavitëse</u>	1	2	3	4	5	6

PA9. Në shkollën tuaj a keni mundësi të përdorni?

	Po	Jo	Nuk ka	Nuk e di
a. <u>Kompjutera</u>	1	2	3	4
b. <u>Internet</u>	1	2	3	4
c. <u>Bibliotekën</u>	1	2	3	4
d. <u>Labororet</u>	1	2	3	4
e. <u>Hapësirat për sporte</u>	1	2	3	4
f. <u>Kujdes shëndetësor (dentist, vaksinim)</u>	1	2	3	4

PA10. Sa pajtohesh ti me ato që do të lexoj tani? (1-nuk pajtohem aspak, 2-nuk pajtohem, 3-as pajtohem as nuk pajtohem, 4-pajtohem, 5-plotësisht pajtohem, 6- nuk e di / pa përgjigje)

	NPA	NP	APAN	P	PP	ND
a. <u>Mësuesit janë të përkushtuar në punë</u>	1	2	3	4	5	6
b. <u>Mësuesit janë të kualifikuar mirë për të na mësuar</u>	1	2	3	4	5	6
d. <u>Mësuesit janë shumë autoritare</u>	1	2	3	4	5	6
<u>Mësuesit kujdesen për përparimin tim në mësim</u>	1	2	3	4	5	6
e. <u>Mësuesit marrin parasysh nevojat e mia individuale, aftësitë e mia dhe mbështesin talentin tim</u>	1	2	3	4	5	6
f. <u>Mësuesit notojnë nxënësit drejt</u>	1	2	3	4	5	6
g. <u>Mësuesit trajtojnë vajzat dhe djemtë në mënyrë të barabartë</u>	1	2	3	4	5	6

h.	<u>Ka bashkëpunim të mjaftueshëm me prindërit</u>	1	2	3	4	5	6
i.	<u>Duhet të ketë rregulla më të ashpra kundër pirjes së duhanit në shkollë</u>	1	2	3	4	5	6
j.	<u>Duhet të ketë rregulla më të ashpra kundër përdorimit të telefonave mobil në shkollë</u>	1	2	3	4	5	6
k.	<u>Ka shumë nxënës në klasë</u>	1	2	3	4	5	6
l.	<u>Duhet të ketë rregulla më të ashpra për përdorimin e uniformave të nxënësve</u>	1	2	3	4	5	6

PA11. A ke shkuar ndonjherë në ndonjë kurs trajnimi jashtë shkollës?

1. Po
2. Jo [Kalo në pyetjen PI1]

PA11a. Nëse po, në çfarë kursi ke qënë? (Përgjigje e shumëfishtë)

1. Kurs i gjuhëve të huaja
2. Kurs Kompjuteri
3. Kurs Muzike
4. Kurs Vallëzimi
5. Kurse të tjera _____ (specifiko)

PI1. A merr pjesë në ndonjë klub, shoqatë apo organizatë për fëmijë?

1. Po
2. Jo [Kalo në pyetjen PI2]

PI1a. Nëse po, çfarë lloj i grupit është? (Përgjigje e shumëfishtë)

1. Klub Sporti
2. Klub Vallëzimi
3. Grup muzikor
4. Klub Artistik [pikturë, aktrim / teatër, / literaturë]
5. Grup Rinor
6. Këshilli i nxënësve
7. Grup fetar
8. Klub tjetër _____ (specifiko)

PI2. Si e kaloni kohën tuaj të lirë?

(Mos e lexoni me zë. Përgjigje e shumëfishtë)

1. Duke luajtur me shokët
2. Duke shikuar TV
3. Duke luajtur lojërat kompjuterike
4. Në internet
5. Merrem me aktivitete sportive
6. Duke u marrë me hobi [pikturë, aktrim, duke luajtur muzikë]
7. Duke lexuar
8. Të tjera _____ (specifiko)

